

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 88-të i botimit
Dhjetor 2020/ Nr. 12



Ja çfarë kemi bërë në tre vite
Ministrja Xhaçka: FA institucioni
më i besuar për shqiptarët



Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes
Albert Mullai merr drejtimin e
Akademisë së Forcave të Armatosura



Batalioni i Forcave Speciale
Zhvillohet stërvitja "Rural
Surveillance and Patrol Training"



Baza e trajnimeve ndërkombëtare Hohenfles, Gjermani

**Kompania II-të e Këmbësorisë
në stërvitjen "KFOR -28"**

Përmbajtja

Numri 12

SESIONI I 66-TË VJETOR

- 5** Mimi Kodheli zgjidhet Zëvendësprezidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s

DEKLARATË E FORCËS AJRORE

- 6** Ja destinacioni i fluturimeve, arsyet dhe personat që kanë udhëtuar

MIRATIMI

- 10** Buxheti për mbrojtjen 2021, 1,5% e Prodhimit të Brëndshëm Bruto (PBB)

OPINION

- 25** Rëndësia e forcës Fizike në Ushtritë moderne

EPOPEJA E LUFTËS SË KOPLIKUT

- 42** Lufta që e ktheu Veriun e Shqipërisë në kufijtë e vitit 1913

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA
Hajrie DEDAJ

Redaktore/ korrektore:
SUELA HODO

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ



4 FORCAT E ARMATOSURA

Ministrja Xhaçka: FA institucioni më i besuar për shqiptarët

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, përmes një postimi në "Facebook" shkruan më datë 9 nëntor 2020, se Forcat e Armatosura janë sot institucioni...



7 KDS

Albert Mullai merr drejtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura

Gjeneral Brigadë Albert Mullai ka marrë drejtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura. Lajmin e bëri të ditur ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka e cila tha se Mullait iu besua...



8 COVID-19

Mjekët e Forcave të Armatosura në frontin e parë të shërbimit

Mjekët e Forcave të Armatosura janë prej kohësh në frontin e parë të luftës me pandeminë e COVID-19. Në shenjë mirënjohje e falënderimi për kontributin e tyre, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka ka publikuar...



16 HOHENFLES, GJERMANI

Kompania III-të e Këmbësorisë në stërvitjen "KFOR -28"

Nga data 30 shtator deri më 5 nëntor, në bazën e trajnimeve ndërkombëtare Hohenfles, Gjermani u zhvillua stërvitja "KFOR-28". Vendi ynë në...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 88-të i botimit
Nr. 12/ 2020

© *Ministria e Mbrojtjes*

*Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



Ja çfarë kemi bërë në tre vite

Ministrja Xhaçka: FA institucioni më i besuar për shqiptarët

Në 3 vjet ia kemi dalë me shumë punë e shumë mund të bëjmë shumëçka për t'i bërë FA një forcë më moderne, më profesioniste, më të arsimuar, e mbi të gjitha, më meritokratike.

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, përmes një postimi në "Facebook" shkruan më datë 9 nëntor 2020, se Forcat e Armatosura janë sot institucioni më i besuar për shqiptarët. Xhaçka shprehet se Baza e Kuçovës është sot e para bazë ajrore e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, në të cilën do të fillojnë së shpejti punimet.

Postimi i ministres së Mbrojtjes Olta Xhaçka:

3 vjet janë shumë pak në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare. Por jam e lumtur, që në këto 3 vjet në krye të Ministrisë së Mbrojtjes, ia kemi dalë të bëjmë disa punë të mira, që e kanë bërë FA institucionin më të besuar për shqiptarët. E mbi të gjitha, ndihem mirë që djemtë e vajzat, burrat e gratë në

uniformë kanë sot më shumë arsye ta veshin uniformën me krenari e kokën lart. Sepse, në 3 vjet ia kemi dalë me shumë punë e shumë mund të bëjmë shumëçka për t'i bërë FA një forcë më moderne, më profesioniste, më të arsimuar, e mbi të gjitha, më meritokratike.

- Ia kemi dalë t'u garantojmë ushtarakëve një trajtim me dinjitoz, duke rritur pagën e tyre dhe në vitin 2018 duke rikthyer pagesën e vështirësisë dhe trajtimin ushqimor që iu mohua me të padrejtë në 2013.

- Ia kemi dalë të akreditojmë Akademienë e FA, si të vetmin institucion të arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke hedhur kështu një tjetër hap të rëndësishëm drejt modernizimit të FA.

- Kemi bërë shumë edhe për modernizimin e infrastrukturës, pajisjeve e kapaciteteve, duke filluar nga sistemet e radarëve; helikopterët Blackhawk, pajisjen me mjetet e duhura të Batalionit të dytë të Këmbësisë; certifikimin nga NATO të Batalionit Kombando dhe B2k e deri tek njësi për luftën kibernetike që i është shtuar sot FA.

- Shqipëria përmes Ministrisë së Mbrojtjes ka drejtuar disa nisma të rëndësishme si SHBA-Karta e Adriatikut (A5), apo SEDM.

Janë zhvillime që vlerësohen edhe nga partnerë e aleatë, të cilët, sot e shohin Shqipërinë jo thjesht si një shtyllë stabiliteti në rajon, por edhe si një eksportues sigurie, kudo ku Aleanca përballet me sfida. Treguesi më i qartë e i dukshëm i këtij besimi është Baza e Kuçovës, e para bazë ajrore e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, në të cilën do të fillojnë së shpejti punimet.



E para shqiptare që merr këtë post të rëndësishëm

Mimi Kodheli zgjidhet Zëvendës-presidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s

Ambasadorja amerikane Yuri Kim, ka uruar deputetin Mimi Kodheli për zgjedhjen si Zëvendës Presidente në Asamblenë Parlamentare të NATO-s



postimi në rrjetet sociale, ka uruar deputetin Mimi Kodheli për zgjedhjen si Zëvendës Presidente në Asamblenë Parlamentare të NATO-s. "Urime Mimi Kodheli për emërimin si Zëvendës Presidenti i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, shqiptari i parë që mban këtë post të rëndësishëm. Ne shpresojmë ta shohim atë duke punuar me Presidentin e Asamblesë Parlamentare Gerry Connolly, për të forcuar NATO-n!" shkruan Kim në Twitter.

Mimi Kodheli ka mbajtur postin e Ministres së Mbrojtjes në vitet 2013-2017.

Në Sesionin e 66-të Vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s (23 nëntor 2020), ku mori pjesë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, zonja Mimi Kodheli është zgjedhur zëvendës presidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

Lajmin e bëri të ditur vetë NATO, ku në një njoftim shkruan:

"Sot, në Seancën e saj Plenare të datës 23 nëntor 2020, Asambleja Parlamentare e NATO-s zgjodhi (me unanimitet të plotë) zonjën Mimi Kodheli në postin e Zëvendës-presidentes së Asamblesë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Zonja Mimi Kodheli, e cila është aktualisht Kryetare e Komisionit Parlamentar për Politikën e Jashtme dhe Kryetare e Delegacionit parlamentar shqiptar në Asamblenë NATO, bëhet kështu e para shqiptare që zgjidhet në një pozicion të tillë të një organizate ndërkombëtare".

Ndërkohë Ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, përmes një

29 Nëntori, Dita Çlirimit të vendit

Xhaçka dhe gjeneralmajor Begaj, homazhe në Varrezat e Dëshmorëve

Shqiptarët festuan 29 Nëntorin, Ditën e Çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë. Në nderim të kësaj ditë, presidentit të Republikës Ilir Meta, kryeministrit Edi Rama, ju bashkua ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, etj të cilët bënë homazhe dhe vendosën kurora me lule pranë monumentit "Nënë Shqipëri", në varrezat "Dëshmorët e Kombit" Tiranë, në respekt dhe mirënjohje të veprës së dëshmorëve që dhanë jetën për çlirimin e vendit.

"Lavdi 29 Nëntorit! Lavdi dëshmorëve të atdheut! Lavdi të gjithë atyre djemve e vajzave, që nuk kursyen asgjë, as jetën, për çlirimin e atdheut. Sot sfidat janë të tjera. Shqipëria është më e sigurt se kurrë. Por djemtë e vajzat tona

Ministrja Xhaçka: "Djemtë e vajzat tona në uniformë kontribuojnë për lirinë, paqen e sigurinë në dhjetëra misione të NATO-s"



në uniformë kontribuojnë edhe sot, me përkushtim e guxim për lirinë, paqen e sigurinë në dhjetëra misione të NATO-s. Kontributi i tyre është krenaria jonë", - shkruan për këtë ditë ministrja Xhaçka në facebook.

Ndërsa me rastin e Festës Kombëtare të 28 Nëntorit, ministrja

Xhaçka ka përcjellë mesazhin, përsëri përmes facebook-ut: "108 vite pas shpalljes së pavarësisë, flamuri ynë valëvitet në çdo cep të botës përmes heronjve tanë nën uniformë, të cilët qëndrojnë krenarë krahu përfaqësuesve të vendeve aleate, në çdo mision të NATO-s, BE-së & OKB-së".

Ja destinacioni i fluturimeve, arsyet dhe personat që kanë udhëtuar

Gjatë muajve të fundit janë kryer 338 fluturime-nga të cilat vetëm 9 në qarkun e Dibrës: 4 për emergjenca mjekësore dhe 5 për emergjenca civile

Ditët e fundit Forca Ajrore e Republikës së Shqipërisë është përballur me një sulm të pabazë nga përfaqësues të një subjekti politik, të cilët akuzojnë për keqpërdorim të misionit dhe të mjeteve të Forcës Ajrore", thuhet në deklaratën e Forcave Ajrore të datës 1 dhjetor 2020.

Mes informacioneve të përdorura në mbështetje të këtyre akuzave, përfaqësues të këtij subjekti kanë bërë publike edhe një listë fluturimesh në një qark të Republikës së Shqipërisë, edhe pse nxjerrja e informacioneve të tilla, shumë prej të cilave janë të klasifikuara për shkak të cenimit të sigurisë së FA, përbën një vepër penale që ndëshkohet me ligj.

Në rastin konkret, thuhet në deklaratën e Forcave Ajrore, në funksion të detyrimit të saj ligjor për transparencë e për të informuar qytetarët, të cilët me të drejtë meritojnë të dinë të vërtetën rreth këtyre akuzave, deklarojmë me përgjegjësi të plotë që informacioni i përcjellë në media nga subjekti politik është i pasaktë, qoftë përsa i përket datave të fluturimeve, qoftë përsa i përket destinacioneve, qoftë përsa i përket arsyeve e qoftë përsa i përket personave që kanë udhëtuar në bordin e mjeteve të Forcës Ajrore.

Është pjesë e misionit të Forcës Ajrore, që të sigurojë kapacitetet e nevojshme për vëzhgimin dhe kontrollin e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë, të mbështesë operacionet luftarake e jo luftarake, ato të kërkim shpëtimit si dhe të realizojë komandim - kontrollin e mjeteve ajrore në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Për më tepër, është detyrë e saj funksionale të mbajë në gatishmëri mjetet dhe efektivet, të garantojë fluturimet dhe kontrollin e hapësirës ajrore, transportin për nevoja të FA, emergjencat civile, emergjencat

mjekësore ajrore dhe asistencën përmes fluturimeve për Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Kryetarin e Kuvendit, Ministrin e Mbrojtjes dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Ne respekt të opinionit publik sqarojmë se:

Çdo pilot operacional i FAj, sipas standardeve të NATO-s ka detyrimin të kryejë minimalisht 120 orë

fluturimi në vit, për të njohur terrenin, ushtruar detyrën dhe njohuritë si pilot, dhe për të ndihmuar në mirëmbajtjen e mjeteve ajrore. Ky detyrim respektohet në mënyrë rigorozë përmes fluturimeve stërvitore dhe detyrave funksionale, çdo ditë e çdo javë në qytete të ndryshme të vendit, siç ka ndodhur dhe do të ndodhë përsa kohë ky është një standard i NATO dhe si i tillë aplikohet në



çdo vend anëtar të Aleancës!

Në përputhje me misionin dhe detyrat e Forcës Ajrore, gjatë muajve të fundit janë kryer 338 fluturime. Nga të cilat vetëm 9 kanë pasur si destinacion qarkun e Dibrës. E përsërisim, vetëm 9 dhe jo 22, siç pretendon subjekti politik, nga të cilat, 4 kanë qenë për emergjenca mjekësore ajrore dhe pjesa tjetër emergjenca civile dhe trajnim rutinë i pilotëve të Forcës Ajrore.

329 fluturime të tjera kanë pasur si destinacion Kukësin, Tropojën, Shkodrën, Lezhën, Mirditën, Elbasanin, Kuçovën, Beratin, Korçën, Gjirokastrën, Vlorën, Sarandën, Fierin dhe Tiranën.

Theksojmë se përgjatë gjithë vitit 2020, Ministria e Mbrojtjes, edhe pse ligji i njeh të drejtën e plotë të përdorë mjetet e Forcës Ajrore në çdo kohë e për çdo detyrë, e ka përdorur këtë të drejtë ligjore vetëm 4 herë në një vit, për të udhëtuar drejt qarqeve Shkodër, Dibër dhe Gjirokastrë, qarqe ku ndodhen edhe detashmentet rajonale të mbrojtjes së Forcave të Armatosura.

Këto 338 fluturime përbëjnë vetëm 22% të planit vjetor dhe të zërit buxhetor të parashikuar për fluturimet stërvitore! Nëse do të përdornim matematikën e subjektit politik, për vetëm 338 fluturimet që janë kryer, vlera financiare do të kishte qenë plot 15 herë më e madhe se sa i tërë buxheti vjetor i FAj për zërin fluturime stërvitore, i cili aktualisht është 78% i parealizuar.

Forca Ajrore jo vetëm nuk ka shpërdoruar fondet dhe njerëzit e saj për arsye politike por në kushtet e një viti të vështirë si pasojë e pandemisë, ka treguar përgjegjshmëri kundrejt qytetarëve duke përdorur me shumë kujdes e pa asnjë abuzim kapacitetet e saj njerëzore dhe financiare. Përdorimi dhe përbaltja e efektivëve të FA në emër të luftës politike është e papranueshme. Forcat e Armatosura janë sot institucioni që gëzon besimin e qytetarëve shqiptarë dhe kjo është arritur pikërisht falë ndaljes së abuzimeve dhe shpërdorimeve që e kishin goditur aq rëndë reputacionin e tij gjatë dekadave të tranzicionit.

KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

Albert Mullai merr drejtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura

Xhaçka: “Gjeneral brigade Albert Mullait i është besuar drejtimi i një prej strukturave më të rëndësishme të FA, Akademisë së Forcave të Armatosura”

Gjeneral Brigade Albert Mullai ka marrë drejtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura. Lajmin e bëri të ditur ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka e cila tha se Mullait iu besua një detyrë shumë e rëndësishme, teksa i ka uruar dhe suksese në detyrë.

“Gjeneral brigade Albert Mullait i është besuar drejtimi i një prej strukturave më të rëndësishme të FA, Akademisë së Forcave të Armatosura. Suksese në detyrën e re komandant Mullai!”, - shprehet Xhaçka.

“Ju dhe çdo efektiv, pedagog dhe student i AFA keni gjithë



mbështetjen tonë, për të çuar përpara një prej projekteve më të rëndësishme për të ardhmen e ushtrisë shqiptare”, - thekson Xhaçka. Përpara marrjes së kësaj detyre, Gjeneral Brigade Albert Mullai mbante postin e Komandantit të Forcave Tokësore.

Gjeneral brigade Albert Mullai ka lindur në Tiranë, më 23 shkurt 1964. Gjatë karrierës së tij si ushtarak ka kryer një sërë detyrash të rëndësishme si: Komandant i Akademisë së nënoficerëve “Thomson”, Këshilltar i lartë për Personelin pranë Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm të FA Afgane në kuadër të Misionit Resolute Support”-Kabul, Afganistan, Shef i Planifikimit Afatgjatë të Komandës Mbështetëse, Atashe Ushtarak i Republikës së Shqipërisë në SHBA, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në MM, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik të Politikave të Personelit, Oficer Shtabi për Operacionet dhe Stërvitjen në Përfaqësinë e Përhershme Ushtarake të RSH-së në NATO-Bruksel-Belgjikë, Oficer shtabi për Personelin (PSE Staff Element) në Shtabin Ushtarak Ndërkombëtar IMS, të NATO-s në Bruksel-Belgjikë, Shef i Sektorit të Arsimimit të J1 në Shtabin e Përgjithshëm të FA, Shef i Sektorit të Marrëdhënieve dypalëshe në Drejtorinë e Politikave dhe Integritet të MM-së, etj.



Ministrja Xhaçka-Lufta me COVID-19

Mjekët e Forcave të Armatosura në frontin e parë të shërbimit

Të palodhur, të përkushtuar, në front të parë të luftës me COVID-19 por edhe të çdo shërbimi shëndetësor për komunitetin



Mjekët e Forcave të Armatosura janë prej kohësh në frontin e parë të luftës me pandeminë e COVID-19. Në shenjë mirënjohje e falënderimi për kontributin e tyre, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka ka publikuar ditën e mërkurë më 18 nëntor 2020, foto nga puna e përditshme e mjekëve në shërbim të efektivëve të FA, familjeve të tyre, por edhe qytetarëve.



“Të palodhur, të përkushtuar, në front të parë të luftës me COVID-19 por edhe të çdo shërbimi shëndetësor për komunitetin. Mirënjohje e respekt për të gjitha bluzat e bardha të Forcave tona të Armatosura, të cilët janë shtylla e fortë e mbështetjes për çdo efektiv të FA e familjeve të tyre, por edhe për çdo qytetar të vendit tonë në këto kohë të vështira”, shprehet në një postim në rrjetin social facebook ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka.





Qendra Stërvitore, Pashaliman

Përfundon kursi “Dhënia e ndihmës së parë dhe kujdesi shëndetësor”

Në mjediset e Qendrës Stërvitore, Pashaliman, ka përfunduar me 20 nëntor 2020, kursi “Dhënia e ndihmës së parë dhe kujdesi shëndetësor”, i cili zgjati rreth 10 ditë. Trajnimi pati njohuri të rëndësishme teorike, gjithashtu kursantët i kanë demonstruar dhe në mënyre praktike për të qenë në gatishmëri të menjëhershme

në dhënie të ndihmës së parë. Pjesëmarrës, ishte dhe komandant i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, shefi Shtabit të Forcës Detare kapiten i rangut II Sabri Gjinollari, të cilët i kanë vlerësuar dhe me certifikata mirënjohje kursantët. Komandanti i kursit, instruktorët përkatës dhe pjesëtarët e Flotiljes Detare, Pashaliman krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të këtij kursi.





FA e angazhuar nga Ngushtica e Hormuzit, KFOR dhe Sudanin e Jugut

Buxheti për mbrojtjen 2021, 1,5% e Prodhimit të Brëndshëm Bruto (PBB)

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me 16 nëntor 2020, në seancën plenare, me 84 vota pro, ligjin për buxhetin e vitit 2021. Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2021 vazhdon të jetë me trend rritës duke treguar angazhimin e vendit tonë për të plotësuar kriteret e vendosura nga NATO për të gjitha vendet anëtare të saj, ku në vitin 2024 ai duhet të zejë 2 përqind të Prodhimit të Brëndshëm Bruto të vendit.

Kështu në vitin 2020 buxheti i mbrojtjes ishte 1,46% e Produktit të Brëndshëm Bruto (PBB), për vitin 2021 buxheti shkon në 1,5% të PBB. Ky është një fakt domethënës, pasi kjo rritje është në përputhje të plotë me objektivat

FF Për të plotësuar priteret e NATO-s, Buxheti i Mbrojtjes duhet të shkojë në 1,75% të PBB në vitin 2022, 1,85% në vitin 2023 dhe 2% në vitin 2024.

dhe angazhimet që qeveria jonë ka marrë përpara aleatëve tanë-NATO në Samitin e Uellsit; angazhime, sipas të cilave Buxheti i Mbrojtjes duhet të shkojë në 1,75% të PBB në vitin 2022 dhe 1,85% në vitin 2023 dhe 2% në vitin 2024. Kurse në terma financiarë, buxheti i vitit 2021 ka një rritje me rreth 2,7 miliard lek ose 11,8% krahasuar me planin e vitit 2020.

“Buxheti i Mbrojtjes do të përdoret për mbështetjen e programeve të mbrojtjes të parashi-

kuara për vitet 2021-2023 siç janë mbështetja për personelin, operacionet brenda dhe jashtë vendit dhe emergjencat civile, stërvitjet, arsimit, angazhimet ndërkombëtare, e padyshim procesi i modernizimit të FA dhe përmirësimit të infrastructures”, ka deklaruar ministrja Xhaka, në mbrojtjen e këtij buxheti në parlament.

Buxheti i Mbrojtjes do të përdoret për mbështetjen e programeve të mbrojtjes të parashikuara për vitet 2021-2023 siç

janë mbështetja për personelin, operacionet brenda dhe jashtë vendit dhe emergjencat civile, stërvitjet, arsimit, angazhimet ndërkombëtare, e padyshim procesi i modernizimit të FA dhe përmirësimit të infrastrukturës.

Do të vazhdojnë misionet në Afganistanin në Operacionin e NATO "Resolute Support Mission"; në misionin "ALTHEA" në Bosnje-Hercegovine; në misionin KFOR të NATO-s në Kosovë; në operacionin ushtarak të NATO-s "Enhanced Forward Presence-eFP" në Letoni, në misionin në OKB në Sudanin e Jugut, por edhe në dislokime të reja, si në Misionin e NATO në Irak (kjo në kuadër të Kartës së Adriatikut), apo dhe në Ngushticën e Hormuzit në krah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, angazhim i cili është marrë, por pritet përfundimi i paketës ligjore.

Duhet të përmëndim edhe përfaqësitë ushtarake (atashetë ushtarake) në disa vende antare të NATO-s si SHBA, Francë, Britani, Gjermani, Turqi, etj. shtabet dhe aktivitetet me NATO (Bruksel, Moins) duke siguruar mbështetjen e personelit ushtarak e civil të angazhuar në shtabet e NATO, përfaqësitë ushtarake, atashetë ushtarakë dhe strukturat ushtarake rajonale.

Ne jemi pjesëmarrës në iniciativat e sigurisë rajonale dhe që prej vitit 2019 ne kemi marrë drejtimin e disa prej tyre, gjë e cila kërkon natyrisht mbështetje me fonde buxhetore. Konkretisht, kemi marrë drejtimin e Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore dhe të Sekretariatit të tij, si dhe të Qendrës për Bashkëpunim dhe Siguri. Në aspektin e stërvitjes, në vendin tone do të zhvillohet stërvitja më të mëdha që është zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri. Stërvitja "Defender-2021", një stërvitje dypalëshe me SHBA është e para

e këtij lloji në vendin tone ku do të marrin pjesë mbi 8.000 trupa amerikane që do të dislokohen në disa rajone të vendit dhe në disa reparte të Forcave tona të Armatosura. Nga ana tjetër trupat tona ushtarake marrin pjesë në disa strëvitje ndërkombëtare që zhvillohen në vende të tjera, me kostot e tyre financiare, pjesë e buxhetit 2021.

pjesëmarrjes së gjigandit të industrisë ushtarake amerikane Lockheed Martin si në Sistemin e Mirëmbajtjes së Vëzhgimit të Hapësirës Detare dhe atë të implementimit të Radarit të Midës për Forcën Ajrore. Pjesë e modernizimit janë edhe ndërhyrjet në infrastrukturë për të krijuar kushte optimale pune për ushtarakët, e padyshim edhe mbështetja e projektit të garantu-



Por impaktin më të madh në buxhetin e mbrojtjes e kanë projektet e modernizimit, plot 79.5% e shpenzimeve kapitale.

Në këtë kontekst këtë vit do të kemi një risi të shtuar, atë të


ar nga NATO për ringritjen e Bazës Ajrore të Kuçovës. Kurse si pjesë e trajtimit financiar është edhe rikthimi i kompensimit të ushqimit për mbi 4 mijë efektivë të FA që u hoq në fillim të vitit 2013.

Forcat e Armatosura shqiptare do të kenë syrin e tyre, që i mungonte, për vëzhgimin e hapësirës ajrore. Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, inspektori, më 6 nëntor 2020, radarin e spondërtuar dhe të vënë në punë në Midë të Pukës. Radari është investim i qeverisë shqiptare dhe qeverisë amerikane dhe projekti u zbatua nga kompania amerikane "Lockheed Martin". Ministria Xhaçka theksoi se ky është një nga investimet më të mëdha në Forcat e Armatosura, i cili do të ndiqet nga të tjerë, veçanërisht për Forcën Ajrore.

"Qeveria shqiptare përmes Ministrisë së Mbrojtjes, ka një vëmendje goxha të madhe ndaj përfundimit të kapaciteteve mbrojtëse të Forcave tona të Armatosura. Ky radar që shohim sot është pjesë e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore. Është një nga investimet më të mëdha të Ministrisë së Mbrojtjes, posaçërisht 22 milion dollarë, 19 prej të cilave investim i qeverisë shqiptare dhe 3 milion dollarë investim i qeverisë së SHBA në këtë projekt, i cili i mundëson vendit tonë të veprojë në përputhje me kërcënimet me të cilat përballlet Aleanca sot.

Ky sistem është produkt i bashkëpunimit me gjigantin e industrisë botërore ushtarake, kompaninë prestigjioze amerikane në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, 'Lockheed Martin', kompani e cila është angazhuar edhe në mirëmbajtjen e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës sonë Detare, ndërkohë që përmes këtij radari, qendrat operacionale në Forcën Ajrore dhe në Forcat e Armatosura, si pjesë

Për Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore u investuan 22 milion USD, ku 19 milion USD, nga qeveria shqiptare dhe 3 milion USD nga SHBA, në funksion të kërcënimeve me të cilat përballlet Aleanca





Investim i qeverisë shqiptare dhe qeverisë amerikane “Lockheed Martin” ndërton në Midë të Pukës vëzhguesin e Hapësirës Ajrore Shqiptare

e Aleancës ushtarake më të fuqishme në botë, kanë prej ditës së sotme një pamje të plotë dhe të qartë ajrore të territorit të Shqipërisë, duke mundësuar kështu edhe reagimin në përputhje me kërcënimet shumëdimensionale që Aleanca ka në epokën që po jetojmë. Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore është vërtet investimi më i madh

në këtë sektor, por Forca Ajrore prej vitesh është futur në një proces modernizimi, pjesë e të cilës do të bëhen edhe helikopterët 'Black Hawk', që pritet t'i shtohen pas pak muajsh Flotës sonë Ajrore ,apo projekteve të tjera që lidhen me sistemin ajror mbrojtës sipas standardeve të NATO-s." - u shpreh Xhaçka.

Helikopterët “Black Hawk” që

do të vijnë së shpejti, do të jenë investim në Kuçovë, së bashku me projektet që lidhen me sistemin ajror mbrojtës.

Projekti për radarin e sapo instaluar në malin e Midës në Pukës kushtoi 22 milion dollarë, 19 milion dollarë prej të cilave nga buxheti i shtetit dhe 3 milion dollarë donacion i qeverisë së SHBA-së.

Paisje luftarake për repartet e deklaruar në NATO

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Bajram Begaj zhvilloi më 9 nëntor 2020, një takim me atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë, kolonel Muhammet Kelami Kablay, në kuadër të akreditimit të tij në vendin tonë.

Gjeneralmajor Begaj, së pari i uroj suksese kolonel Kablay në detyrën e atasheut ushtarak të Turqisë dhe vlerësoi bashkëpunimin ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes atë rajonal, por edhe më tej, në kuadër të misioneve dhe aktiviteteve të NATO-s.

Bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve shtrihet në fushën e edukimit, trajnimit, shëndetësore, modernizimin, logjistikë si edhe misioneve të NATO-s,

“ Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Bajram Begaj, takohet me atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë, kolonel Muhammet Kelami Kablay

konkretisht kontingjenti i përbashkët ushtarak që shërben në Hamid Karzai International Airport, në Kabul, Afghanistan.

Gjeneralmajor Begaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e edukimit të brezave të rinj si dhe ushtarakëve të gradave të ulta dhe të larta në kurset dhe akademitë turke, si një kontribut për zhvillimin e lidërshiptit.

Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan Kursin e Lartë për Siguri dhe Mbrojtje, të zhvilluar nga Akademia e Forcave të Armatosura të RSH, ku marrin pjesë

edhe ushtarakë të lartë të Turqisë, ndërsa në lidhje me modernizimin e FA, asistencë turke ka qenë domethënëse në rritjen e kapaciteteve të emergjencave civile dhe modernizimin me pajisje luftarake të ndërveprueshme të reparteve të deklaruar në NATO.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, në emër të burrave dhe grave në uniformë të FARSH-it, përcolli ngushëllimet më të sinqerta për humbjen e jetëve të shkaktuar nga tërmeti i datës 30 tetor 2020 në Izmir, Turqi.



Komandanti i Forcës Tokësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj vizitoi ditën e mërkurë më 11 nëntor 2020, Forcën Tokësore. Qëllimi i kësaj vizite është diskutimi mbi çështjet e trajnimit, stërvitjes dhe bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet vendeve tona.

Fillimisht gjeneral brigade Hadërgjonaj u prit nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili nëpërmjet një prezantimi të shkurtër, i njohu vizitorët me misionin dhe detyrat kryesore të Forcës Tokësore.

Më pas, vizita vazhdoi në Batalionin "Komando" ku, për këtë qëllim, ishte përgatitur një mesim tregues nga efektivet e Kursit XVII Komando, pjesë e të cilit janë edhe kursantë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në përfundim të aktivitetit gjeneral brigade Hadërgjonaj falënderoi gjeneral Kingjin për mikpritjen, vlerësoi angazhimin dhe kontributin e Forcave të Armatosura shqiptare në

Bashkëpunim me Forcën Tokësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Qëllimi i kësaj vizite është diskutimi mbi çështjet e trajnimit, stërvitjes dhe bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet vendeve tona



kuadër të operacioneve të paqes, gjithashtu falënderoi efektivat e Kursit Komando, për performancën

e treguar gjatë demonstrimeve. Vizita u mbyll më një foto të përbashkët.

Misioni i Kombeve të Bashkuara

VKM: Për praninë e misionit të Forcave të Armatosura në Sudanin e Jugut

Këshilli Ministrave më datë 18 nëntor 2020, miratoi vendimin për "Një ndryshim në vendimin Nr.270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS), të ndryshuar".

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurave të vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr.64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të komandimit të Forcave të Armatosura të Repub-

Kobëzgjatja e misionit ushtarak shqiptar do të jetë deri në 22.9.2021



likës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr.1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)", miratuar me ligjin nr.23/2019, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi "në pikën 1, të vendimit nr.270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndry-



shuar, data 15.3.2021 ndryshohet dhe bëhet 22.9.2021". Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

Republika e Sudanit të Jugut është një vend pa dalje në det në Afrikën Lindore. Kryeqyteti i Sudanit të Jugut është Xhuba. Kufizohet me Etiopinë në lindje, me Kenin, Ugandan dhe Republikën Demokratike të Kongos në jug. Republika e Sudanit të Jugut e ka fituar pavarësinë më 9 korrik 2011 dhe ka rreth 8 milionë banorë.

Nga data 30 shtator deri më 5 nëntor, në bazën e trajnimeve ndërkom-bëtare Hohenfles, Gjermani u zhvillua stërvitja "KFOR-28". Vendi ynë në këtë stërvitje u përfaqësua me 99 efektivë të Kompanisë III të Batalionit II të Këmbësorisë (b2k). Në këtë stërvitje morën pjesë 6 shtete: Shqipëri, SHBA, Kosovë, Moldavi, Maqedoni e Veriut dhe Itali.


"Rreth 100 efektivë të Batalionit të Dytë të Këmbë-sorisë u stërvitën për më shumë se 1 muaj në Hohenfels të Gjermanisë me kolegët e tyre nga SHBA, Republika e Kosovës, Italia, Maqedonia e Veriut dhe Moldavia. Stërvitja KFOR-28 rrit ndërve-prueshmërinë e vendeve aleate dhe partnere gjatë operacioneve të paqes, duke testuar kryesisht patrullimin përgjatë kufirit, patrul-limin me mjete, pikat e vrojtimit dhe kontrollin e turmave", shkruan ministrja Xhacka në facebook.

Qëllimi i kësaj stërvitje ishte bashkëpunimi në zona opera-cionale gjithëpërfshirëse si dhe bashkëpunimi midis shteteve në kuadër të Operacioneve të Mbështetjes së Paqes.

"KFOR-28" bazohet në mjedi-sin e operacioneve aktuale dhe është i dizenuar për të për-gatitur njësitë për Operacione në Mbështetje të Paqes si dhe në mbështetje të autoriteteve civile. Trajnimi gjithashtu synon rritjen e ndërveprimit të trupave gjatë stërvitjes për Operacionet e Mbështetjes së Paqes dhe praktikimin e procedurave standarde të drejtimit të trupave.

"KFOR 28" ofron informacione paraprake dhe të mjaftueshme lidhur me mjedisin operacional, situatën sociale, politike, ushtarake dhe ekonomike në vend. Përveç aspektit të planifikimit trajnon të gjithë personelin në aspektin fizik, mental dhe tak-tik. Qëllim i këtij ushtrimi është

Qëllimi i kësaj stërvitje ishte bashkëpunimi në zona operacionale gjithëpërfshirëse si dhe bashkëpunimi midis shteteve në kuadër të Operacioneve të Mbështetjes së Paqes.



Në këtë stërvitje morën pjesë 6 shtete: Shqipëri, SHBA, Kosovë, Moldavi, Maqedoni e Veriut dhe Itali

ngritja e profesionalizmit të njësisë së MKAB-së, përgatitja e tyre për të vepruar dhe punuar në mjedis të kombinuar shumëkombësh si dhe shkëmbimi i përvojave. Ky ushtrim është vlerësues për trupat para zbarkimit për mision, përkatësisht

me fokus kryesor situatën aktuale në territorin e Kosovës.

Temat kryesore të cilat u zhvilluan duke respektuar të gjitha masat protokollare për mbrojtjen nga virusi COVID-19 ishin: patrullë e kufirit, patrullë me mjete, pikë vrojtimi, dhe



Baza e trajnimeve ndërkombëtare Hohenfles, Gjermani

Kompania III-të e Këmbësorisë në stërvitjen “KFOR -28”

kontroll turme. “KFOR - 28” mriti më tepër aftësitë individuale ndërvepruese të ushtarakëve shqiptarë në mjediset multinationale duke rritur njëkohësisht edhe aftësitë profesionale të personelit drejtues officer dhe nënoficer.



Profesionalizëm, sakrificë dhe përkushtimin

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi më 6 nëntor 2020, një vizitë njohëse në Batalionin III të Këmbësorisë (b3k), në kuadër të takimeve me repartet e varësisë së Forcës Tokësore.

Në takimin e zhvilluar me komandantin e Repartit Ushtarak 1030, gjeneral brigade Kingji u njoh më konkretisht me punën dhe angazhimet e tyre të përditshme si dhe mjediset e punës dhe stërvitjes, në interes të realizimit të misionit si një nga repartet kryesore të Forcës Tokësore. Komandanti i Forcës Tokësore duke vlerësuar efektivat e b3k për angazhimet dhe arritjet e tyre të deritanishme, theksoi mbështetjen e pakursyer që ata do të kenë gjithmonë nga ana e tij dhe Shtabit të FT.

“Ju garantoj ju dhe efektivat që ju drejtoni, se tek unë do të gjeni gjithmonë mbështetjen maksimale, për realizimin e çdo detyre sado e

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, vizitë në Batalionin e III të Këmbësorisë



vështirë të jetë. Unë besoj se puna e përbashkët në grup, mbështetja që ne duhet t'i japim njëri - tjetrit, do të na i bëjë sfidat me të lehta dhe më të përballeshme. Profesionalizmin, sakrificën dhe

përkushtimin tuaj, unë e kam parë edhe më përpara si komandant i këtij batalioni. Vazhdoni të mbani lart moralin dhe shpirtin e krenarisë”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kingji.

Në kujdesin e Gardës së New Jersey

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit EOD (Explosive Ordnance Disposal) Niveli II.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndrçim Sallaku, pjesëtarë nga Shtabi i Komandës Mbështetëse si dhe komandantët e strukturave të saj.


Në fjalën përsëritëse komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndrçim Sallaku, falënderoi nëntë kursantët për rezultatet e arritura dhe instruktorët e tyre ndër të cilët dy ishin ekspertë të Gardës së New Jersey. “Me ndihmën e këtyre kurseve kapaciteti EOD do të zhvillohet dhe rritet më shumë në të ardhmen për të kontribuar deri në nivel rajonal.” - u shpreh gjeneral brigade Sallaku.

Ky kurs shërben një kohësisht edhe për zgjidhjen e detyrave të ndryshme EOD brenda dhe jashtë vendit si në operacione luftarake ashtu edhe në ato joluftarake”. Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikatat për të gjithë kursantët. Në kurs morrën pjesë 9 vetë, kryesisht nga Batalioni i Xhenios.

Përfundon Kursi EOD, çertifikohen 9 kursantë

Me ndihmën e këtyre kurseve kapaciteti EOD do të zhvillohet dhe rritet më shumë në të ardhmen për të kontribuar deri në nivel rajonal





MJEDISI STËRVITOR I BATALIONIT TË FORCAVE SPECIALE

Zhvillohet stërvitja “Rural Surveillance and Patrol Training”

Nga data 2 deri 20 nëntor në mjediset stërvitore të Batalionit të Forcave Speciale dhe Poligonit Kombëtar të Bizës u zhvillua stërvitja “Rural Surveillance and Patrol Training”. Kjo stërvitje u zhvillua me efektivët e Batalionit të Forcave Speciale shqiptare dhe një grupi të Batalionit të Dytë të Regjimentit të Dukës së Lankasterit (2LANCS) të Mbretërisë së Bashkuar. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është shkëmbimi i eksperiencave dhe rritja e ndërveprueshmërisë ndërmjet aleatëve të NATO.

Stërvitje ishte konceptuar në dy faza: faza e parë teorike u fokusua në mësimdhënie dhe marrje njohurish, ndërsa faza e dytë përmbajti zhvillimin e veprimeve praktike taktike.

Ndër temat kryesore që u zhvilluan në këtë stërvitje ishin: planizimi, zbulimi special, njohuri armatimi, xhenio, shëndetësi, patrullim në këmbë dhe me mjete, llojet e rendimeve të luftimit në këmbë dhe me mjete, rënie në kontakt me kundërshtarin, mbulimi dhe kamuflimi, zënia e pikës së vrojtimit, goditje objekti, etj.

“ Stërvitja u zhvillua me efektivët e Batalionit të Forcave Speciale shqiptare dhe një grupi të Batalionit të Dytë të Regjimentit të Dukës së Lankasterit (2LANCS) të Mbretërisë së Bashkuar. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është shkëmbimi i eksperiencave dhe rritja e ndërveprueshmërisë ndërmjet aleatëve të NATO.



Lejtnant Andi Gjeçi, përfundon Kursin Ndërkombëtar të Oficerit të Detarisë

Kualifikimi i ushtarakëve shqiptarë në Akademitë e vendeve të NATO-s, një investim dhe garanci për një Forcë të Armatosur me leadership Euro-Atlantik.

Bashkëpunimi ushtarak në fushën e arsimit me SHBA, por jo vetëm, vijon të furnizojë Forcën e Armatosur me drejtues oficer e nën/oficer të një niveli të lartë.

Çdo vit janë me dhjetëra ushtarakë të të gjitha niveleve që kualifikohen në Akademitë dhe shkollat ushtarake më të mira të SHBA-së.

I diplomuari më i fundit është lejtnant Andi Gjeçi, i cili sapo përfundoi me sukses Kursin Ndërkombëtar të Oficerit të Detarisë, në Shkollën e Rojës Bregdetare, në Virxhinia të SHBA dhe u specializua në fushat si kërkim-shpëtimi në det, bordingu, siguria detare, ligjshmëria në det, leadershipi dhe menaxhimi.

Kualifikime të tilla janë një kërkesë për Forcën tonë Detare, ku kontribu-



ti i ardhshëm i lejtnant Gjeçi do të jetë një vlerë e shtuar për trajnimin e detarëve drejtues, në përmbushje të misionit të njësive detare.



FORCA DETARE

Ditën e merkure, datë 11 nëntor, anija e FD, P-110, "Shqypnia", zhvilloi një operacion shpëtimi në rajonin 20 milje në jug-perëndim të portit të Shëngjinit. Me marrjen e sinjalit se një mjet peshkimi me emrin "Kristiani" kërkonte ndihmë urgjente, efektiv i motovedetës "Shqypnia" së bashku me anije të tjera që ndodheshin në rajon, bënë të mundur gjetjen e mjetit dhe çuarjen e saj në portin e Shëngjinit. Operacioni u drejtua nga personeli përgjegjës i FD në bashkëpunim me QNOD.

Shpëtohet anija e peshkimit "Kristiani" në Shëngjin



Kursi i Stërvitjes Individuale Bazë, çertifikohen 107 rekrutë të rinj

“Dita e sotme është e veçantë për ju, vijoi përshëndetjen Kolonel Dimo, pasi do të betoheni si ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ju do të betoheni para flamurit tonë kombëtar, për ti qëndruar besnik atdheut, detyrës dhe ligjit”.

Në mjediset e Qendrës së Arsimimit Profesional të Ushtarëve Vlorë me datë 06.11.2020, pavarësisht kufizimeve të imponuara nga pandemia e “Covid-19”, u zhvillua ceremonia e Certifikimit dhe Betimit të rekrutëve, të cilët përfunduan kursin e Stërvitjes Individuale Bazë. Në përfundim të këtij kursi u certifikuan 107 rekrutë, të rinj e të reja, nga mbarë vendi, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave tona të Armatosura.

Në ceremoni mori pjesë edhe Drejtoresha e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë në AFA, znj. Blerina Vorpsi, e cila shprehu vlerësime për rekrutët e sapo certifikuar dhe konsiderata të veçanta për ceremoninë e zhvilluar.

Fjalën e rastit në këtë ceremoni e mbajti Komandanti i QAPU, Kolonel Ferdinand Dimo, i cili falënderoi personelin trajnues, ku ndër të tjera theksoi: “Ndihe mi krenar për produktin e punës suaj, për këtë forcë të madhe ushtarake që keni stërvitur, për përpjekjet e vazhdueshme tuaja në drejtim të konsolidimit të sistemit të stërvitjes së ushtarit të Forcave të Armatosura, për ambicien tuaj për të zbatuar standarde të avancuara në procesin stërvitor, për

gjithçka që ju keni bërë për edukimin e këtyre të rinjve, tashmë të denjë për të shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura”.

Në veçanti, Komandanti i QAPU falënderoi rekrutët e sapo certifikuar: “Ju shpreh mirënjohjen time për përkushtimin dhe seriozitetin treguar, për atë që ju reflektuat gjatë stërvitjes këtu në Bunavi. Jam i sigurt se dijet dhe aftësitë e fituara do t’ju shërbejnë për të rritur më tej profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrave në repartet e Forcave të Armatosura ku do të shërbeni”.

“Dita e sotme është e veçantë për ju, vijoi përshëndetjen Kolonel Dimo, pasi do të betoheni si ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ju do të betoheni para flamurit tonë kombëtar, për ti qëndruar besnik atdheut, detyrës dhe ligjit”.

“Në këtë ditë të shënuar, krahas jush janë rreshtuar oficerët tuaj të ardhshëm, kursantët ushtarak të sistemit pasuniversitar dhe bachelor. Ata sapo kanë filluar rrugën e bukur të jetës ushtarake. Në emrit tuaj dhe gjithë pjesëmarrësve i uroj atyre suksese dhe gjithë të mirat”. Mes urimeve më të mira rekrutët u përcollën nga Bunavia për në repartet e Forcave të Armatosura.



Certifikohen 60 kursantë në Kursin e 45-të Bazë të Nënoficerit

Në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve me datë 4.11.2020, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit 45-të Bazë të Nënoficerëve. Në këtë ceremoni mori pjesë Komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, Komandanti i Kurseve, personeli mësimdhënës dhe mbështetës si dhe kursantët që janë aktualisht në kurse.

Kursi Bazë i Nënoficerit (faza I-rë), u zhvillua në QAPN për një periudhë 8-javore dhe ka pasur si qëllim zhvillimin e elementëve themelore të personalitetit të tetarit si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyra të njësuara me të, edukimin dhe përgjegjësinë ndaj detyrës dhe gatishmërisë luftarake, në zbatimin e urdhrave dhe forcimin e disiplinës vetjake.



Përvetësimi i njohurive të marra në modulet: Drejtim-Komandim, Informatikë, Formim Politik, Metodikë-Didaktikë, Histori Ushtarake, Rregullore/Ligjshmëri, Taktikë, SHLT, Përgatitje Zjarri dhe Përgatitje Fizike, luajtën rol kryesor në formimin e tyre si komandantë të ardhshëm skuadre.

Përfundimi i këtij kursi me sukses

nga 60 kursantë, dëshmoi edhe njëherë punën e bërë nga kursantët dhe instruktorët, duke evidentuar qartë faktin që ky kurs, e arriti qëllimin dhe pse u realizua në kushtet e zbatimit të masave mbrojtëse anti covid-19. Mbyllja e ceremonisë u finalizua me shpërndarjen e 60 certifikatave për personelin që përfundoi me sukses kursin.

Në Gjirin e Vlorës dhe rajonin Bristan, Kepi i Gjuhëzës

Në rajonin e Gjirit të Vlorës u zhvillua stërvitja FLOTEX-20, ndërsa në rajonin e qitjeve me artileri Bristan-Kepi i Gjuhëzës u zhvilluan qitjet detare me artilerinë e anijeve.

Qëllimi kryesor i stërvitjes ishte rritja e ndërveprueshmërisë ndërmjet mjeteve detare të Flotiljes, me anë të zhvillimit të stërvitjes sipas procedurave të zbatimit të ligjshëm detare për Operacionet e Ndalimit Detar dhe Kërkim-Shpëtim-it (SAR), si dhe realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenar të supozuar.

Stërvitja u zhvillua me pjesëmarrjen e anijeve: P-131, P-132, P-134, P-112, P-116, P-03 dhe P-02. Gjatë zhvillimit të stërvitjes kishte dhe përfaqësues nga Shtabi i Forcës Detare, Shtabi i Flotiljes Detare Pashaliman, 1 skuadër e Grupit të Bordingut, 3 gomonet e

Zhvillohet stërvitja me artilerinë e anijeve "FLOTEX-20"



anijeve të klasit Iliria dhe elementë të Mbështetjes Shëndetësore.

Kjo stërvitje shërbeu për vlerësimin dhe certifikimin e Flotiljes De-

tare Pashaliman. Qitjet detare me artilerinë e anijeve u realizuan me sukses të plotë pavarësisht kushteve jo të favorshme meteorologjike.

Keshilli Ministrave, datë 25 nëntor 2020

Komiteti i Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimi ndërinstytucional

Komiteti i Mbrojtjes Civile i cili është organi më i lartë, i përhershëm, përgjegjës për zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile kryesohet nga ministri i Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka

Më datë 25 nëntor 2020, Keshilli Ministrave, me firmën e Kryeministrit Edi Rama, mori vendimin, "Për funksionimin e organizimit e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimit ndërinstytucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të Mbrojtjes Civile". Vendimi është marre në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave.

Sipas vendimit, pranë Këshillit të Ministrave krijohet e funksionon Komiteti i Mbrojtjes Civile (në vijim, KMC), i cili është organi më i lartë, i përhershëm, përgjegjës për zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë.

KMC-ja kryesohet nga ministri i Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka dhe ka në përbërje: ministrin e Brendshëm; ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme; ministrin e Financave dhe Ekonomisë, ministrin e Infrastrukturrës dhe Energjisë; ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; ministrin e Turizmit dhe Mjedisit; ministrin e Drejtësisë; ministrin e Kulturës; drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; drejtorin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore; drejtorin e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore; kryetarin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

Në varësi të nevojave, në mbledhjet e KMC-së ftohen edhe përfaqësues nga institucione shkencore dhe monitoruese, drejtues të strukturave qendrore, organizata



joqeveritare etj.

KMC-ja mbledhet, sa herë gjyko-
het e nevojshme nga kryetari i
tij, për çështje që kanë të bëjnë
me zbatimin e politikave në bash-
kërendimin e punës për zvogëli-
min e riskut ndaj fatkeqësive dhe
mbrojtjen civile. Të drejtën e pro-
pozimit për thirrjen e mbledhjes
së KMC-së, përveç kryetarit të
tij, e ka edhe çdo ministër, sipas
fushës së përgjegjesisë dhe llojit
të fatkeqësisë.

KMC-ja zbaton politikat që kanë
të bëjnë me vlerësimin e riskut
nga fatkeqësitë në nivel qendror,
Strategjinë Kombëtare për Zvogë-
limin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe
Planin Kombëtar të Emergjencave
Civile dhe, nëpërmjet ministrit
përgjegjës për mbrojtjen civile,
propozon ndryshime apo përditë-
sime të tyre.

KMC-ja është autoriteti më i
lartë i përhershëm që bashkëren-
don e koordinon veprimtaritë dhe
aktivitetet ndërinstytucionale të
institucioneve e të strukturave
dhe të të gjitha subjekteve të përf-
shira në mbrojtjen civile. KMC-ja,
me kërkesë të prefektit, në rast
se vlera e kompensimit tejkalon 8
(tetë) % të buxhetit të bashkisë,
merr vendim për kompensimin e
dëmeve nga Agjencia Kombëtare
e Mbrojtjes Civile.

Pranë AKMC-së ngrihet e
funksionon sekretariati teknik i
KMC-së, i cili është përgjegjës
për përgatitjen e materialeve të
mbledhjes dhe për njoftimin e
anëtarëve të KMC-së për mbled-
hjen e radhës, jo më vonë se 10
(dhjetë) ditë përpara datës së zh-
villimit të saj. Përbërja e sekretari-
atit teknik të KMC-së përcaktohet
me urdhër të drejtorit të Përgjith-
shëm të Agjencisë Kombëtare të
Mbrojtjes Civile.

Çdo ministër është përgjegjës
për zvogëlimin e riskut nga fat-
keqësitë dhe mbrojtjen civile në
fushën e përgjegjesisë shtetërore
të institucionit që drejton, nëpër-
mjet sektorit për mbrojtjen civile.
Ministritë hartojnë plane, pro-
grame e dokumente të tjera që
kanë për qëllim zvogëlimin e riskut
nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen
civile, sipas llojit të veprimtarisë

e përgjegjesisë së tyre.

AKMC-ja koordinon në mënyrë të
përqendruar shpërndarjen e kapaci-
teteve logjistike dhe njerëzore, të
caktuara për përballimin e emergjen-
cave civile apo të fatkeqësive.

10. Sektorët për mbrojtjen civile
pranë ministrive duhet të zbatojnë
me shpejtësi dhe efektivitet kërkesat
e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes
Civile për përballimin e emergjencave
civile apo të fatkeqësive.

Sektorët për mbrojtjen civile në
ministritë përkatëse aktivizojnë, me
kërkesë të AKMC-së, kapacitetet e
parashikuara për emergjencë civile,
për të reaguar me shpejtësi dhe
efektivitet në rastin më të parë
të mundshëm, por asnjëherë më
vonë se 2 (dy) orë. Në situatat e
emergjencave civile, komunikimi
ndërinstitucional mbahet duke përdorur
kanalet zyrtare të komu-
nikimit. Në rastet e komunikimit

këtij vendimi.

Institucionet e strukturat ven-
dore, që bashkëpunojnë me insti-
tucionet dhe strukturat qendrore
dhe të tjera për mbrojtjen civile,
janë komisionet e mbrojtjes civile
në nivel qarku e bashkie, të cilat
veprojnë nën drejtimin e prefektit
të qarkut e të kryetarit të bashkisë.
Në përbërje të strukturës së ad-
ministratës së prefektit funksionon
sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes
Civile. Prefekti bashkërendon me
bashkitë brenda territorit admin-
istrativ të tij për planifikimin pranë
tyre të strukturave të përhershme
të planifikimit e të mbrojtjes civile.
Komunikimi me publikun, në rastet
e fatkeqësive natyrore/fatkeqësive,
kryhet nga ministria përgjegjëse për
mbrojtjen civile.

Vendimi nr. 965, datë 2.12.2015,
i Këshillit të Ministrave, "Për bash-
këpunimin ndërinstytucional të struk-



verbal, sektorët për mbrojtjen civile
pranë ministrive regjistrojnë dhe
ruajnë përmbajtjen e bisedave, të
njoftimeve apo të kërkesave të
marra e të dhëna përmes përdor-
imit të mjeteve të teknologjisë së
informacionit. Institucionet dhe
strukturat operacionale kryesore
shtetërore, përgjegjëse për përbal-
limin e emergjencave civile apo të
fatkeqësive, janë ato të përcaktuara
në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij
vendimi, të cilat angazhohen menj-
ëherë me kërkesë të AKMC-së.

Për përballimin e emergjencave
civile me specifika të veçanta, me
kërkesë të AKMC-së, mund të an-
gazhohen edhe autoritete e insti-
tucione të tjera shtetërore, përveç
atyre të parashikuara në lidhjen 1 të

turave të drejtimit, në rastet e
emergjencave civile dhe krizave",
shfuqizohet. Ngarkohen Ministria
e Mbrojtjes, Ministria e Brend-
shme, Ministria për Evropën dhe
Punët e Jashtme, Ministria e Fi-
nancave dhe Ekonomisë, Ministria
e Infrastrukturës dhe Energjisë,
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvil-
limit Rural, Ministria e Arsimit,
Sportit dhe Rinisë, Ministria
e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale, Ministria e Turizmit dhe
Mjedisit, Ministria e Drejtësisë,
Ministria e Kulturës, Agjencia
Kombëtare e Mbrojtjes Civile
dhe të gjitha institucionet, sipas
lidhjes 1, për zbatimin e këtij
vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas
botimit në "Fletoren zyrtare".

Rëndësia e forcës Fizike në Ushtritë moderne

Gjorgji VELJOVSKI

S tresi fizik i luftës moderne nuk është reduktuar aspak më parë. Përkundrazi, ai është rritur relativisht saktësisht për shkak të nocionit të rremë se teknologjia dhe armatimet moderne do të lehtësojnë luftën. Ushitari i sotëm është mësuar sistematikisht me përfitimet e teknologjisë dhe ekziston një tendencë për të injoruar, ose relativizuar rëndësinë e forcës fizike. Ushtritë moderne gjithnjë e më shumë alarmohen për nevojën e ruajtjes së standardeve të aftësisë fizike, sepse ekziston një perceptim se vetëm disa specialitete kanë nevojë për forcë fizike. Pas mijëvjeçarëve të luftërave botërore, sot kuptimi dhe nevoja për forcë të zhveshur fizike po rishikohet. Trajnimi fizik zhvillon aftësi ushtarake që janë thelbësore për sigurinë personale të një ushtari dhe për kryerjen në mënyrë efektive detyrat luftarake. Shkathtësitë themelore që çdo ushtar duhet të dijë janë akoma vrapimi, kërcimi, ngjitja, zvarritja, noti dhe ngritja e peshave.

Atletika konsiderohet mbretëresha e sporteve, sepse disiplinat e saj datojnë që nga kohërat antike dhe është një demonstrim i aftësive ushtarake. Karakteristikat fizike të ushtarit gjithmonë kanë qendruar si superiore ndaj atyre, që nuk ishin ushtarë. Sportistët e parë ishin ushtarë që garuan në vrapim, në hedhjen e shtizës dhe gurit, kërcim në distance dhe kërcim në lartësi, aktivitete që në atë kohë i kërkoheshin një ushtari në fushën e betejës. Maratoni i parë ishte Filipidisi, korrieri që barti mesazhin nga Maratona në Athinë për fitoren ndaj Persianëve në vitin 490 para Krishtit. Në kohët e lashta, palestra dhe ushtrimet fizike konsideroheshin si një virtut i njeriut. Platoni

Të luftuarit evoluon për shkak të mënyrës së përdorimit të luftës dhe mjeteve të përdorura, por natyra e luftës, siç përshkruhet më së miri nga Clausewitz, është «një fushë e sforcimeve fizike dhe vuajtjeve» dhe do të mbetet gjithmonë e pandryshuar

dhe Aristoteli theksuan ushtrimin dhe gjendjen fizike të njerëzve si një politikë shtetërore dhe strategji ushtarake dhe diçka, që ndikon në psikologjinë dhe jetën intelektuale të njerëzve.

Kjo filozofi u pranua gjithashtu nga romakët në thënien e famshme "Mens sana in corpore sano" (në një trup të shëndetshëm ekziston një mendje e shëndetshme). Ushtarët romakë njiheshin më shumë për aftësinë e tyre për të lëvizur dhe fortifikuar. Ndërtimi i kampeve pasoi menjëherë pas marshimit të qindra kilometrave me të gjitha pajisjet individuale dhe kolektive. Sukses i ushtrisë romake ishte për shkak të disiplinës, e cila u mbajt me punë manuale. Kur nuk lëviznin dhe luftonin, legjionarët kaluan kohën duke ndërtuar infrastrukturë, stërvitje dhe trajnime. Ka shembuj të tjerë të panumërt nga historia, që konfirmojnë faktin se forca fizike ka qenë gjithmonë jo vetëm e qenësishme, por edhe thelbësore për luftën dhe ushtrinë. Njohja doktrinale e gatishmërisë fizike të ushtrive fillon me reformën e parë të madhe të çështjeve ushtarake në shekullin e XVII. Në kohë kur krijoheshin shtetet moderne kombëtare, ushtritë profesionale dhe disiplina e fuqisë ushtarake. Stërvitja e ushtarit, në të cilën theksohej forca fizike, ishte për shkak të zhvillimit të aftësive operacionale në shekullin e XIX, ku lëvizshmëria në fushën e betejës ishte çelësi i fitores. Marshimet e gjata dhe të shpejta të ngarkesave ishin thelbësore në Luftërat Napoleonike.

Trupat franceze mund të udhëtonin deri në 50 kilometra në ditë dhe të

luftonin menjëherë. Napoleoni lëvizi njësitë brenda marshit një ditor. Ishte një risi në fushën e betejës, një përqendrim i shpejtë i të gjitha njësive në një moment pasi njëra prej tyre të kontaktojë me armikun. Kjo kërkonte forcë të madhe fizike. Lufta e Dytë Botërore pa mobilizimin më të madh të njerëzve për luftë në historinë njerëzore. Më pas u vu re për herë të parë që mënyra moderne e jetës, shkenca dhe teknologjia, kishin ndryshuar në mënyrë drastike karakteristikat fizike të ushtarëve. Makineritë, automjetet dhe mjetet e krijuara për të lehtësuar punën fizike dhe për të rritur produktivitetin kanë zvogëluar aftësitë fizike të një personi mesatar. Sot, efektet e mënyrës moderne të jetesës në aftësitë fizike janë edhe më të mëdha. Një person mesatar sot, nëse nuk merret me sport, nuk do të përmbushte normat e qëndrës dhe forcës së një personi mesatar të së kaluarës, edhe pse për shkak të mjekësisë moderne ai është shumë më i shëndetshëm dhe ka një jetëgjatësi më të madhe. Ndër përpjekjet e para për të përfshirë forcën fizike në doktrinën ushtarake ishte manuali amerikan FM 21-20 i vitit 1946.

Pas analizës së stresit fizik në fushën e betejës gjatë Luftës së Dytë Botërore, ky manual vuri bazat e aftësisë ushtarake, ushtrimeve fizike, të cilat, ndryshe nga sportet, duhet të zhvillojnë ato karakteristikat, që një ushtari i duhen vërtet gjatë luftës. Është identifikuar, që përveç forcës, qëndrueshmërisë dhe shkathtësisë, një ushtar duhet të zhvillojë një ndjenjë të lidhshimit, iniciativës, stabilitetit

emocional dhe vullnetit për të fituar. Për herë të parë, janë futur pengesa që simulojnë terrenin në fushën e betejës. Ky rregull gjithashtu përcakton për herë të parë kriteret për kontrollet fizike për të monitoruar përparimin e ushtarit. Trajnimi ditor ushtarak lidhet drejtpërdrejt me aftësinë fizike. Fuqia fizike e një ushtari zvogëlon gjasat e lëndimit gjatë stërvitjes. Përveç kësaj, ka shumë trajnime specifike që kërkojnë një nivel veçanërisht të lartë të aftësisë fizike.

Për të qenë në dispozicion të ushtrisë, disa shkolla dhe kurse ushtarake kërkojnë që të plotësohen kriteret e rrepta fizike. Dhe e gjithë kjo është larg stresit të vërtetë fizik në fushën e betejës në një luftë të vërtetë. Prandaj, forca fizike duhet parë si një domosdoshmëri dhe një parakusht për profesionin ushtarak. Trajnimi fizik në ushtri është një kombinim i pjesës teknike, mendore dhe fizike. Teknika është e nevojshme për të zhvilluar njohuri dhe aftësi në luftime, mentaliteti për të nxitur motivim dhe dëshirë për të fituar, dhe ana fizike për të fituar forcë dhe qëndrueshmëri. Efektiviteti në luftime varet kryesisht nga aftësia fizike. Ushtari pritet të ketë forcë të madhe, qëndrueshmëri, shkathtësi dhe koordinim të trupit. Pavarësisht nga teknologjia, ushtari modern do të jetë ende në gjendje të udhëtojë në distanca të gjata me pajisje, armë dhe municione, pothuajse gjithmonë përtej terrenit të keq dhe në kushte të vështira atmosferike. Ngritja e sendeve të rënda është e zakonshme në profesionin ushtarak.

Detyra më e thjeshtë, siç është ngarkimi dhe shkarkimi i një kamioni, është një aktivitet fizik, që kërkon forcë dhe teknikë. Ushtarët vazhdojnë të kryejnë detyra të vështira, pavarësisht nga teknologjia dhe pajisjet moderne. Por roli më i rëndësishëm i aftësisë fizike është se ajo ndikon drejtpërdrejt në aftësinë mendore dhe emocionale të moralit të ushtarit. Një ushtar që është i përgatitur fizikisht është më lehtë të merret me lodhjen, raskapitjen fizike dhe angazhimin shumë ditor pa pushim. Forca fizike rrit vetëbesimin e një ushtari, sepse ai e di që ai është më elastik ndaj stresit fizik. Ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen e qetësisë në momente të vështira. Një njësi ushtarake është aq e fortë sa hallka më e dobët. Kjo nënkupton nevojën për punë ekipore në qasjen e ushtrimeve. Programi i ushtrimit duhet të harmonizohet në mënyrë të tillë që të gjithë në njësi të zhvillohen afërsisht me kriteret e kërkuara. Cilësia e njësisë vlerësohet në përputhje me aftësinë fizike totale të të gjithë anëtarëve. Përvojat nga situatat reale kanë treguar se është shumë më e rëndësishme për komandantin

nëse të gjithë në njësi përgatiten afërsisht në të njëjtin nivel sesa kur disa individë bëjnë përjashtime. Puna në ekip dhe fryma e ekipit duhet të pasqyrohen në të gjitha fushat, dhe kjo është veçanërisht e saktë kur njësi po përballet me një sforcim të rëndë fizik. Kjo është arsyeja pse në ushtri është e rëndësishme të stërviteni së bashku në krahasim me vendosjen individuale të rekordeve. Në të gjitha ushtritë është vërtetuar se gjëja më e rëndësishme për zhvillimin e frymës kolektive të njësisë ushtarake është stërvitja e përbashkët e sinkronizuar e mëngjesit. Kjo është një metodë për t'i sjellë të gjithë, në mënyrë kolektive, në një nivel të përafërt për sa i përket forcës fizike. Angazhimi i ushtarit për të ruajtur kulturën fizike, i kombinuar me një mënyrë jetese të shëndetshme, do të ndikojë drejtpërdrejt në efikasitetin e kryerjes së detyrave të përditshme e në përgjithësi, në gatishmërinë luftarake. Prandaj, detyra për udhëheqësin është të inkurajojë, mirëmbajë dhe forcojë këtë.

Drejtuuesi në çdo nivel duhet të sigurojë që ushtarët janë të përgatitur fizikisht, sepse ushtria është një pro-

janë të përgatitur psikofizikisht, kanë rezultate më të mira për sa i përket disa kriterëve në aftësitë profesionale, efikasitetin dhe shpejtësinë në kryerjen e detyrave, mendimin kritik, komunikimin me anëtarët e tjerë, forcën mendore, dhe përbalimin e situatave stresuese. Trupi i njeriut duhet parë si një makinë e përbërë nga trupi dhe mendja (pjesa fizike dhe mendore). Të dy pjesët duhet të trajnohen në mënyrë të barabartë. Një ushtar, që ushtron çdo ditë ka më shumë energji sesa ai që nuk bën. Ushtrimet fizike të përditshme e mbajnë ushtarin zgjuar dhe energjik gjatë gjithë ditës. Në nivelin strategjik, duke ruajtur sistematikisht gatishmërinë fizike të ushtrisë, rreziku i lëndimit dhe sëmundjes zvogëlohet. Stresi i luftës moderne imponon nevojën që të gjithë ushtarët të jenë të aftë fizikisht, pavarësisht nga specialiteti i tyre. Në çdo gjini apo shërbim, kërkohet një nivel i lartë i aftësisë fizike, sepse herët a vonë, ushtari do të gjendet në një situatë ku jeta e tij dhe kryerja e detyrës do të varet nga ajo.

Në një njësi ushtarake, nëse jo të gjithë janë të përgatitur në të njëjtin



fesion sfidues psikofizikisht. Kryerja e detyrave të përditshme në kohë paqeje dhe gjatë luftës kërkon një shkallë të konsiderueshme të forcës në këmbët, krahët, shpinën dhe barkun e ushtarit. Ushtrimet e rregullta dhe të forta rritin madhësinë dhe forcën e muskujve. Është më mirë që ushtari të zbatojë stërvitje funksionale, e cila është simulim i aktiviteteve në kryerjen e detyrave të përditshme. Përmes arteve marciale, një ushtar zhvillon aftësi specifike të tilla si shkathtësia, vetëbesimi, gatishmëria, shkathtësia dhe agresiviteti, dhe përmes veprimtarive konkurruese të situatës ndërton punën ekipore, vullnetin për të fituar, solidaritetin dhe aftësinë për të menduar dhe vepruar shpejt nën presion. Në shumë vende të NATO-s, kohë dhe fonde të veçantë janë caktuar për të kryer kërkime dhe analiza të marrëdhënies midis rezultateve të punës së ushtarit dhe gatishmërisë së tij psikofizike.

Praktika tregon se ata ushtarë që

nivel, ose standardi do të bjerë, ose ankhin do të rritet për shkak të shpërndarjes së pabarabartë të ngarkesës së punës. Një ushtar i përgatitur psikofizikisht mund të bëjë më shumë sesa ai që nuk është i përgatitur. Ushtari modern është i armatosur dhe i pajisur me mjete të shumta që peshojnë, dhe ato duhet të barten në fushën e betejës. Edhe në ato vende pune ku nuk ka pajisje dhe veshmbathje, nivelet e stresit mund të jenë të larta. Ushtarët e trajnuar psikofizikisht kanë provuar të jenë mëndërisht më të qëndrueshëm në situata kur kërkohet shumë punë brenda një kohe të shkurtër. Gatishmëria e lartë luftarake e një ushtari kërkon shëndet të mirë, forcë mendore, rezistencë ndaj lëndimit dhe qëndrueshmëri. Palestra fizike prek individin, por edhe ekipin. Njësi ushtarake është aq e fortë sa më e dobëta dhe aq e shpejtë sa ushtari më i ngadaltë.

Tradita që pasurohen në vijimësi nga Forcat e Armatosura

Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Ushtria kombëtare shqiptare është vepër e shqiptarëve

4 Dhjetor 1912, ushtarakët shqiptar festojnë ditëlindjen e FA-së. Në këtë datë lartësohen në kujtesën historike të Atdheut brez i ushtarakëve që me kurajo, me besim dhe me ide fisnike krijuan Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare (Luftës). Madhështia e aktit të kryer, pavarësisht përpjekjeve të regjimeve të ndryshme për denigrim, për të harruar, apo mënjeluar, kjo datë ka zënë vend në kujtesën kombëtare. Shtetet kombëtare nuk krijohen nga aktorë të jashtëm, qofshin këta dhe Fuqi të Mëdha, në qoftë se nuk ekziston një popull që ka nevojë për shtetin e vet. Prof. Kristo Frashëri ka theksuar se asnjë nga popujt e Ballkanit nuk ka zhvilluar gjatë shekujve aq shumë kryengritje kundër zgjedhës osmane sa shqiptarët.

Në periudhën e shkurtër të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, Ushtria shqiptare, e re dhe e brishtë, e udhëhequr dhe drejtuar nga gjeneral Mehmet pashë Dërralla, major Shefqet Ali Shkupi dhe oficeri të tjerë atdhetarë, të cilët kishin shërbyer në radhët e Ushtrisë së Perandorisë Osmane, bënë ç'ishte e mundur. Kjo ushtri e përbërë kryesisht nga strukturat rezerviste, vullnetarë, xhandarë dhe më pak forca aktive, e kryen detyrën e vështirë, në

kushte kur vijonte Lufta Ballkanike, për mbrojtjen e pavarësisë së arritur me shumë përpjekje të shtetit të sapokrijuar dhe të rendit.

Zhvillimet politike shoqërore të viteve 1912-1920, shënojnë një etapë të veçantë në historinë e popullit tonë. Kjo periudhë shërbeu për të kristalizuar tiparet, pikëpamjet, mendimet dhe karakteristikat daluese të një kombi, si dhe përpjekjet për të qenë të organizuar në përballim të sfidave politike e ushtarake për sigurimin e mbijetesës.

Rreth konceptit dhe mendimit ushtarak

Gjatë viteve në vijim 1921-1924,

dhe përdorimin e Fuqive të Armatosura dhe të Ushtrisë në veçanti, sipas niveleve bashkëkohore të përparuara. Në këto vite morën formë tiparet e Ushtrisë shqiptare, si ushtri e kohës gjithnjë në kërkim të vetvetes. U hodhën gradualisht bazat e organizimit të mirëfilltë e të qëndrueshëm ushtarak me imazh bashkëkohor. Përgjatë këtij harku kohor 1925-1939, u bënë përpjekje për t'u integruar me filozofi e konceptime perëndimore, por duke ruajtur traditën, me veçori e përshtatshmëri kombëtare. U synua dhe u arrit në strukturën e organizimit, e pajisjes, e armatosjes dhe e përgatitjes së saj. Në këto vite u bë shkëputja nga mendësitë dhe



mori formë dhe spikati më qartë koncepti dhe mendimi ushtarak për ndërtimin, organizimin, stërvitjen

nga format e vjetra dhe tradicionale të stërvitjes, duke përzgjedhur dhe zbatuar një infrastrukturë ligjore të



nevojshme të kohës. U plotësua hap pas hapi përmes miratimit të bllokut të ligjeve përcaktues për krijimin, organizimin, pajisjen, arsimimin e kualifikimin, shërbimin ushtarak, trajtimin ekonomik e financiar deri më 1939, ku gjetën mbështetje fillimisht në status me vlera kombëtare, duke u dhënë fuqinë e duhur ligjore. Njëherësh, u punua për krijimin e një kuadri të domosdoshëm me rregullore, të cilat rregulluan organizimin, jetën dhe veprimtarinë e Ushtrisë shqiptare.

Pavarësisht përpjekjeve të Shqipërisë dhe Italisë për të krijuar një ushtri shqiptare të aftë për të ruajtur dhe mbrojtur pavarësinë e Shqipërisë, kjo nuk dha fryte. Ushtria shqiptare nuk mund të ngrihej kundër sundimtarëve të saj. Kështu spontanisht, vetëm disa dhjetra ushtarakë dhe më pak nënreparte të veçuara, së bashku me vullnetarë popullorë, i bënë një qëndresë disa orëshe pushtuesve të huaj të shpërndarë në drejtimet kryesore të zbar-kimit. Ky ishte një mesazh dhe një mësim për Forcat e Armatosura, për ushtarakët dhe gjithë popullin, në raportin e tyre ligjor e profesional ndaj politikës, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me zbatimin e misionit kushtetues për mbrojtjen e atdheut.

Lëvizja antifashiste

Gjatë pushtimit të Shqipërisë, në vitet e Luftës së Dytë Botërore, lindën forca të armatosura, joqeveritare, fillimisht në formë e përmasa të vogla nacionaliste. Pas Konferencës historike e pluraliste të Pezës, këto forca u zgjeruan dhe fituan përkatësinë politike të PKSH, të Ballit Kombëtar, të Legalitetit etj. Forca e armatosur më e madhe në numër, e cila paraqiti një skemë organizative me formacione më të qëndrueshme sulmuese, të cilat erdhën në rritje, ishte Ushtria Nacionalçlirimtare Partizane Vullnetare, që zotëronte një fuqi të madhe goditëse, disiplinë dhe shpirt të lartë luftarak. Procesi organizativ dhe veprimtaria luftarake e saj drejtohej nga një Shtab i Përgjithshëm profesional. Kjo ushtri pati një mbështetje të gjerë në popull. Deri në fund të nëntorit të vitit 1944 numëronte 70.000 luftëtarë të rreshtuar në 24 brigada, 8 divizione sulmuese dhe 3 korpomata, si dhe në dhjetra formacione territoriale në tërë sipërfaqen e vendit.

Përvojë të veçantë në pikëpamje të organizimit ushtarak e më gjerë përbëjnë dhe formacionet luftarake të drejtuara nga Balli Kombëtar dhe Legaliteti, përvojë që meriton të trajtohet.

Dukuri e formacioneve partizane

ishte se në krye të shtabeve drejtuese e në komandat e tyre luftarake, që u krijuan në vitet e Luftës Antifashiste, drejtuan një numër i madh ish-oficerë e nënoficerë të karrierës, që vinin nga radhët e ish-ushtresë shqiptare. Ata drejtuan me kompetencë dhe aftësi profesionale procesin organizativ dhe luftarak në rritje të kësaj ushtrie. UNÇSH ishte vijuese e traditave dhe vlerave më të mira luftarake të popullit shqiptar.

Përvojë krejt të veçantë, që konfirmoi Lufta Antifashiste dhe UNÇSH, me sistemin e saj të organizimit, ishte afirmimi i parimit të vullnetarizmit. Sipas këtij parimi, edhe nëse asnjë ligj nuk arrin të realizojë mobilizimin e detyruar, atëherë shtetasit rrëmbejnë armët vullnetarisht dhe bashkohen në emër të një ideali të lartë, siç është lufta për liri. Ende është e padrejtë, që për hir të pësimit historik, e që nuk është fenomen shqiptar, të minimizojmë e deri të injorojmë rolin e UNÇSH, fitoren në Luftën e Dytë Botërore, rëndësinë e madhe që pati për kombin shqiptar aderimi i LANÇ në Shqipëri në Aleancën Antifashiste Botërore.

Ndryshime dhe reforma

Ushtria shqiptare, e quajtur Kombëtare prej 10 korrikut 1945

deri në korrik 1949 dhe pas kësaj deri në vitet 1990 Ushtria Popullore, kaloi përmes një zinxhiri të gjatë ndryshimesh e reformimesh. Ushtria u riorganizua sipas një koncepti dhe filozofie tjetër, duke provuar skema të reja organizimi dhe vendosjeje, në raport me kërkesat dhe situatat politiko-ushtarake të kohës, për një mbrojtje sa më të sigurt. Nga mesi i viteve '60 disiplina, koncepti për stërvitjen dhe përgatitjen luftarake u përsosën, si dhe armatimi dhe teknika luftarake. Arsimimi i oficerave pati rritje cilësore pasi shkollimi i lartë dhe kualifikimi pas akademik bëhej në akademitë më të njohura të ish-B.S. Me futjen e armatimit dhe teknikës luftarake, lindën dhe disa armë e shërbime të reja si aviacioni luftarak, radiozbulimi, mbrojtja kundërkimike etj., dhe u përsosën ato ekzistuese. Fuqia mbrojtëse e vendit u rrit, ndërsa ushtria në 1955 u anëtarësua në Traktatin e Varshavës dhe veçoi pothuajse si një armatë e tij prej nga doli në vitin 1968.

Tablo ndryshe paraqiten FA mbas vitit 1966 deri në fillim të viteve 1990. Në ushtri u hoqën gradat ushtarake, u rivendos posti i komisarit politik dhe u forcua ndjeshëm roli i Partisë së Punës në komandat e të gjitha niveleve. Në kuadrin e Luftës së Ftohtë dhe në përputhje me konceptin politik të kohës e të vetizimit, Ushtria shqiptare mori përmasa të mëdha. Kështu deri në fillim të viteve 1990 Ushtria shqiptare, duke tejkaluar madje dhe raportet e aplikuara nga vet Traktati i Varshavës, kishte 61.000 ushtarake aktiv, ose mbi 2% të popullsisë, 360.000 rezervistë dhe 200.000 forca vullnetare territoriale, pa folur për mobilizimin e rinisë shkollore e studentore të armatosur. Ndërsa në përputhje me një nga parimet e mbrojtjes së vendit "pëllëmbë për pëllëmbë", ushtria la gazerat dhe u shpërnda në afro 2.200 pika hapje e garnizone ushtarake në të gjithë sipërfaqen e vendit. Gjithsesi, gjatë kësaj periudhe mjaft të gjatë, parësisht nga sistemi në fuqi, që u ndihmua dhe nga aleatët ideologjikë, kurdoherë ushtria dhe gjithë FA u

përpoqën dhe ia dolën të kryejnë misionin e tyre kryesor, mbrojtjen e tërësisë tokësore të vendit.

Ndryshime rrënjësore në FA

Rënia e sistemit politik dhe zhvillimet demokratike në Shqipëri në fillim vitin 1990 ishte e natyrshme që kërkoi një varg ndryshimesh rrënjësore e rinovimesh dhe në FA të vendit. Në këtë proces kompleks e të vështirë, ushtria veçoi përgjithësisht me një frymë demokratike dhe luajale, duke demonstruar se e donte dhe mbështeste demokracinë. U shënuan arritje në ripërqendrimin e forcave dhe të mjeteve luftarake, në hapjen dhe lidhjen e ushtrisë me ushtrinë e vendeve të tjera, në arsimimin e kualifikimin e qindra ushtarakeve në shkollat perëndimore, si dhe lidhja me organizma ushtarake ndërkombëtarë etj. Ndër kohë u përfshimë në nismën Partneritet për Paqe (PfP), u fut linja e kontrollit civil në ushtri, si dhe përpjekje u bënë për departizimin dhe çideologjizimin e forcave ushtarake.

Reforma nuk ia arriti të dalë në sferën praktike, veçanërisht në linjën e departizimit të jetës dhe të veprimtarisë së ushtrisë. Shkurtime e pastuduara, emërtimet dhe gradimet, përzgjedhja e oficerëve për kualifikime brenda dhe jashtë vendit etj., u panë shpesh si një çështje personash e funksionesh dhe jo gjithmonë si një çështje e strategjive të zhvillimit dhe obligimit profesional. Mjaft oficerë që u larguan nga reforma u privuan nga trajtimi ekonomik, si dhe një masë e tyre gati u izoluan nga kontaktet me repartet e institucionet ku kishin investuar energjitë më të mira atdhetare e profesionale.

Ngritja e një force ushtarake moderne

Historia e Forcave të Armatosura shqiptare në ditëlindjen e 108 të saj të na shërbejë për ringjalljen e vetëdijes se gjithçka të bukur e fisnike, si vetë historia e FA-së, që nuk asgjëson vetveten, se humbjet janë të përkohshme, se ato mund

të jenë deri diku kalendarike, aspak shpirtërore, ideale, intelektuale e profesionale. Të gjitha këto kanë një interes, ngritjen e forcave ushtarake moderne.

Përvoja 108-vjeçare e Ushtrisë sonë, ruan vlera progresive e pozitive sidomos kur arritjet janë të dukshme dhe, që meritojnë të shfrytëzohen. Theksoj se çdo komb dhe vend i zhvilluar, një forcë e armatosur moderne, nuk mund të bëhet e tillë pa piketat e traditës, dmth të veprës së drejtuesve dhe të personaliteteve të shquara që përfaqësojnë atë, sepse "burrat e shtetit dhe luftëtarët e vërtetë e gjejnë rrugën dhe në errësirë vetëm nëse ata nuk injorojnë dritat që kanë lënë paraardhësit". Përvoja jonë e ka vërtetuar vlerën e kësaj aksiome, se një ushtri pa tradita rrezikon të mbetet pa individualitete.

Anëtarësimi në NATO, na ka bërë pjesë të veçantë të mbrojtjes kolektive për herë të parë në historinë e shtetit tonë të pavarur. Ky anëtarësimi në NATO ka motivuar për një qeverisje demokratike, për institucione të forta shtetërore, për udhëheqje të aftë e të orientuar nga interesi kombëtar, gjithmonë duke vlerësuar vendndodhjen gjeostrategjike, burimet e bollshme dhe klimën shumë të mirë të Shqipërisë. FA kanë kohë që po shpalosin performancë të përsosur në misionet paqerujtëse, duke evidentuar dhe njëherë vlerat tona kombëtare. Angazhimi ynë mbetet solemn, me rrënjë tek detyrimi ynë ndaj Atdheut, Nderit dhe Detyrës. Historia e Forcave tona të Armatosura përcjell bindshëm mësimin se idealet njerëzore i paraprijnë një mosbindjeje të përherëshme, universale ndaj së keqes. Kjo është ajo që ideuan dhe luftuan themeluesi i shtetit modern shqiptar Ismail Qemali dhe bashkëluftëtarët e tij. Dhe kjo doktrinë zbatohet plotësisht tek FA, mbartësit dhe garantuesit e vazhdimësisë së mbrojtjes së shtetit dhe traditave kombëtare në momentet e rëndësishme të historisë.



Ministri i Mbrojtjes Anton Quni priti në takim Këshilltarin e Transformimit të Mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor, gjeneral brigade Johnny Bowron. Në takim, ministri Quni e njoftoi gjeneral brigade Bowron me zhvillimet në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Sigurisë së Kosovës, të arriturat gjatë procesit aktual të tranzicionit dhe sfidat e shfaqura gjatë krizë aktuale të pandemisë COVID-19. Ai, ndër të tjera shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për rolin dhe kontributin e madh të shtetit, qeverisë dhe Forcave të Armatosura Britanike në ndërtimin dhe zhvillimin e gjithmbarshëm të Kosovës, vet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës. Në takimin e radhës me brigadierin Bowron, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama theksoi se partneriteti me Forcat e Armatosura Britanike do të vazhdojë të jetë i fuqishëm në perspektivën tonë zhvillimore për të arritur aftësitë, kapacitetet dhe standardet më të larta operacionale.

Nga ana e tij, brigadieri Bowron shprehu vlerësimin e lartë për strategjinë e tranzicionit të MM/FSK-së si dhe të arriturat e deritashme duke shprehur mbështetjen nga autoriteti zyrtar dhe eksperiencën e tij për këtë proces edhe në të ardhmen. Ministri Quni gjatë takimit shoqërohej nga këshilltari i tij ushtarak, kolonel Hamdi Pollomi dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritime Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha.



MINISTRI ANTON QUNI TAKON GJENERAL BRIGADE JOHNNY BOWRON

Mbretëria e Bashkuar mbështet procesin e tranzicionit të FSK-së

Këshilltari i Transformimit të Mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor, gjeneral brigade Johnny Bowron në Prishtinë



AMBASADORI GJERMAN NË PRISHTINË, JOERN ROHDE

Firmoset marrëveshja për dhurimin e fondeve për FSK-në

Në Ministrinë e Mbrojtjes, zëvendës Sekretari i Përgjithshëm, Faruk Geci, nënshkroi dy marrëveshje për dhurimin e fondeve të radhës nga qeveria gjermane për nevojat e sistemit të mbështetjes operationale të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) së FSK-së. Për shkak të masave kufizuese anti-covid nënshkrimi u bë në ambiente të ndara. Z. Geci nënshkroi në emër të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës si palë pranuese, pas nënshkrimit të ambasadorit gjerman në Prishtinë, Joern Rohde, në emër të Ministrisë Federale të Mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë, nga pala dhuruese. Sipas programit gjerman “Mundësimi dhe rritja e sigurisë, mbrojtjes dhe stabilitetit të vendeve partnere”, pala gjermane dhuroi donacionin e radhës në vlerë prej 350,000 euro, të cilat sipas marrëveshjeve përkatëse do të përdoren ekskluzivisht për qëllime të prokurimit të

Sipas programit gjerman “Mundësimi dhe rritja e sigurisë, mbrojtjes dhe stabilitetit të vendeve partnere”, pala gjermane dhuroi donacionin e radhës në vlerë prej 350,000 euro



pajisjeve për avancimin e sistemit të mbështetjes logjistike dhe operationale të KDS-së. Me këtë rast në prani edhe të këshilltarit bilateral gjerman në Ministrinë e Mbrojtjes, nënkolonel Armin Dausch, zëvendës sekretari Geci, në emër të ministrit të Mbrojtjes dhe ko-

mandantit të FSK-së shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e lartë për shtetin gjerman për donacionin e radhës si dhe mbështetjen e pandërprerë dhe shumë të rëndësishme në zhvillimin e përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Këshilltari ushtarak Italian në Ministrinë e Mbrojtjes

“Medaljen për shërbim të shquar” për kolonel Vincenzo Stella

Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni priti në takim lamtumirës këshilltarin ushtarak Italian në Ministrinë e Mbrojtjes, kolonel Vincenzo Stella. Me këtë rast, ministri Quni shprehu falënderimin dhe mirënjohjen për angazhimin e tij me përkushtim të lartë profesional duke ofruar eksperiencën e tij të gjatë të udhëheqësit

ushtarak për stafin e Ministrisë së Mbrojtjes. Nga ana e tij, kolonel Stella, shprehu përshtypjet e tij të veçanta gjatë mandatit të tij për Ministrinë e Mbrojtjes dhe stafin e saj duke theksuar admirimin e tij për të arriturat e deritashme të FSK-së dhe vizionin e saj për të ardhmen.

Në shenjë mirënjohje për

angazhimin e tij, ministri Quni i ndau “Medaljen për shërbim të shquar”. Në takim lamtumirës morën pjesë edhe këshilltari politik, Feriz Trezhnjeva, drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha dhe zyrtarja e lartë e kabinetit, Martina Dedaj-Kçira.



Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, priti ambasadorin e Republikës së Hungarisë në Kosovë, József Bencze në vizitën e tij të parë në Ministrinë e Mbrojtjes. Në fillim, ambasadori Bencze vlerësoi lart rëndësinë e partneritetit në mes dy ministrive duke shprehur gatishmërinë e shtetit hungarez dhe institucioneve të saj në mbështetjen e mëtejme të FSK-së për arritjen e objektivave të saj. Ministri Quni, nga ana e tij falenderoi për vizitën dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen e deritashme të Hungarisë në të gjitha fushat, përmes kontributit me kontingjentin ushtarak në kuadër të KFOR-it, në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve operationale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Ai gjithashtu kërkoi ofrimin e eksperiencës për procesin reformues të FSK-së si dhe eksperiencën e zbatuar të institucioneve hungareze për procesin integruar euroatlantik në NATO.

Ministri Quni, në vazhdim theksoi se Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, janë në proces të realizimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, proces i cili zhvillohet në transparencë të plotë, dhe si gjithmonë, në koordinim të plotë me partnerët tanë.

Në fund të dy bashkëbiseduesit u pajtuan për vazhdimin e bashkëpunimit në funksion të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë. Në takimin përkatës, Ministri Quni shoqërohej nga këshilltari i tij politik, Feriz Trezhnjeva, kurse ambasadori Bencze shoqërohej nga sekre-



MINISTRI QUNI, PRITI AMBASADORIN E HUNGARISË, JÓZSEF BENCZE

Eksperienca hungareze në procesin reformues të FSK-së

tari i dytë i ambasadës hungareze, Zoltan Gulyas. Marrëveshja dypalëshe e bashkëpunimit në mes Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës (ish-Ministrisë së FSK-së) dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë, është nënshkruar më 10

qershor 2016 në Budapest. Marrëveshja përcakton bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe stërvitjes, shkëmbimit të përvojave në menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e krizave, rrugën e integriteteve euroatlantike etj.

Në Poligonin e stërvitjeve taktike në fshatin Cernushë

Zhvillohet stërvitja fushore katërditore “Ujku vigjilent-02”

Në Poligonin e stërvitjeve taktike në fshatin Cernushë, u realizua Stërvitja Fushore katërditore “Ujku vigjilent-02” me demonstrimin stërvitor përmbyllës të Kompanisë së Mekanizuar të Regjimentit të Tretë të Forcave Tokësore të FSK-së. Për të parë nga afër demonstrimin e operationeve stërvitore, ishin ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj dhe atasheu ushtarak i SHBA-së, major Bret Wisecup. Ata u pritën nga zëvendëskomandanti i Regjimentit të Tretë, major Ilir Beqiri, dhe komandanti i Kompanisë së Mekanizuar, toger Bardhyl Dugolli, të cilët njoftuan lidhur me konceptin, njësitë e angazhuara, përbërjen e tyre, organizimin, skenarët si dhe kurset e veprimt të cilat u ekzekutuan në stërvitjen përkatëse. Pas demonstrimit stërvitor, pjesëtarëve të task-forcës pjesëmarrëse në stërvitje iu drejtua ministri i Mbrojtjes, Anton Quni i cili shprehu impresionet e tij për nivelin e lartë të profesionalizimit të demonstruar gjatë stërvitjes. “Ky nivel profesional, kjo shkallë e angazhimit dhe përkushtimit janë faktori determinues i besimit të plotë në ju. Kërcënimet ndaj nesh fare nuk na brengosin, sepse fitues është ai që mbron vendin e vet”,- tha ndër të tjera ministri Quni.

Zhvillohët stërvitja pesëditore fushore “Ujku Alfa-1”

Në poligonin e stërvitjeve kolektive taktike të FSK-së në Babaj të Bokës, u realizua Stërvitja fushore “Ujku Alfa-1” me demonstrimin stërvitor pesëditor të shkathtësive operuese të njësiteve të Komandës së Regjimentit të Parë të Këmbërorisë së Forcave Tokësore për realizimin (certifikimin) e detyrave të mbrojtjes territoriale. Në këtë ngjarje të veçantë, morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rrahman Rama dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralbrigade Fadil Hadërgjonaj dhe oficerë tjerë të lartë të FSK-së. Ata u pritën nga komandanti i Regjimentit të Parë të Këmbërorisë, nënkolonel Albert Kuçi i cili me stafin e tij njoftuan lidhur me aktivitetet e zhvilluara në stërvitjen përkatëse, të arriturat, sfidat dhe qëllimin final të saj.

Në vijim, para fillimit të demonstrimit stërvitor, fjalën e mori ministri i Mbrojtjes Anton Quni i cili duke përshëndetur trupat e Regjimentit të parë të Këmbërorisë për këtë arritje të veçantë ndër të tjera u shpreh se Forcat e Sigurisë së Kosovës kanë shënuar një pikë kthese në historinë e tyre, duke treguar aftësitë dhe kapacitetet e para ushtarake në nivel skuadre për mbrojtjen territoriale të vendit dhe pjesëmarrjen dinjitoze krahas për krahas forcave aleate në operacione paqeruajtëse. “Validimi i këtyre skuadrave shënon përmbushjen më të rëndësishme deri më tani të detyrave tona që dalin nga Plani Gjithëpërfshirës i Tranzicionit. Me krenari këtë hap

Kompania e Regjimentit të Parë të Këmbërorisë gjatë stërvitjes iu nënshtrua një sërë skenarësh, të përgatitur mbi praktikat më të mira të vendeve të NATO-s



cilësor mund ta quajmë një ngjarje të veçantë në historinë e forcave tona”, - theksoi më tej ministri Quni. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rrahman Rama vlerësoi lartë validimin e skuadrave të para të Regjimentit të Parë të Këmbërorisë, si një arritje të veçantë, që i dedikohet punës, disiplinës, sakrificës dhe profesionalizmit të të gjithë personelit të kësaj njësie, për të cilët, ai shprehu edhe falënderimet dhe mirënjohjen e tij personale. “Procesi i validimit sa krenari për ne më shumë nënkupton përgjegjësi dhe sakrificë. Ne do të vazhdojmë tutje deri në realizimin e plotë të objektivave strategjike dhe vizionit tonë për të ardhmen” - tha ndër tjera gjeneral Rama.

Kompania A e Regjimentit të

Parë të Këmbërorisë gjatë stërvitjes nga data 26.10.2020 iu nënshtrua një sërë skenarësh, të përgatitur mbi praktikat më të mira të stërvitjes dhe vlerësimit të vendeve të NATO-s bazuar në doktrinat e Aleancës të forcave këmbësore, duke testuar kapacitetet zotëruese operacionale, por edhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e luftimit. Demonstrimi stërvitor u përmbyll me zhvillimin e operacionit luftarak në stacionit e fundit dhe konfirmimin e suksesit të plotë nga ana e gjeneral Hadërgjonaj. Në këtë atmosferë të veçantë u ndanë edhe gradat për dy oficerë të angazhuar në stërvitje, respektivisht kapitenin e ri, Dritan Hoti dhe togerin e ri, Valdrin Pollomi.

MINISTRJA E MBROJTJES, RADMILLA SHEKERINSKA

Ministrja e mbrojtjes, Radmilla Shekerinska mori pjesë në takim në Këshillit të Atlantikut të Veriut të NATO-s, në nivelin e ministrave të mbrojtjes, përmes video konferencës.

Shekerinska në takim falënderoi NATO-n për ndihmën me vlerë prej 1.4 milion euro për 60 aparate për frymëmarrje dhe pajisje shtesë mjekësore, një lëvizje që konfirmon se solidariteti dhe gatishmëria për të ndihmuar çdo aleat është pasuria më e madhe e Aleancës.

“Sfidat kërkojnë një përgjigje serioze dhe për këtë arsye investimi në mbrojtje dhe ndarja e barrës financiare të sigurisë kolektive është i rëndësishëm,” - u tha në takim, duke përshëndetur përparimin e shumicës së vendeve anëtare të NATO-s për arritjen e një pjese të parashikuar të 2% të PBV-së të mbrojtjes, Maqedonia e Veriut mbetet e përkushtuar në angazhimin për të rritur vazhdimisht buxhetin e mbrojtjes dhe për të arritur 2% të PBV-së në vitin 2024, si dhe alokimin e 20% të buxhetit për pajisjet dhe modernizimin në vitin 2021.

Një nga temat kryesore të takimit ishte rritja e qëndrueshmërisë shoqërore, me ç'rast ministrat e mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s miratuan rekomandime për ndërtimin e kapaciteteve dhe rritjen e bashkëpunimit civil-ushtarak. “Sfidat moderne shkojnë përtej mbrojtjes dhe ushtrisë dhe kërkojnë një qasje të koordinuar dhe një përgjigje të përbashkët të të gjithë shoqërisë,” - konkluduan ministrat në seancën e sotme të Këshillit të Atlantikut të Veriut.

Ministrat e Mbrojtjes miratuan vendim për ndërtimin e një qendre hapësinore në Gjermaninë jugperëndimore, gjegjësisht në bazën Ramshtajn, duke theksuar se qëllimi i NATO-s nuk është të militarizojë hapësinën, por të rrisë ndërgjegjësimin për sfidat dhe gatishmërinë për t'u marrë me to.



Buxheti i mbrojtjes 2021: 20% për modernizimin e ushtrisë

Maqedonia e Veriut mbetet e përkushtuar në angazhimin për të rritur buxhetin e mbrojtjes 2% të PBV-së në vitin 2024 dhe 20% të buxhetit për modernizimin në vitin 2021

Në diskutimin për misionet paqeruajtëse dhe operacionet në Afganistan, Irak dhe Kosovë, ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska tha se Maqedonia e Veriut vazhdon të marrë pjesë në misionin “Mbështetje e Vendosur” në Afganistan dhe njoftoi se jemi në proces të përgatitjes për të dërguar një ekip kirurgjikal në bashkëpunim me Mbretërinë e Norvegjisë. Ajo shtoi se prania jonë në Afganistan do të rregullohet në përputhje me planet e tërheqjes së NATO-s mbi parimin “Së bashku brenda-Së bashku jashtë”. Ministrja gjithashtu nënvizoi kontributin e ri të 44 pjesëtarëve të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut brenda forcës së KFOR-it në Kosovë, i cili do të rritet gjatë vitit të ardhshëm dhe numri i përgjithshëm do të jetë 180

ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, ndërsa ky është një konfirmim i gatishmërisë së Armatës sonë për të investuar në paqen dhe sigurinë e rajonit. Ministrat e mbrojtjes të NATO-s gjithashtu, me kërkesë të qeverisë Irakiane, kanë miratuar një direktivë mbi një mision të zgjatuar jo-luftarak të NATO-s në Irak për të trajnuar dhe këshilluar forcat e sigurisë irakiane. Ministrja Shekerinska për këtë çështje tha se është planifikuar që Maqedonia e Veriut të marrë pjesë me pesë anëtarë në këtë mision, si pjesë e një ekipi trajnues mobil për trajnim dhe këshillim, në kuadër të iniciativës A5.

Takimi tjetër i Këshillit të Atlantikut të Veriut të NATO-s në nivelin e ministrave të Mbrojtjes do të mbahet në fillim të vitit 2021.

Armata maqedonase: 44 pjesëmarrës në KFOR u nisën drejt Kosovës

Kontingjenti i parë maqedonas me 44 pjesëmarrës të Armatës u nis nga kazerma „Kuzman Josifovski-Pitu“ në Tetovë, drejt Kosovës, ku në gjashtë muajt e ardhshëm do të punojnë si oficerë shtabi në komandën kryesore të KFOR-it në Prishtinë dhe do ta sigurojnë komandën rajonale të KFOR-it Perëndim.

Me pjesëmarrjen në misionin KFOR në Kosovë, Maqedonia e Veriut zë pozitën në NATO si një vend që nënkupton paqe, siguri dhe stabilitet në Ballkan.

Në ceremoninë me rastin e dërgimit të këtij kontingjenti të parë në Kosovë, i cili u mbajt së fundmi, ministrja Shekerinska tha: “Ne kemi treguar se cilat janë cilësitë tona në vende shumë të largëta. Tani e tutje do të tregojmë

“ Pjesëmarrja e pjesëtarëve të Armatës në misionin e KFOR-it në Kosovë do të vazhdojë të rritet gjatë vitit 2021

vendin tonë të vërtetë në rajon. Anëtarësimi në NATO do të thotë siguri dhe stabilitet për ne, do të thotë siguri nën ombrellën kolektive të Aleancës, por e ndiejmë atë anëtarësim si një përgjegjësi të madhe. Më pak se 20 vjet më parë, vendi ynë përdori rastin për të pasur një mision të NATO-s për të pasur siguri dhe stabilitet. Sot, si një anëtar i NATO-s, ne mund të ndihmojmë që kjo të ndodhë me fqinjët tanë. Dhe kjo tregon se sa kemi shpenzuar së bashku, sa probleme kemi kapërcyer dhe sa jemi pjekur si njerëz dhe si shtet”.

Pjesëmarrja e pjesëtarëve të

Armatës në misionin e KFOR-it në Kosovë do të vazhdojë të rritet gjatë vitit 2021-tashmë në rotacionin tjetër, plani është që të rritet numri i pjesëtarëve të KFOR-it në mbi 60 anëtarë, dhe nga vera e ardhshme së bashku me partnerin tonë të kahershëm Gardën Kombëtare të Vermontit nga SHBA, jashtë rotacioneve të vendosura, kontributi në një periudhë prej 9 muajsh do të rritet me mbi 100 pjesëtarë të Armatës. Gjithsej rreth 180 ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të Armatës së Maqedonisë së Veriut do të marrin pjesë në misionin e KFOR verën e ardhshme.



Ushtria do pajiset me 67 mjete “Oshkosh” me vlerë 35 milionë USD

Ministri i Mbrojtjes, Predrag Bošković, mori pjesë më 30 tetor 2020, në prezantimin e automjeteve të reja të blinduara të lehta “Oshkosh” me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Malin e Zi, Judy Rising Reinke dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Malit të Zi, Gjeneral Major Dragutin Dakić.

Pas kësaj dite, absolutisht asgjë nuk do të jetë e njëjtë për Ushtrinë e Malit të Zi. “Ceremonia e sotme është një tregues i asaj që mund të bëjmë së bashku me partnerët tanë në një kohë të shkurtër, në një mënyrë transparente, efikase dhe më të mirë për interesat e shtetit, dmth Ushtrisë së Malit të Zi,”- tha Bosković, duke falënderuar kështu partnerët amerikanë.

Pesë automjete “Oshkosh” mbërritën në Malin e Zi, javën që kaloi dhe këto ditë do mbërrijnë 15 të tjera, kurse dhe deri në 2023 do plotësohet tërë kontrata për 67 automjete të blinduara. Këto automjete do të pajisin dy struktura të këmbësorisë të deklaruara të Ushtrisë së Malit të Zi, një përparësi e nivelit më të lartë sipas Planit të Zhvillimit të Mbrojtjes të Malit të Zi për periudhën nga 2019 deri në 2028.

“Automjetet do të sigurojnë manovrim, aftësi mbrojtëse, por edhe një forcë zjarri krejtësisht të ndryshme të njësive tona të këmbësorisë, e cila do t’u mundësojë njësive tona të stërviten, stërviten, dhe më vonë të marrin pjesë në misionet me partnerët tanë, por me burimet e tyre, pa pasur nevojë të përdorin logjistikën e partnerëve. Kjo është diçka për të cilën kemi punuar me përkushtim dhe intensivisht,”- vuri në dukje Ministri Boskovic. Në prezantimin në kazeremat “Milovan Sharanovic” në Danilovgrad, Ministri gjithashtu falënderoi ekipin e tij. “Unë jam i lumtur që pas katër vitesh në Ministrinë e Mbrojtjes,

“ Mali i Zi dhe SHBA-ja nënshkruan një marrëveshje për automjetet e blinduara në tetor të vitit të kaluar me vlerë 36.165.105 dollarë



ne kemi krijuar një ushtri që është më e aftë dhe më e shkathët, dhe mbi të gjitha një ushtri që është e gatshme ta vërë veten në shërbim të çdo qytetari të Malit të Zi në periudhën e mëpasshme”,- përfundoi ministri Bošković.

Ambasadorja e SHBA në Malin e Zi, Judy Rising Reinke, gjithashtu shprehu mirënjohjen e saj për bashkëpunimin, duke thënë se Mali i Zi hapi rrugën me blerjen e automjeteve dhe u bë vendi i parë evropian që përdori makina të lehta taktike të blinduara “Oshkosh”. “Mali i Zi është i pari nga të gjithë aleatët evropianë të NATO-s që prokuron automjetet e lehta të blinduara ushtarake më të përparuara në botë. Në muajt e ardhshëm, aleatë të tillë si Sllovenia, Belgjika, Lituania dhe Mbretëria e Bashkuar do të bashkohen me Malin e Zi dhe do të sigurojnë këto automjete të blinduara, të cilat do t’u mundësojnë vendeve të përmendura të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin gjatë stërvitjeve shumëkombëshe dhe misionëve të përbashkëta

brenda operacioneve të NATO-s”,- tha ajo. Ajo shtoi se automjetet përfaqësojnë një investim shumë të rëndësishëm në aftësitë e ushtrisë malazeze dhe tregojnë një arritje të rëndësishme në rrugën e përpjekjeve të vazhdueshme për ta modernizuar atë.

“Shtetet e Bashkuara kanë privilegjin të jenë në gjendje të llogarisin Malin e Zi si një mik, partner dhe aleat. Ne jemi gjithmonë me njerëzit e Malit të Zi, si në këto mundësi të bukura, ashtu edhe në kohë të vështira, siç është kriza aktuale shëndetësore. “Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë pa mëdyshje t’i sigurojnë mbështetje Malit të Zi në rrugën e tij drejt Perëndimit, anëtarësia e së cilës në NATO është përbërësi kryesor”,- përfundoi ambasadori. Mali i Zi dhe Shtetet e Bashkuara nënshkruan një marrëveshje mbi prokurimin e automjeteve të blinduara në tetor të vitit të kaluar. Vlera e kontratës është 36.165.105 dollarë.

Mali i Zi-Sloveni: Bashkëpunim dypalësh në fushën e mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes, Predrag Bošković, u takua me Ambasadorin e Republikës së Sllovenisë, Gregor Presker, dhe të Dërguarin e Mbrojtjes së atij vendi në Mal të Zi, Kapitenin e anijes luftarake "Boris Geršak". Në takim, ministri vuri në dukje se Republika e Sllovenisë është një nga vendet kryesore aleate të Malit të Zi, mbështetja dhe ndihma e të cilit kanë një rëndësi të pamatshme për zhvillimin dhe përparimin e ushtrisë malazeze.

Ministri Boshkovic vuri në dukje cilësinë dhe përmbajtjen e bashkëpunimit midis dy vendeve, i cili mund të shërbejë si një shembull i shkëlqyeshëm i mbështetjes së ndërsjellë dhe besimit të fortë. Kjo është arsyeja pse ministri theksoi nevojën për të forcuar më tej bashkëpunimin rajonal të mbrojtjes përmes pjesëmarrjes aktive në iniciativat rajonale. Boskovic theksoi

Mali i Zi dhe Republika e Sllovenisë janë të përkushtuara për të vazhduar aktivitetet në drejtim të forcimit të mbrojtjes dhe krijimit të stabilitetit

gjithashtu se një përgjigje efektive ndaj sfidave të sigurisë kërkon përmirësimin e kapaciteteve të duhura institucionale dhe se Mali i Zi punon me zell në nivelin kombëtar dhe në bashkëpunim me aleatët për të mbrojtur interesat kombëtare.

Ministri shprehu mirënjohje të veçantë për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë për bashkëpunimin e ushtrive të të dy vendeve në kuadër të Grupit Shumëkombësh në Letoni si një kontribut për praninë e forcuar në Lindje (EFP), duke shtuar se ky lloj bashkëpunimi është i një rëndësie të pamatshme për Malin e Zi.

Ambasadori Presker tha se pasi fitoi anëtarësimin e plotë në Aleancë, Mali i Zi, në një periudhë relativisht të shkurtër, përmirësoi

ndjeshëm aftësitë e tij mbrojtëse dhe kështu konfirmoi statusin e tij si një aleat i përgjegjshëm dhe i besueshëm. Gjatë bisedimeve, ai tha se pret, që Republika e Sllovenisë dhe Mali i Zi do të vazhdojnë të zhvillojnë bashkëpunimin dypalësh të mbrojtjes në periudhën e ardhshme, të cilën ai e sheh si përfitime të dyfishta në formën e forcimit të sistemeve të mbrojtjes kombëtare dhe kontributin në sistemin e sigurisë kolektive.

Bashkëbiseduesit shprehën kënaqësinë për aspiratat e larta të të dy palëve për të zhvilluar më tej bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe konfirmuan gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet, si dypalëshe dhe multilaterale.



Mali i Zi-Itali: Bashkëpunimi në fushën ushtarake do të vazhdojë

Ministri i Mbrojtjes, Predrag Bošković, u takua me të dërguarin e sapoemëruar të Mbrojtjes së Republikës së Italisë për Malin e Zi mbi një bazë jo-rezidente, kolonel Nikola Picol, i cili ishte për vizitë në Ministrinë e Mbrojtjes të Malit të Zi. Në takim morën pjesë edhe ish i dërguari i mbrojtjes italiane, koloneli Ciro Forte.

Ministri Bošković përgëzoi kolonel Picol për marrjen e detyrës, duke besuar se angazhimi i tij i ardhshëm do të kontribuojë në vazhdimësinë e marrëdhënieve të shkëlqyera bilaterale. Ai falënderoi kolonel Forte për mbështetjen dhe kontributin e tij në zhvillimin e bashkëpunimit në fushën mbrojtjes. Duke theksuar suksesin e realizimit të projekteve dypalëshe, ministri Bošković gjithashtu vuri në dukje gatishmërinë e Ministrisë së Mbrojtjes për të shqyrtuar propozimet për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në periudhën e ardhshme. Gjithashtu, ministri vuri në dukje mbështetjen e konsiderueshme të Italisë për Malin e Zi, si në fushën e zbatimit të reformave të mbrojtjes që i paraprinë anëtarësismit në NATO, ashtu edhe në fushën e integritimit në Bashkimin Evropian.

Duke theksuar angazhimin gjithëpërfshirës të Ministrisë së Mbrojtjes për modernizimin e sektorit të mbrojtjes, Ministri Boshković informoi bashkëbiseduesit e tij për prioritetet aktuale dhe të planifikuara për zhvillimin e ushtrisë malazeze. Ai theksoi mbështetjen e Malit të Zi në përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare në krijimin e stabilitetit, si dhe kontributet e rëndësishme në sistemin e sigurisë kolektive, dhe veçanërisht theksoi rëndësinë e angazhimit të ushtarëve malazezë jashtë vendit në përmirësimin e ndërveprimit të Ushtrisë.

Koloneli Picolo shprehu kënaqësi të veçantë për mundësinë për t'u akredituar në Malin e Zi si një atashe ushtarak italian dhe tha se ai ishte

“ Bashkëpunimi i përbashkët brenda Aleancës do të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit ndërkombëtar



i gatshëm të jepte një kontribut të plotë në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të mbrojtjes midis dy vendeve. Picolo vuri në dukje përparimin gjithëpërfshirës që Mali i Zi ka bërë në periudhën e mëparshme në fushën e integritimit Euro-Atlantik, i cili ka ndikuar shumë në stabilitetin e përgjithshëm të rajonit dhe i cili rekomandon sot vendin tonë si një aleat të besueshëm brenda Aleancës.

Në takime të ndara, Kolonel Picolo gjithashtu bisedoi me Zëvendës Shefin e Përgjithshëm të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Malit të Zi, kolonel Aleksandar Pantović dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë për Politikën e Mbrojtjes dhe Planifikimit, Gjeneral Major Rajko Peçiç. Pesic shprehu kënaqësinë me marrëdhëniet e tanishme dypalëshe midis Malit të Zi dhe Republikës së Italisë në fushën e mbrojtjes dhe vuri në dukje sukseset e arritura në kuadrin e bashkëpunimit midis forcave ajrore dhe flotës së të dy vendeve, duke theksuar rëndësinë e trajnimit të kadetëve malazezë në akademitë ushtarake italiane. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të arritur midis Malit të Zi dhe Italisë brenda Aleancës, si dhe pjesëmarrjen e përbashkët në iniciativat rajonale (veçanërisht duke theksuar rëndësinë e

DECI - Iniciativa e Bashkëpunimit të Mbrojtjes dhe ADRIONJ). Duke theksuar pasojat e paparashikueshme të pandemisë së virusit COVID-19, Gjeneral Majori Pesic dhe koloneli Picolo theksuan rëndësinë e mbështetjes së forcave të armatosura në mbështetjen e përgjithshme të popullsisë dhe se veprimi i përbashkët brenda Aleancës mund të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit ndërkombëtar. Kolonel Pantović falënderoi kolonel Forte për bashkëpunimin e deritanishëm dhe i uroi atij shumë suksese gjatë angazhimit të tij të ardhshëm, dhe i uroi mirëseardhje kolonel Picolo në këtë detyrë të përgjegjshme. Pantović njohu të dërguarin e sapoemëruar të mbrojtjes italiane me aktivitetet më të rëndësishme të ushtrisë së Malit të Zi, veçanërisht në drejtim të modernizimit, trajnimit dhe pjesëmarrjes në misionet dhe operacionet ndërkombëtare dhe theksoi se forcimi i kapaciteteve mbrojtëse është një domosdoshmëri kombëtare. Gjatë takimit, ata iu referuan bashkëpunimit shumë të pasur dhe të suksesshëm midis forcave të armatosura të Malit të Zi dhe Italisë dhe diskutuan mënyrat e mundshme për ta përmirësuar atë.



Kontribut në misionin “Mbështetja e Vërtetë”, Afganistan

Amerikanët nderojnë rreshterin Kilibarda me “Medaljen e Meritës”

Rreshterit të lartë, Vladimir Kilibarda iu dha “Medalje e meritës” për performancë, ekspertizë dhe përkushtim të jashtëzakonshëm, për periudhën e angazhimit aktiv nga Shtatori 2019 deri në Mars 2020, brenda rotacionit IX të Ushtrisë Malazeze në misionin “Mbështetje e Vërtetë” në Afganistan.

Ceremonia e dekorimit të Kilibarda u ndoq nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Malazeze, Gjeneral Major Dragutin Dakić dhe i Dërguari i Mbrojtjes i SHBA-së në Mal të Zi, Nënkolonel Robert Perry dhe bashkëpunëtorët e tij.

Gjeneral Majori Dakić e përgëzoi Kilibardin për çmimin, i cili është rezultat i punës së tij profesionale në misionin “Mbështetje të Vërtetë” në Afganistan. Dakić falenderoi komandantin e Forcave të Armatosura të SHBA-së, komandën e misionit në Afganistan, i cili njohu dhe vlerësoi

Për periudhën e angazhimit aktiv nga Shtatori 2019 deri në Mars 2020, brenda rotacionit IX të Ushtrisë Malazeze në misionin “Mbështetje e Vërtetë” në Afganistan

siç duhet rezultatet që Kilibarda arriti gjatë qëndrimit të tij në misionin “Mbështetje të Vërtetë”. Dakić kujtoi se njohjet e shumta të partnerëve të NATO-s dëshmojnë për sukseset e anëtarëve tanë në misionet dhe operacionet ndërkombëtare.

“Akti i sotëm është provë se Mali i Zi dhe ushtria e tij janë një aleat i besueshëm dhe i përkushtuar, i cili është një krenari jo vetëm për Ushtrinë e Malit të Zi, Marinën e saj dhe Ministrinë e Mbrojtjes, por për të gjithë Malin e Zi,”- vuri në dukje Dakić.

Rreshteri i lartë Kilibarda falenderoi për pjesën e treguar dhe njohjen, e cila, siç tha ai, do të jetë një nxitje shtesë për ekzekutimin edhe më të mirë dhe më efikas të detyrave. Medalja e Komandimit të Ushtrisë është një nga pesë dekoratat ushtarake krahasuese, të rangut të mesëm, të dhëna nga Shtetet e Bashkuara kryesisht për anëtarët e Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara, por edhe për anëtarët e forcave të armatosura të huaja që nga viti 1962 për arritje shembullore.

Jens Stoltenberg hap Samitin e Rinisë të NATO-s 2030

NATO 2030: E ardhmja juaj, liria juaj, aleanca juaj

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mirëpriti të rinjtë nga e gjithë Aleanca në Samitin e Rinisë të NATO-s 2030 më 9 nëntor 2020.

Organizuar në bashkëpunim me Konferencën e Sigurisë së Mynihut, Samiti i Rinisë mbledhi qindra të rinj për një bisedë online me Sekretarin e Përgjithshëm dhe udhëheqës të tjerë të NATO-s dhe një seri debatesh interaktive të përqendruara në mbajtjen e NATO-s të fortë ushtarakisht, duke bërë atë më të fortë politikisht dhe duke marrë një qasje më globale.

Duke hapur Samitin, Sekretari i Përgjithshëm theksoi se NATO është e nevojshme në një botë më të pasigurt, më të kontestuar dhe më konkurruese. Aleanca, shpjegoi ai, mund të ofrojë strategji për t'u marrë me pasigurinë, të shërbejë si një forum për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe për të siguruar forcën dhe solidaritetin e nevojshëm për të trajtuar sfidat globale. Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu inkurajoi drejtuesit e rinj të ndanin pikëpamjet dhe idetë e tyre mbi të ardhmen e Aleancës. "Ju, udhëheqësit e nesërm, si në Amerikën e Veriut ashtu edhe në Evropë, keni peshën më të madhe në sigurinë tonë, kështu që NATO 2030 është shansi që ju të rriteni dhe të mbronni të ardhmen tuaj, lirinë tuaj, Aleancën tuaj," tha ai. Sekretari i Përgjithshëm njoftoi gjithashtu krijimin e Udhëheqësve të Rinj të NATO 2030, një grup prej 14 liderësh në zhvillim nga e gjithë Aleanca të cilët do t'i sigurojnë atij informacion për të informuar rekomandimet e tij për NATO 2030. Ai gjithashtu bëri publik fituesit e konkursit video të NATO 2030. Samiti i Rinisë është pjesë e NATO

NATO bashkon pothuajse një miliard njerëz, gjysma e fuqisë ekonomike dhe ushtarake të botës



2030, iniciativa e Sekretarit të Përgjithshëm për t'u siguruar që Aleanca mbetet e gatshme të përballë me sfidat e nesërme dhe të mbajë të sigurt qytetarët e saj në dekadën e ardhshme dhe më gjere

Fjala e hapjes nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në Samitin e Rinisë NATO 2030

Ju jeni një platformë e jashtëzakonshme për adresimin e sfidave të ardhshme të sigurisë. Mirëmëngjesi Evropë dhe mirëmëngjesi Amerika e Veriut! Më lejoni të filloj duke uruar Joe Biden për zgjedhjen e tij si presidenti i ardhshëm i Shteteve të Bashkuara dhe Kamala Harris si Zëvendës President i ardhshëm. Unë kam punuar me Joe Biden për shumë vite dhe e njoh atë si një mbështetës të fortë të NATO-s dhe marrëdhënieve transatlantike. Një NATO e fortë është e mirë për Evropën dhe e mirë për Amerikën e Veriut. Mezi pres të punoj shumë ngushtë me Joe Biden dhe Kamala Harris për të forcuar më tej bashkëpunimin midis Amerikës së Veriut

dhe Evropës në vitet që vijnë.

Kur Udhëheqësit e NATO-s u takuan për herë të fundit, më kërkuan për herë të reflektim, se si ta bëjmë Aleancën tonë të forte edhe më të fortë, me shikim përpara dhe të aftë për të ardhmen. Kjo është arsyeja pse unë po mbaj këtë Samiti të Rinisë NATO 2030 sot. Sepse NATO 2030 ka të bëjë me të ardhmen tuaj, lirinë tua dhe Aleancën tuaj.

Kur isha në moshën tuaj, unë u rrita në Norvegji dhe pikëpamjet dhe vlerat e mia u formuan nga bota përreth meje. Ne jetuam nën hijen e Luftës së Ftohtë dhe kërcënimi i sulmit bërthamor. Por ne ndiheshim të sigurt, sepse ishim pjesë e një Aleance dhe besuam se miqtë tanë në NATO do të na vinin gjithmonë në ndihmë. Një për të gjithë dhe të gjithë për një. Ky premtim solemn i ka mbajtur aleatët e NATO-s të sigurt për më shumë se 70 vjet.

Sot, misioni kryesor i NATO-s vazhdon. Ruajtja e paqes dhe parandalimi i agresionit në tokë, në det, në ajër në hapësirë dhe në hapësirën kibernetike, nga pandemitë te infodemikat, sulmet

kibernetike ndaj ndryshimit të klimës. Bota jonë vazhdon të ndryshojë dhe NATO po ndryshon me të. Pra, në një botë më të pasigurt, na duhet një strategji për t'u marrë me pasigurinë. Në një botë më të kontestuar, na duhet një forum për të zgjidhur mosmarrëveshjet tona dhe në një botë më konkurruese, na duhet forcë për të trajtuar sfidat globale. Për të gjitha këto arsye ne kemi nevojë për NATO-n dhe më lejoni të shpjegoj pse.

Së pari, nëse COVID-19 na ka treguar ndonjë gjë, është se bota jonë është më e paparashikueshme se kurrë më parë. E vetmja gjë për të cilën mund të jemi të sigurt është vetë pasiguria. Kur më kërkuan të bëhesha Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s në fillim të vitit 2014, bota ishte një vend shumë i ndryshëm. Pak kush kishte dëgjuar për ISIS-in dhe pak parashikuan aneksimin e paligjshëm të Krimesë nga Rusia.

Që atëherë, Rusia ka vazhduar veprimet e saj agresive. Ne kemi parë nivele të reja të brutalitetit nga ISIS dhe organizatat e tjera terroriste. Kina ka pohuar peshën e saj ekonomike dhe ushtarake në skenën botërore. Ne jo gjithmonë e dimë se cila do të jetë kriza e radhës. Por ne e dimë që jemi më të fortë së bashku se sa vetëm.

Në kohë paqeje apo konflikti, është mirë të kesh miq. Ne kemi parë vlerën e Aleancës sonë duke iu përgjigjur pandemisë COVID-19. Dorëzimi i ndihmave mjekësore shumë të nevojshme dhe mbështetjen e përpjekjeve civile për të shpëtuar jetë. Në një botë më të pasigurt, ne kemi nevojë për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe institucionet ndërkombëtare që e mbështesin atë, si NATO dhe ne duhet të investojmë më shumë në mbrojtjen tonë kolektive. Të mbrojmë të drejtën e secilit prej nesh për të jetuar jetën në paqe dhe liri.

Së dyti, në një botë më të kontestuar, na duhet një forum për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tona. Nuk është sekret që aleatët e NATO-s nuk shohin gjithmonë sy më sy. Ne kemi pasur dallimet tona në të kaluarën dhe i kemi sot. NATO ofron një platformë për të sjellë aleatët së bashku. Kështu që kur nuk pajtohemi mund të ulemi së bashku, flasim së bashku dhe zgjidhim dallimet tona. NATO është i vetmi vend

që bashkon Evropën dhe Amerikën e Veriut, çdo ditë. NATO është vendi për të diskutuar, vendosur dhe vepruar mbi çështje që ndikojnë në sigurinë tonë të përbashkët.

Kjo më çon në pikën time përfundimtare. Kjo në një botë të konkurrencës më të madhe, na duhet forcë dhe solidaritet për të adresuar sfidat globale. Sfidat e sotme të sigurisë shkojnë përtej kufijve kombëtarë. Ato nuk mund të adresohen vetëm nga ndonjë vend. As edhe më i madhi, nëse do të flasim për ngritjen e Kinës, apo ndryshimin e klimës, përhapja e armëve bërthamore, apo sulmet kibernetike dhe dezinformimi.

Kur flasim si një, zëri ynë është më i lartë. Kur vendosim dhe veprojmë së bashku, fjalët dhe veprimet tona janë të forta të 30 aleatëve. NATO bashkon pothuajse një miliard njerëz, gjysma e fuqisë ekonomike dhe ushtarake të botës. Ne gjithashtu kemi një rrjet partnerësh të një mendjeje në të gjithë botën, nga Finlanda dhe Suedia, në Australi, Zelandën e Re, Korenë e Jugut dhe Japoni. Kështu që ndërsa përballemi me një konkurrencë edhe më të madhe globale, ne duhet të punojmë edhe më ngushtë së bashku, për të mbrojtur vlerat dhe mënyrën tonë të jetës dhe për të forcuar normat dhe institucionet globale

që na kanë mbajtur të sigurt dhe të fortë për dekada. Përballë një bote më të pasigurt, më të kontestuar dhe më konkurruese, na duhet një strategji për t'u marrë me pasigurinë, një forum për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tona dhe forca për të trajtuar sfidat globale. Kjo është arsyeja pse na duhet NATO, tani, për dekadën e ardhshme dhe përtej.

Ju - udhëheqësit e nesërm, si në Amerikën e Veriut dhe në Evropë - keni peshën më të madhe në sigurinë tonë. Pra, NATO 2030 është shansi që ju të rriteni dhe ruani të ardhmen tuaj, lirinë tuaj, Aleancën tuaj. Tani është koha që ju të ndani pikëpamjet tuaja dhe të na tregoni idetë tuaja. Mirë se erdhët në Samitin e Rinisë të NATO-s 2030!

Prezantojmë Liderët e rinj të NATO 2030

Në të vërtetë jam shumë i kënaqur që jam në gjendje të prezantoj grupin e NATO 2030 për Udhëheqësit e Rinj sot. Unë e caktova grupin sepse doja që ata të më ndihmonin, të më ndihmonin, për t'u siguruar që NATO është e përshtatshme për të ardhmen, kështu që unë shpresoj shumë për idetë e tyre, për propozimet e tyre, dhe jam jashtëzakonisht mirënjohës që ata të gjithë po na bashkohen sot.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg:

Një NATO e fortë është e mirë për Amerikën dhe Evropën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg përgëzon Presidentin e zgjedhur të SHBA-së Joe Biden dhe Zëvendës Presidenten e zgjedhur Kamala Harris. Stoltenberg shkruan se "Unë mirëpres ngrohtësisht zgjedhjen e Joe Biden si Presidentin e ardhshëm të Shteteve të Bashkuara. Unë e njoh Z. Biden si një mbështetës të fortë të NATO-s dhe marrëdhënive transatlantike. Udhëheqja e SHBA-së është aq e rëndësishme sa kurrë më parë në një botë të paparashikueshme dhe unë pres që të punoj shumë ngushtë me Presidentin e zgjedhur Biden, Zëvendës Presidentin e zgjedhur Kamala Harris dhe administratën e re për të forcuar më tej lidhjen midis Amerikës së Veriut dhe Evropës. Një NATO e fortë është e mirë për Amerikën e Veriut dhe e mirë për Evropën. Së bashku, Aleatët e NATO-s përfaqësojnë pothuajse një miliard njerëz, gjysma e fuqisë ekonomike të botës dhe gjysma e fuqisë ushtarake të botës. Na duhet kjo forcë kolektive për t'u marrë me shumë sfida me të cilat përballemi, duke përfshirë një Rusi më pohuese, terrorizmin ndërkombëtar, kërcënimet kibernetike dhe raketore dhe një ndryshim në ekuilibrin global të fuqive me rritjen e Kinës. Ne mund të jemi të sigurt dhe të suksesshëm vetëm nëse përballemi së bashku me këto sfidë".

Ne shqiptarëve historia na ka mësuar shumë, por edhe na ka dënuar si pak popuj në Evropë. Me luftëra e beteja për mbrojtjen e trojeve tona për liri e pavarësi, kundër armiqve të jashtëm e jo rrallë të brendshëm, ka qenë e historia jonë. Me fitore e humbje, me gëzime e hidhërime. Sidoqoftë qëndruam. Nuk u mposhtëm. Dhe me të drejtë kujtojmë ata patriotë që me pendë e pushkë i dolën zot dhe na lanë Shqipërinë të pavarur, siç kujtojmë dëshmorët, që me gjakun e tyre në themelet e kësaj Shqipërie, u bënë të pavdekshëm.

Viti që po mbyllim shënon 100 vjetorin e ngjarjeve vendimtare për fatet e atdheut, që për nga rëndësia, sipas disa studiuesve mund të krahasohen me luftërat e Skënderbeut, Lidhjen e Prizrenit, apo shpalljen e pavarësisë... e ku një vend të veçantë zë Lufta e Vlorës.

Por jo më pak e rëndësishme ishte mbrojtja e Shqipërisë Veriore dhe Veri Lindore, nga fqinjët sllavë, veçanërisht e Shkodrës e krahinave përreth dhe e Dibrës.

Fati e deshi të jemi fqinjë me sllavët, të cilët historikisht kanë pasur pretendime ndaj tokave shqiptare dhe, fatkeqësisht në shumë raste ja kanë arritur qëllimit të tyre. Atyre nuk u mjaftonte që kishin pushtuar Kosovën, Shqipërinë Lindore (Maqedonisë Perëndimore), Ulqinin, Tivarin, Hotin, Grudën, Plavën, Gucinë, por pretendonin shumë më tepër, ku një vend tepër të rëndësishëm zinte Shkodra. Ëndrra e tyre për Shkodrën është e vjetër, dhe ata nuk do të hiqnin dorë asnjëherë prej saj, pavarësisht se mbas pushtimit të saj në vitin 1913 (kujtojmë tradhtinë e agjentit të tyre, Esad Pash Toptani që u dorëzoi Shkodrën mbas një qëndrese të radhë prej rreth 6 muaj), në saj të ndërhyrjes së ndërkombëtare u detyruan të tërhiqeshin, mbasi grabitën e dogjën ç' i doli para.

Megjithëse kohë lufte, ata vazhdonin të thurnin plane e madje të bënin hapa konkretë për të përgatitur terrenin për pushtimin e Shkodrës. Kështu në gusht të vitit 1914 ata sulmuan dhe dogjën Kelmendin, futën trupa në Hot e deri në Kastrat (jo larg Shkodrës).

Epopeja e Luftës së Koplikut

Lufta që e ktheu Veriun e Shqipërisë në kufijtë e vitit 1913



SHAQIR VUKAJ

të Shqipërisë londineze të v.1913, por me kusht që edhe të tjerët të vepronin njëllëj, por nga ana tjetër angazhohej me të gjitha mënyrat me shpresë se Konferenca do të plotësonte kërkesat e saj ndaj territoreve shqiptare përfshirë Shkodrën, Malësinë e Madhe, Anën e Malit etj.

Pavarësisht nga qëndrimi në Paris, Beogradi tregojë tepër aktiv në terren, madje edhe brenda territoreve shqiptare të 1913. Gjithmonë me qëllim aneksimin e Shkodrës, ata grumbulluan në Podgoricë një grup tradhtarësh, përkrahës të Esat Pashës, si Alush Lohja, Lukë Luka, Lekë Mirashi etj, që u vunë në krye të bandave që po organizoheshin kundër vendit të tyre, që sipas të dhënave të Beogradit arrin në rreth 1200 vetë e që stërviteshin nga oficerë jugosllavë. Që në gusht 1918, Esat Pasha kishte paraqitur një projekt për "rregullimin" e Shqipërisë, sipas të cilit Greqisë duhej ti jepeshin 10500 km. katrorë nga Shqipëria e

Jugut, Serbisë 6000 km. katrorë nga Shqipëria e Veriut, ndërsa në territoret brenda Vjosës e Drinit të krijohej një shtet mysliman, çka, i jepte Beogradit garanci e mundësi për të vepruar...

Kështu në vitin 1919 Beogradi ndërmori veprime konkrete për të zgjeruar zonën e pushtuar drejt Shkodrës, me qëllim që të krijonte një zonë homogjene pushtimi, që do të shtrihej në gjithë Shqipërinë e Veriut. Madje krijoi dhe një njësi të quajtur "Detashmenti i Kelmendit", i cili, në shtator 1919, u fut pothuajse në gjithë krahinën e Kelmendit, për të detyruar parinë që të pranojnë "ombrellën jugosllave". Njëkohësisht krijuan dhe një njësi ushtarake speciale për të operuar në Hot (pjesën brenda kufirit tonë) që u fut në verën e v.1919. Në fund të muajit dhjetor, kryeministri jugosllav, Davidoviç kërkoi që të pushtohej zona e Bogës dhe e Shkrelit, në mënyrë që të krijohej një pykëzim për dobësimin e mundësisht ndërprerjen e lidhjeve me Shkodrën. Në prag të Krishtlindjeve, me dredhi e mashtrim, ata bënë një masakër të pa dëgjuar në Hot, duke vrarë 74 vetë të pafajshëm si dhe duke arrestuar 200 të tjerë që

de Fortou.

Në Konferencën e Paqes në Paris që u hap më 18 janar 1919, fqinjët kërkonin ta shqyenin Shqipërinë. Italia-nët kërkonin Vlorën dhe pro-

tektoratin mbi "shtetin autonom shqiptar" që do të krijohej në Shqipërinë e Mesme, Athina kërkonte "Vorio Epirin". Beogradi (tashmë Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene) me dredhi, nga njëra anë, për t'ju kundërvënë pretendimeve italiane, propozonte njohjen e kufijve

Përfundimi i Luftës Parë Botërore e gjeti Shqipërinë nen pushtimin italian (pjesa më e madhe e Shqipërisë), francez (Korça) ndërsa Shkodrën nen pushtimin e një fuqie ndërkombëtare (përberë nga trupa franceze, angleze e italiane) nen komandën e filoserbit, gjeneralit francez Bardi

i çuan në Podgoricë. Kështu u mbyll viti 1919.

Duhet theksuar angazhimi e përpjekjet e patriotëve shkodranë, të cilët në mbështetje të Lëvizjes Kombëtare, më 16 shkurt 1919 krijuan komisionin nismëtar "Vllaznia", me 172 anëtarë, me kryetar patriotin Hil Mosi. Komisioni luajti rol tepër të rëndësishëm si në planin e brendshëm, si në atë ndërkombëtar. Ndërmjet tjerave duhet përmend përkujtimi në mënyrë madhështore i 28 Nëntorit në Shkodër, Rezolucioni që ju dërgua Presidentit të SHBA, Wilson, Llojd Xhorxhit dhe ministrit të Jashtëm të Italisë, ku kërkohej "Nji Shqipëri indipendente, bashkimin e Vlorës dhe Shkodrës me shtetin shqiptar, si politikisht ashtu dhe administrativisht".

Ndërkohë në Konferencën e Paqes, mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene vazhonte përpjekjet për copëtimin e Shqipërisë. Ajo kërkonte aneksimin e krahut të djathtë të Drinit të Zi, Kastratin dhe pjesën e Hotit mbetur brenda kufijve të Shqipërisë, Kelmendin, dhe krejt zonën në krahun e djathtë të lumit Buna, ku shtrihej mali i Taraboshit, duke marrë kështu edhe Liqenin e Shkodrës dhe, pasi të merrte këto krahina, Beogradi pranonte Shqipërinë e pavarur me një administratë autonome. Dhe "kurva" Evropë (Anglia, Franca dhe Italia) arritën një kompromis, sipas të cilit Shqipëria copëtohej ndërmjet Italisë, Greqisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene (ashtu siç ishte parashikuar në Traktatin e Fshehtë të Londrës të v.1915), projekt që nuk u realizua në saj të qëndresës së shqiptarëve dhe angazhimit e qëndrimit të SHBA-së.

Viti 1920 filloi me një ngjarje të jashtëzakonshme për fatet e Shqipërisë dhe organizimin e shtetit shqiptar. Më 21 janar u mbledh Kongresi i Lushnjës, me përfaqësues nga të gjitha krahinat. Kongresi krijoi një Qeveri Emergjente, Këshillin e Lartë si dhe një Këshill Kombëtar që do të kryente funksionet e parlamentit. Tashmë Shqipëria kishte një qeveri qendrore, që do i jepte fund qeverisjes nga të huajt, nga disa klane, apo sipas krahinave. Detyrat e saj ishin të jashtëzakonshme, në planin e brendshëm për ruajtjen e tërësisë territoriale, për mbrojtjen e çlirimit e disa krahinave nga pushtuesit italianë, shovinistët grekë dhe serbo-malazezët si dhe në planin ndërkombëtar, për mbrojtjen e çështjes shqiptare, veçanërisht në Konferencën e Paqes në Paris.

Duke përfutur nga situata e pa stabilizuar dhe pengesat që i nixirreshin qeverisë, në shkurt, jugosllavët ndërmorën një agresion të hapur, duke pushtuar malin strategjik të Taraboshit (Taraboshi historikisht ka qenë çelësi i Shkodrës. Thuhet se gjatë takimit të Kralj Nikollës së Malit të Zi me Sulltanin në vitin 1905, ai i kërkoj Sulltanit një copë shkëmb në Tarabosh, sa "një lëkurë bualli", pikërisht për këtë qëllim, që të siguronte një pikë strategjike për realizimin e ëndrrës së tij për pushtimin e Shkodrës). Krahas Taraboshit ata pushtuan anën e majtë të liqenit të Shkodrës, si dhe krahun e djathtë të lumit Buna, duke u afruar deri tek ura e Bunës, në lagjen e jashtme e qytetit. Sipas disa studiuesve, të gjitha këto u arritën me aprovimin e gjeneralit Francez Bardi de Fortou.

Situata e jashtëzakonshme që u krijua alarmoi patriotët shkodranë, që u organizuan në komitetin "Mbrojtja Kombëtare" që mori një seri masash mbrojtëse si dhe kërkuan ndihmën e qeverisë së sapo krijuar. Komiteti i dha një rëndësi të jashtëzakonshme bashkëpunimit dhe bashkëpunimit midis qytetarëve dhe malësorëve, nga radhët e të cilëve do të dilnin shumica e luftëtarëve. Problemi kryesor mbetej bashkimi administrativ i Shkodrës dhe Malësisë së Madhe me shtetin administrativ që po ngrinte qeveria e

re dhe që ishte shprehur qartë në mbledhjen e organizuar më 6 mars 1920 nga Komisioni i Shkodrës.

Mbasi dështuan në tentativën për të pushtuar Kelmendin e Shalën, jugosllavët gjithë vëmendjen ja kushtojnë qytetit të Shkodrës.

Ishte koha kur përgatitej largimi i trupave të huaja nga Shkodra dhe, sipas disa studiuesve, gjenerali francez që komandonte këto trupa, përgatitej që me largimin e tyre, vendin e tyre t'ia linte ushtrisë jugosllave, që ishte dislokuar jo vetëm në lagjen e jashtme të Shkodrës (matanë urës së Bunës), por në pozicione strategjike (Tarabosh, Anë të Malit, dhe përgjatë bregut të liqenit të Shkodrës).

Duket e pabesueshme, por gjenerali francez, i kërkoj Kryetarit të Bashkisë së Shkodrës, që të përpilonte një peticion në emër përfaqësuesve e qytetit, ku të kërkohej prania e trupave serbo-malazeze në Shkodër, si "mbajtëse të rendit dhe qetësisë", e jo si pushtuese, gjë që u hodh poshtë në mënyrë demonstrative nga patriotët shkodranë. Ndërkohë qeveria, që nga njëra anë përpiktej nëpërmjet bisedimeve me gjeneralin francez të arrinte një marrëveshje për marrjen në dorëzim të qytetit nga shqiptarët, nga ana tjetër, punonte për tu përgatitur e për të marrë masa për mbrojtje. Më 10 mars në një mbledhje të Komisionit të Shkodrës, ku merrnin pjesë dhe përfaqësues të qeverisë, u vendos që ti kërkohej komandantit të forcave ndërkombëtare që qyteti i Shkodrës ti dorëzohej "Komisionit të Shkodrës".

Situata u acarua më shumë në Shkodër filloi armatosja e mobilizimi i vullnetarëve për mbrojtjen e qytetit me çdo kusht. Ndërkohë, në Bahçallëk, (në hyrje të Shkodrës) rreth 200 vullnetarë të armatosur qëndronin të gatshëm për çdo moment. Në këto kushte, megjithëse gjenerali francez nuk desh ta dorëzonte qytetin shqiptarëve, përfaqësuesit e qeverisë dhe të Komisionit të Shkodrës, e bënë fakt të kryer marrjen në dorëzim të qytetit. Mbasi francezi me trupat që komandonte u larguan, filloi menjëherë formimi i administratës lokale me dy prefektë (një mysliman dhe një katolik) si dhe u krijua një këshill administrativ.

Beogradi e priti në mënyrë armiqësore bashkimin e Shkodrës administrativisht me qeverinë, madje shtoi përgatitjet ushtarake. Në këtë kuadër rriti numrin e ushtarëve dhe punimet fortifikuese në Tarabosh, si çelësi për Shkodrën. Sipas një raporti të Ministrisë Brendshme për Qeverinë, ata kishin përgatitur edhe një plan për rebelimin e esatistëve, që do të sulmonin Shkodrën nga tre drejtime. Sulmi mbi Shkodrën planifikohej të bëhej në të njëjtën kohë me rebelimin në Shqipërinë e Mesme... Në të njëjtën kohë ata përpiqeshin të shkaktonin turbullira në Malësi të Madhe, nga njëra anë të fushin ngatërresa midis malësorëve, dhe nga ana tjetër të fushin banda të armatosura në këto zona.

Dukej qartë se Beogradi po përgatitej për një agresion ushtarak. Sigurisht për një ndërmarrje të tillë duhej gjetur preteksti. Siç shkruan enciklopedisti shkodran Hamdi Bushati (Sekretar pranë shtabit të Luftës së Kopllikut) preteksti u gjet. Mbasi serbomalazezët vranë 74 malësorë nga Hoti e Gruda, një togë xhandarësh shqiptarë të gënijer ndoqën armikun matanë kufirit shtetëror. Dhe preteksti u gjet. Sipas ndonjë studiuesi, ledhe sipas kujtimeve të Sejfi Vllamasit) ata shfrytëzuan togërin Zef Serreqi, i rekrutuar nga italianët që në krye të togës ndërmori këtë aventurë...

Qeveria e Tiranë i kërkonte Prefekturës së Shkodrës të tërhiqen menjëherë. Ajo urdhëronte në mënyrë kategorike nënprefekturën Malësisë së Madhe që trupat shqiptare të mos kalonin në asnjë mënyrë kufirin, sepse detyra e tyre ishte të ruanin me çdo kusht kufirin shqiptar, urdhër që

ju dha edhe krerëve të Malësisë së Madhe që u mbledhën në Kastrat.

Më 27 korrik (që konsiderohet si fillimi i Luftës së Koplikut) tre batalione të ushtrisë jugosllave, bashkë me mercenarë shqiptarë...ju drejtuan Kastratit, që mbas katër-pesë orë luftimesh arritën ta pushtojnë. Menjëherë u dha kushtrimi dhe qindra vullnetarë nga Shkodra e rrethinat u drejtuan në pikat grumbullimit. Më 29 korrik forcat jugosllave sulmuan Katundin e Kastratit. Duhet theksuar se ushtria e tyre ishte e pajisur me armët moderne të kohës, topa e mitraloza etj. kryesisht të prodhimit francez. Për këto suksese të ushtrisë jugosllave, Regjenti i mbretërisë Serbo-Kroato-Slovene, i konfirmonte Atashaut Ushtarak Anglez në Beograd, se "Forcat ushtarake kishin pushtuar vijën e lartësive në veri të Liqenit të Shkodrës, rreth 15 kilometra në lindje të kufirit të v.1913".

Tashmë ata ishin përgatitur për të realizuar qëllimin e tyre, pushtimin e Shkodrës. Në këto kushte, më 29 korrik u organizua në Shkodër një takim i madh nën moton "Serbët ia behën në Koplik" me qëllim organizimin e popullit për mbrojtjen me çdo kusht të trojeve shqiptare. Siç shkruante revista Agimi (Nr.5 v.1920) "Burra të pjekur, djem të ri, myslimanë e të krishterë, si bijtë e thjeshtë të një race, vllazën të një gjaku, të një fisi e të një votre e të një zjeremi...lanë çdo punë e shërbim e menjëherë rrokën armët, tue pas zjermin në gji e uzdajën në zemër: Burra e djelm, o sot o kurrë".



Më 30 korrik në qytet u dha kushtrimi, "Një pushkë për shtëpi" dhe brenda ditës u nis drejt frontit formacioni i parë me 500 vullnetarë. Shtabi drejtues u vendos, fillimisht në Vrakë, ku forcave vullnetare, të qytetit ju bashkuan vullnetarët e Malësisë së Mbishkodrës. Në përplasjen me pararojën e ushtrisë jugosllave, ajo u tërhoq, duke krijuar mundësi që Shtabi të vendosej në Çezme të Koplikut. Në Shtab bënë pjesë njerëz me emër në Shkodër, Syçbo beg Bushati, Rexhep Shala, Muharrem Kazazi, Shuk Gurakuqi, Oso beg Koliku, Can Mema, Malo beg Bushati etj, ndërmyjet të cilëve disa oficerë. Nga qeveria vinin herë pas here përfaqësues për koordinimin e veprimeve etj.

Fillimisht forcat vullnetare, tashmë qytetarë e malësorë nga të gjitha krahinat e Malësisë së Madhe, nga Dukagjini e deri nga Kosova, përbeheshin nga rreth 2200 vetë, të organizuar dhe të ndarë në tri kolona, me detyra të caktuara qartë. Bën përshtypje një dokument i kohës, sipas të cilit jepen me hollësi numri i vullnetarëve nga çdo fshat i Malësisë së Madhe (që përbente numrin më të madh), përfshirë dhe trojet shqiptare që ndodheshin jashtë kufirit, si dhe nga çdo lagje e qytetit, apo nga fshatrat rreth Shkodrës. Në Shkodër u krijuan grupe e njësi ndihmëse, si komisioni Përkujdestar i Ushtrive Vullnetare, grupi i korrierëve, grupi i çiklistëve, u themelua shoqata "Hylli i Kuq", Komiteti bamirës "Grueja Shqiptare" etj.

Tashmë kemi një organizim pak a shumë ushtarak, që drejtohej nga një Shtab, por që, sipas traditave e zakoneve, vullnetarët e çdo krahine kishin prijësit e tyre. Në qoftë se e ditët e para numëroheshin 2200 vullnetarë, mbas pak kohësh numri i tyre arriti në rreth 3000 vetë, nga të cilët rreth 400 nga Kosova, rreth 300 vullnetarë nga Kruja, Ishmi dhe Shijaku etj.

Në këtë periudhë, krahas luftimeve, Qeveria Shqiptare, përpjeq në planin diplomatik të gjente zgjidhje për ndali-

min e luftës. Në këtë kuadër ajo mori disa herë iniciativa, madje përfaqësuesi i saj u takua në Rieka me komandantin e ushtrive jugosllave në Mal të Zi, gjeneralin Mihajloviç, por pa asnjë rezultat dhe ushtria e tyre vazhdonte luftën në Malësi e Koplik.

Shkodranët e malësorët nuk ishin dakord me këtë politikë të qeverisë, madje u përpoqën ti bënin presion. Ata vazhdonin ofensivën dhe arritën të merrnin një pikë strategjike në Koplik, që bëri të mundur të bashkonte frontin dhe të vazhdonin ofensivën në shumë drejtime, aq sa më 21 gusht ata arritën të çlironin pothuajse të gjitha zonat e pushtuara. Kishte mbetur vetëm mali i Taraboshit.

Qeveria vazhdonte përpjekjet për armëpushim, gjë që bëri të ndalej ofensiva e shqiptarëve. Për këtë arsye, më 21 gusht përfaqësuesi i qeverisë u takua në Shkodër me delegatin jugosllav Vukatiç. Pa kaluar pak orë, duke shfrytë-

zuar armëpushimin gjoja për të arritur një marrëveshje, serbo-malazezët ndërmorën një ofensivë të madhe nga shumë drejtime në Malësinë e Madhe me të gjitha armatimet e kohës dhe arritën të pushtojnë Kelmendin, Kastratin deri në afërsi të Koplikut.

Në situatën e krijuar për luftëtarët shqiptarë, problemi kryesor mbetej mbrojtja e pozicioneve, në mënyrë që mos të lejonin në asnjë mënyrë avancimin e jugosllavëve drejt Shkodrës, duke krijuar një front që shtrihej nga Kastrati, Shkrelli e deri në breg të Liqenit të Shkodrës. Theksojmë se në ndihmë të vëllezërve të tyre kishin ardhur vullnetarë nga Kruja (200 vetë), Mati (200 vetë) Tirana, Shijaku e Kavaja (400 vetë) etj.

Ndërkohë "Çështja Shqiptare" kish tërhequr vëmendjen e Fuqive të Mëdha, veçanërisht të qeverisë së SHBA, që nëpërmjet një note dorëzuar Ministrisë së Jashtme të Anglisë ku thuhej se ajo "Dëshiron që të arrihet sa më parë në zgjidhjen e problemeve të shumta që kanë lindur në lidhje me Shqipërinë", madje paralajmëroi se "nuk do të njihje asnjë rregullim për të cilin ky departament nuk do të ketë dhënë qysh më parë pëlqimin e vet".

Ndërsa në notën e 6 marsit 1920 thuhet se "Presidenti detyrohet të deklarojë edhe një herë se nuk do të miratonte asnjë plan që i jep Jugosllavisë një kompensim territorial në pjesën veriore të Shqipërisë".

Situata në frontin e luftës sipas buletineve ditore të Ministrisë së Luftës, në përgjithësi është e qetë, nuk ka luftime të mirëfillta, por gjithsesi jugosllavët qëllojnë me artileri pozicionet e shqiptarëve në të disa pika të frontit... Shqiptarët duke njohur mirë pabesinë e dredhitë e serbo-malazezëve qëndronin në gatishmëri, madje numri i luftëtarëve shqiptarë në front ishte rritur dhe kishte shkuar në 3050 vetë. Duhet vënë në dukje se ata nuk pranuan të zbatonin as urdhrin e Qeverisë së Tiranës për të ulur numrin e vullnetarëve në front...

Në muajin tetor ushtria jugosllave kishte mbetur në ato pozicione që kishin arritur më 22 gusht, pa mundur të bënte asnjë hap përpara. Ata vazhdonin të mbanin të pushtuara zona të caktuara në Hot, Kastrat e Shkrel. Megjithëse po bëheshin përpjekje që konflikti të zhvendosej në fushën diplomatike (në këtë periudhë kemi shkëmbim të robërve nga të dy palët), jugosllavët vazhdonin provokacionet, ndërmerrnin here pas here aksione të shkëputura për të parë e provuar gatishmërinë e vullnetarëve shqiptarë, që u kundërpërgjigjeshin në çdo rast (madje në kundërshtim me urdhrin e Qeverisë për të mos ju kundërpërgjigjur...).

Qëndrimi, gatishmëria, trimëria, vendosmëria e organizimi i vullnetarëve të Malësisë së Madhe, Shkodrës e vullnetarëve nga krahina të tjera, u bënë barrikadë për të mos lejuar ushtrinë jugosllave të arrinte qëllimin e vet për pushtimin e Shkodrës. Njëlloj qëndronin vullnetarët shkodranë e vullnetarët nga krahina të tjera, në gatishmëri për të përballuar çdo sulm që mund të vinte nga krahu i Bunës dhe bregu i Liqenit të Shkodrës. Strategjia e zgjedhur, që vazhdoi edhe gjatë muajve nëntor-shkurt ishte rruga më e mirë për tu krijuar mundësi rrugëve diplomatike që Qeveria Shqiptare kishte ndërmarrë me Fuqitë e Mëdha e SHBA.

Qeveria Shqiptare, më 12 tetor kishte bërë kërkesën për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe, pavarësisht nga kundërshtimet e Beogradit, Athinës dhe të Parisit, më 17 dhjetor Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve, çka ishte një sukses i jashtëzakonshëm, e që do të kishte rolin e vet edhe për ti dhënë fund Luftës së Koplikut.

Më në fund, Beogradi i detyruar nga shumë faktorë, në radhë të parë në saj të qëndresës së shqiptarëve, si dhe ndërhyrjes së faktorit ndërkombëtar, u detyrua të tërhiqej përfundimisht nga territoret e pushtuara, duke u kthyer në kufijtë e vitit 1913, duke shuar një herë e mirë ëndrrën për pushtimin e Shkodrës.

Luftëtarët shqiptarë treguan akte heroizmi të rralla në këtë luftë të pabarabartë, përballë një ushtrie të përgatitur e të pajisur më armët moderne të kohës. Të pa stërvitur, pa furnizimet e domosdoshme, madje as pa gjërat më elementare për të përballuar një armik të tillë, vullnetarët shqiptarë në saj të mobilizimit dhe ndihmës të gjithë banorëve të Malësisë së Madhe e të qytetit të Shkodrës, arritën që brenda një kohë të shkurtër të ktheheshin në një lloj ushtrie popullore të rregullt e të disiplinuar, që zhvilloi luftëra e aksione luftarake në shumë fshatra e pika strategjike të Malësisë së Madhe.

Lufta e Koplikut do të kishte Heronjtë e Dëshmorët e vet, që me trimërinë e heroizmin e treguar u bënë shembull për shokët e tyre e për brezat e ardhshëm e që me gjakun e tyre vulosën themelet e kësaj Shqipërie që kemi sot.

Sipas shumë dokumenteve e të dhënave, në këtë luftë u vranë 79 luftëtarë, dhe së bashku me 74 të vrarët në Hot, numri i tyre shkon në 153 vetë, pa folur për qindra të plagosur. Dua të kujtoj se një pjesë e tyre janë shpallur Dëshmorë para viteve 90-të, dhe sipas dokumentacionit të përgatitur nga Bashkia e Koplikut, presim që së shpejti edhe të tjerët të shpallen së shpejti Dëshmorë të Atdheut.

Lufta e Koplikut, sikurse dhe Lufta e Vlorës, ishte luftë kombëtare, ku morën pjesë vullnetarë nga shumë krahina të Shqipërisë, e organizuar dhe drejtuar politiko-ushtarakisht nga qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës. Megjithëse shumica dërrmuese e luftëtarëve ishin vullnetarë që vinin kryesisht nga Malësia e Madhe apo krahina që historikisht ishin mësuar të luftonin nën drejtimin e bajraktarëve apo prijësve të krahinave, ajo u zhvillua dhe u

drejtua nga një Shtab që komandonte e drejtonte të gjitha veprimet luftarake.

Ajo u zhvillua në kushte të komplikuar ndërkombëtare, kur Fuqitë e Mëdha të Europës, Britania e Madhe, Franca dhe Italia kishin planifikuar dhe rënë dakord për copëtimin e Shqipërisë, ku Veriu, e në këtë kuadër, Shkodra, Malësia e Madhe, Ana e Malit etj. do i jepeshin Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene.

Lufta e Koplikut, në ndryshim me shumë luftëra të tjera nuk u zhvillua në një vijë fronti. Ajo u zhvillua në shumë vende dhe përfshiu pjesën më të madhe të Malësisë së Madhe, në Kelmend, Hot, Shkrel, Kastrat, Katund të Kastratit, Koplik, etj.

E veçantë e kësaj lufte është se për herë të parë morën pjesë vullnetarë nga e gjithë Malësia e Madhe, pa përjashtim nga të gjitha zonat e fshatrat dhe përbënin numrin më të madh të të gjithë vullnetarëve. Duhet vënë në dukje se në të morën pjesë shumë vullnetarë nga trojet shqiptare të lëna jashtë kufijve nga Konferenca e Londrës e v. 1913, nga Kosova, Hoti, Gruda, Plava, Gucia si dhe nga zonat e tjera të rrethit Shkodër. Një ndihmë të madhe dhanë vullnetarët e ardhur nga Mati, Tirana, Kavaja, Shijaku etj.

Shkodra e kishte treguar veten edhe në raste të tjera, veçanërisht gjatë Luftës për Shkodrën, rrethimit 6 mujor, por qëndrimi e mobilizimi i qytetarëve të Shkodrës, pa dallim feje, këtë herë ka qenë shembullor, ku në krye qëndronin intelektualë e patriotë të njohur shkodranë.

Ishte kjo luftë (krahas asaj të Dibrës) që e ktheu Veriun e Shqipërisë në kufijtë e vitit 1913, duke i dhënë fund një herë e mirë ëndrrës e pretendimeve shekullore sllave për të pushtuar Shkodrën, dhe unë do të shtoja se përkufizimi që ka bërë Pr. Paskal Milo për Luftën e Vlorës se ajo "Përmbylli në vija të përgjithshme procesin e rivendosjes së pavarësisë dhe sovranitetit të Shqipërisë" duhet thënë edhe për Luftën e Koplikut.

Është e pafalshme që për 100 vjetorin e kësaj lufte nuk u organizua asgjë nga qeveria, apo institucionet tona studimore. Presim të realizohet premtimi i Bashkisë Koplik për të organizuar disa aktivitete në fund të vitit, si dhe vendosjen e monumentit kushtuar kësaj lufte. Ishte pozitive iniciativa e një shoqate kulturore që kishte marrë iniciativë për përkujtimin e saj, por ishte e pafalshme që edhe në këtë rast u fut politika e mbrapshtë e ditës dhe nuk pamë bashkë qeveritarë e politikanë të partive të ndryshme. Data përkujtimore të tilla duhet të shërbejnë si shembull mirëkuptimi e bashkëpunimi midis shqiptarëve e jo të shfrytëzohen për përçarje...

Së fundi dua të theksoj se Lufta e Koplikut nuk është studiuar ashtu si e meriton. Historiografia jonë ia ka borxh, prandaj është detyrë e institucioneve përkatëse dhe historianëve tanë seriozë që ta çojnë me tej punën e bërë nga historianët Xhevat Repishti ("Lufta për mbrojtjen e Shkodrës në vitet 1919-1920") (Shkodër 1998) e Ndue Bacaj në ("Lufta e Koplikut 1920 dhe ngjarjet që i paraprijnë") (Shkodër 2020) dhe disa autorëve të tjerë që me raste të ndryshme kanë shkruar, apo mbajtur kumtesa e referate. Ekzistojnë shumë dokumente e materiale të pashfrytëzuara, që po të merren në dorë nga studiues seriozë, do të mësonim shumë më tepër për këtë luftë, për planet e veprimtarinë armiqësore të Beogradit e të disa Fuqive të Mëdha Evropiane kundër Shqipërisë, për heroizmin e njerëzve të thjeshtë që dolën vullnetarë e luftuan deri në fund për mbrojtjen e trojeve shqiptare si dhe për veprimtarinë e disa patriotëve e intelektualëve shkodranë që me penë e pushkë u vunë në krye të kësaj lufte, dhe që me të drejtë radhitet ndër luftërat më të lavdishme të popullit tonë.

Lavdia dhe rënia e një gjenerali në Luftën Kombëtare të Vlorës

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Gjenerali Italian Piaçentini, përballë ortekut popullor të sulmit të kapedanëve dhe popullit të Jugut të Shqipërisë, do të ndërronte jetë vetëm një vit pas përfundimit me disfatë të kësaj lufte. Ai iku nga Vlora me një daramet në zemër, daramet që do ta çonte në "parajsë", vetëm një vit pas kësaj lufte dhe me të drejtë bashkëlufetarët e tij, bashkëgjeneralët, epronët dhe vartësit, që luftuan krah tij nëse do të pyesnin: "Gjeneral, kush të mundi?", një pyetje më e rëndë, "se plumbi", që do të rëndonte mbi të. Lavdia e një gjenerali u shua si yll, që nuk mundi të ndriçonte kurrë sepse, sikurse shkruajtën gazetat e kohës: "gjalmëzestë e Labërisë nuk të falin kur u shkel lirinë"! Në anën tjetër lavdia e Osman Haxhiut, KMK-së, Këshillit të Luftës, çetave dhe luftëtarëve ishte një meteor lavdie që ka një shekull që ndriçon dhe do të ndriçojë përherë për lirinë dhe rikonfirmimin e pavarësisë së shqiptarëve. Fitimtarët shqiptarë erdhën në ditën e fitores më 3 shtator 1920, pas një marrëveshje të 2 gushtit 1920, që ishte shkatërruese për një gjeneral, tujet e të cilat ranë dhe u vishkën bashkë me ëndërrën e ringjalljes së legjoneve romake të "Nostra mare!", me humbjen e hidhur përballë një "grusht rebelësh" të Vlorës dhe trevave të tjera shqiptare. Një epokë e re ishte çelur për shqiptarët.

Ballafaqim forcash në Luftës së Vlorës: "O Shqipëri, o gur e hi!"

Lufta e Vlorës ishte një luftë e armatosur e popullit shqiptar për çlirimin e krahinës së Vlorës nga pushtuesit italianë dhe për bashkimin e saj administrativ me pjesën tjetër të Shqipërisë. Forcat italiane ishin vendosur në Vlorë gjatë Luftës së I Botërore. Vendimi për fillimin e Luftës së Vlorës u mor nga përfaqësuesit e krahinës së Vlorës të mbledhur në Kuvendin e Barçallait më 29 maj 1920, i cili zgjodhi për organizimin dhe drejtimin e luftës Komitetin "Mbrojtja Kombëtare" me kryetar Osman Haxhiun. Ai formoi gjithashtu edhe një komision ushtarak me Lepenicën në krye, i cili pas pesë ditësh u zëvendësua nga Qazim Koculi. Qeveria e Tiranës dha ndihmesën e vet, pavarësisht se nuk mori pjesë zyrtarisht në luftë. Lufta e Vlorës nisi më 5 qershor 1920 dhe u zhvillua në mënyrë frontale. Përballë

(Me rastin fitores së shqiptarëve para një shekulli, në Luftën Kombëtare të Vlorës, por edhe të dështimit të njerës prej ushtrive më të përgatitur të Italisë dyzetë milionëshe në Vlorë, si dhe të dështimit të njerit prej gjeneralëve më të aftë e të zotë siç ishte gjeneralletenant Settimio Piaçentini i mbretërisë së Italisë në Shqipëri nën drejtimin e Osman Haxhiut në verën e 1920-ës)

ushtrisë së rregullt italiane, që kishte në Shqipëri dy divizione, u vunë forcat shqiptare, të grumbulluara mbi baza vullnetare e që arrinin në rreth 4 mijë veta. Më 5-6 qershor u goditën njëherazi të gjitha garnizonet italiane në krahinë, që nga Tepelena e deri në Drashovicë. Sulmi mbi forcat italiane në qytetin e Vlorës dhe rrethinat filloi më 11 qershor. Lufta për marrjen e Vlorës vazhdoi gjatë dhe u zhvillua me mësymje dhe kundërmësymje, në një nga të cilat spikati trimëria e Selam Musait dhe qindra e mijra shqiptarëve nga e gjithë Shqipëria. Lufta filloi në mënyrë kalorësiake, me kalorësin e ultimatiumit Mehmet Selim Shahaj Mallkeqi, i cili i dorëzoi komandës italiane ultimatumin për largimin nga Vlora. Në rradhët e këtij ultimatumi shkruhej: "Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare të Vlorës, i shtërnguar nga populli i Vlorës dhe gjithë Shqipërisë, dëshiron që zotëria juaj t'i përgjigjet kërkesës tonë gjerë nesër më 4 qershor ora 19:00 ndryshe çdo ngjarje që mund të ngjasë, Komiteti Mbrojtja Kombëtare nuk pranon kurrë responsabilitet. Por përgjigja e gjeneral Piaçentinit ishte e prerë: "Topat e mi në Kaninë dhe në Babicë do tju japin përgjigje". Kështu Mehmet Selimi Mallkeqi, kalorësi ultimatiumit, kalëroi si zogu nëpër re drejt e në shtabin kryengritës të luftës.



Beteja për Shqipërinë e përbashkuar kishte filluar. Ajo që nuk mundësohej me diplomaci kalorësiake, ishte e zgjidhur përmes luftës së vendosur, që pati shumë gjak, mund e sakrificë në tre muaj verë të përvëlur nga luftimet për jetë a vdekje për bashkimin e Vlorës me trungun mëmë me çdo kusht me çdo sakrificë. Lufta në garnizonin e Kotës dhe gjithë garnizonet e tjera ishte për luftëtarët sërish sfida e radhës përballë pushtuesve. Lufta provoi gatshmërinë dhe vullnetin e shqiptarëve deri në luftime të përgjakshme përballë çdo garnizoni deri në luftimet trup me trup me pushtuesit. Gjatë Luftës së Vlorës, edhe pse pati shumë kundërsulme nga trupat italiane, ato nuk mundën të çanin darën e rrethimit të forcave shqiptare. Roma u detyrua më në fund të hiqte dorë nga sovraniteti mbi krahinën e Vlorës dhe të nënshkruante me Qeverinë e Tiranës "Protokollin shqiptaro-italian" të 2 gushtit 1920. Më 3 shtator 1920 forcat shqiptare hynë triumfalisht në qytetin e Vlorës të zbrazur nga trupat pushtuese. Bashkë me krahinën e Vlorës, qeveria italiane u detyrua të tërhiqte garnizonet ushtarake edhe nga Saranda, Durrësi e Shëngjini. Lufta e Vlorës ishte "arritje dhe vepër historike e identitetit shqiptar dhe që siguroi vazhdimësinë tonë në hapësirat në të cilat jemi dhe kemi të drejtë etnike e historike", thotë akademik Rexhep Qosja. Lufta vulosi bindjen e diplomacisë së Fuqive të Mëdha se faktori shqiptar ishte dhe duhej vlerësuar si element i rëndësishëm ekuilibri gjeostrategjik e gjeopolitik nga ku respektimi i pavarësisë së Shqipërisë, i riçonte ndërkombëtarët tek Konferenca e Londrës dhe vendimi i 29 korrikut 1913. Lushnja dhe Vlora ishin dy stacionet vendimtare të rikonfirmimit të Pavarësisë dhe fati historik e deshi Shqipërinë përmes një turbullire të tillë, por mbi të gjitha qëndronte vendosmëria shqiptare. Edhe Egerem Vlora që "e shihte luftën me dylbi", në dreka e dreka me gjeneral Piaçentinin dhe bashkëpunëtorët e tij, italianë i befusuar nga ç'po ndodhte, shkruante në Kujtimet e veta se: "Si kishte qenë e mundur?! Si kishin arritur disa mijëra fshatarë që në dy javë t'i dëbojnë italianët nga një zonë prej 2000 km², të zenë 3100 robër, 17 topa dhe një mori armatimesh, municionesh dhe ushqimesh? E gjitha kjo shëmbëllente me një çudi! Por, kush i nje shqiptarët, nuk e ka të vështirë ta kuptojë këtë ecuri ngjarjesh... Lufta për Vlorën vazhdoi e rreptë. As ditë dhe as natë nuk rreshiti zjarri i pushkëve dhe gjëmimi i topave përmbi qytet dhe fshatrat përreth". Më tej do shprehej: "më 17 gusht trupat italiane u larguan nga qyteti dhe hypën nëpër anije, më 3 shtator 1920 "rebelët", fitimtarë dhe krenarë me të drejtë, hynë në Vlorë dhe e bashkuan krahinën e tyre me pjesën tjetër të Shqipërisë. Ata e kishin merituar këtë sukses". Lufta e Vlorës ballafaqoi forcat italiane dhe shqiptare, ngjarje luftarake që u pasqyruan në gazetën "Drita" të Veli Harshovës Gjirokastër, "Kuvendi" "Dielli" të Bostonit etj. Shoqëria "Vatra" e Amerikës dërgoi "Bandën" e shoqërisë që drejtohej nga Thoma Nasi së bashku me trupat vullnetare. Në këtë luftë shkoi edhe banda muzikore "Afërdita" e Elbasanit. Në këtë luftë u shquan me kontribut të spikatur Babai Teqes së Turanit të Tepelenës Ahmet Turhani, Baba Xhaferi Përmet, Don Mark Vasa, myftiu Osman Muka, At Shtjefën Gjeçovi, etj.

Kush ishte Osman Haxhi Muhameti – fituesi i Luftës së Vlorës më 1920-ën

Osman Haxhiu u lind në Picar të Vlorës më 28. 10. 1885. Mësimet e para i mori në mejtepin e qytetit, nga viti 1900 deri më 1905 kreu studimet në kolegjin amerikan "Robert Kollez", në Stamboll, ku mësoi turqishten, gjermanishten,



Shtabi Luftarak i Mbrojtjes Kombetare

frëngjishten. Qysh herët zuri miqësi me djemtë e Ismail Qemalit, Ethem e Qazim Vlorën dhe me ta, që në moshë të re, u radhit në lëvizjen për pavarësi të Shqipërisë. Në Stamboll, në vazhdim të traditave patriotike familjare, u lidh ngushtë me Ismail Qemalin, Hasan Prishtinën, Mulla Xhaferr Drashovicën etj. Ka qenë një djalë i shkathët, i zgjuar, syptrembur, i ushqyer me idetë e rilindësve e u njoh si një luftëtar aktiv për ti vënë ato në jetë. Që i ri provoi edhe syrgjynosjen në Arabinë Saudite, por patriotët shqiptarë të lidhur me të nga Siria, Egjipti, Libia e Stambolli, e ndihmuan të arratisesh... Më 1906 emërohet nëpunës në Vlorë, më 1908 anëtar i klubit "Labëria"; më 1909 nëpunës në Prefekturën e Janinës, nga ku arratiset me vlonjatë të tjerë. Nga Janina shkon në Korfuz, Bari, Napoli e Romë. Më 1911 Osman Haxhiu kthehet në Vlorë bashkë me Ethem bej Vlorën dhe u bë mbështetës i fuqishëm i Ismail Qemalit në organizimin e lëvizjes kombëtare. Në Vlorë nisi një aktivitet të ngjeshur atdhetar, në përfshirje të Klubit "Labëria", por edhe bashkëpunoi ngushtë me Ismail Qemalin. Përpara shpalljes së Pavarësisë në Vlorë, komisioni i ngritur, ku merrte pjesë dhe Osman Haxhiu, krijoi një qendër ushtarake në Shkozë të Sevasterit, me fuqinë e një Komande Ushtarake, në luftë kundër agresorëve andartë grekë. Pas ardhjes së Ismail Qemalit nga Durrësi në Vlorë, ai u rrethua nga patriotët e Vlorës, përfshi edhe Osman Haxhiu. Më 1913 u caktua Sekretar i Prefekturës së Vlorës. Edhe pse u ngarkua në këtë detyrë, me urdhër të Ministrisë të Brendshme, Mehmet Pashë Dërralla, bashkë me Alem Mehmetin dhe Ethem Vlorën, gjatë muajve shkurt-prill 1913, qëndruan në bregdet për organizimin e forcave në mbështetje të frontit të Janinës. Osman Haxhiu në fillim u caktua zëvendësprefekt e më vonë prefekt, detyrë që e mbajti deri në muajin shkurt të vitit 1917 në Vlorë. Prefektura e Vlorës me Osman Haxhiun në krye, bëri të pamundurën për sistemimin dhe vendosjen e tyre në shtëpitë e fshatarëve vlonjatë të muhaxhirëve të ardhur nga krahinat e Kurveleshit, Kardhiqit, Libohovës e Rrëzomat e Delvinës. Në vitet 1916 deri më 1917 Osman Haxhiu me të ardhurat e veta, çeli shkolla fillore për fëmijët e popullit fukara në të gjitha katundet e Vlorës dhe si biri i popullit shumë shpejt hyri në zemrën e tij, kur vendosmërisht kundërshtoi pushtuesit italianë, që në administratën e prefekturës, të mos flitej italisht dhe se çdo dokument i saj të shkruhej në gjuhën tij. Italianët e pushojnë nga puna më 22.2.1917, kohë kur ju përvesh punës ilegale për çlirimin e Vlorës dhe bashkimin me trojet e tjera shqiptare. Në periudhën midis viteve 1917-1918, Osman Haxhiu nuk e ndërpreu veprimtarinë patriotike. Ai pati mjaft letërkëmbime me Ismail Qemalin, Hasan Prishtinën, Aqif Pashë Elbasanin, Vehbi Dibrën dhe patriotë të tjerë. Në këto mesazhe bëhej më e plotë situata, detyrat dhe komplotet që thureshin në kancelaritë evropiane për copëtimin e Shq-

ipërisë. Çdo ditë që kalonte evidentonte me qartë rrezikun e madh, shkëputjen e Vlorës dhe hiterlandit të saj nga gjiri i atdheut. Atdhetari patriot Halim Xhelo kishte krijuar organizatën "Lidhja Fshatare e Labërisë", ku kishte mbledhur rreth saj atdhetarë të shumtë, ndërkohë që më 28.11.1919 në shtëpinë e Osman Haxhiut u mbledhën të përkujtonin e festonin me flamur në dorë në sheshet dhe rrugët e qytetit. Flamuri kombëtar mbahej nga dy djem vlonjatë Rexhep Arapi e Faik Xhaferri, të cilët në çdo hap shoqëroheshin nga dy bijtë e Shqipërisë Jonuz e Myrsel Kumanova. Në krah të tyre ecnin Osman Haxhiu, Duro Shaska, Abaz Nezini, Qazim Kokoshi etj. Në këtë ditë historike për Shqipërinë, përlëshja me pushtuesit ishte më e përgjakshmja në 7 vitet e pavarësisë. Në krye të Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare". Në zbatim të Vendimeve të Lusnjës në mars të vitit 1920, u krijua një organizatë patriotike, ku Osman Haxhiu u zgjodh në krye të Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare" me rol të jashtëzakonshëm në ngritjen e popullit të Labërisë për luftën çlirimtare. Në Kuvendin e Barçallasë, më 29 maj 1920, krahas miratimit të vendimit për luftë ndaj pushtuesit italianë, Osman Haxhiu u zgjodh kryetar i Komitetit të "Mbrotjtjes Kombëtare" komandë udhëheqëse e drejtuese e veprimeve luftarake. Për këtë detyrë të besuar, ai mori dhe miratimin e njëzëshëm në mbledhjen e Beunit prej komandantëve të të gjithë çetave, që përfaqësonin më shumë se 4000 luftëtarë fillimisht. Ultimatumit i 3 qershorit 1920, i firmosur nga kryetari i Komitetit të Mbrotjtjes Kombëtare Osman Haxhiu dhe anëtarët e tij Qazim Kokoshi, Duro Shaska, Ali Beqiri, etj., që i drejtohej gjeneral Piaçentinit, kërkohej "...lirim i menjëhershëm i Vlorës prej ushtrisë Italiane". Lufta e Vlorës është një ndër kryeveprat e jetës së Osman Haxhiut, epokë të lavdishme që përjetësisht është skalitur në Historinë kombëtare të shqiptarëve e përjetuar në vargjet memorial: "Ja do të bëhet Vlora jonë, ja do të bëhet gurë e hi". Në këtë luftë mbarëshqiptare mbetën 157 dëshmorë, por edhe 400 të plagosur... Komiteti i "Mbrotjtjes Kombëtare" me Osman Haxhiun në krye, i mbështetur fuqimisht nga qeveria e Sulejman Delvinës, e plotësoi me nder misionin e madh atdhetar e çlirimtar, që i ngarkoi koha, liria, kombi shqiptar e historia. Osman Haxhiun, populli i Vlorës e zgjodhi deputet në Parlamentin Shqiptar në vitin 1921. Ndërsa në Revolucionin Demokratik të Qershorit 1924, Osman Haxhiu ishte në krah të Fan Nolit, të Bajram Currit e të Luigj Gurakuqit. Atdhetari dhe patrioti Osman Haxhiu dha për Shqipërisë gjithçka, rininë, mënjësinë, dashurinë, trimërinë dhe pasurinë, prandaj edhe populli shkroi vargje lapidarë: "Lule Osman efendi/T'ishin dy a tre si ti/ Do bëhej Shqipëri". Osman Haxhiu u shua në moshën 51 vjeçare më 12 mars 1937. Për figurën atdhetare të Osman Haxhiut ka shkruar një monografi "Osman Haxhiu", Prof. Bardhosh Gaçe, shkolla dhe rrugë mbajnë emrin e tij, ndërsa në tre dekada demokraci është nderuar si drejtuesi dhe udhëheqësi kryesor i Luftës Kombëtare të Vlorës të vitit 1920. Edhe pse kanë shkruar dhjetra shkrime për Osman Haxhiun nderimi për të sërish është i pamjaftueshëm, sepse ai ishte një figurë



Settimio Piacenti

kombëtare dhe jo një udhëheqës lokal i një luftime lokale kur vetë Lufta e Vlorës ishte luftë kombëtare e të gjithë shqiptarëve. Figura e Osman Haxhiut ishte aq popullore dhe me vlerë në kohë rreziku për Shqipërinë sa për figurën e tij kanë shkruar shumë autorë si, Prof. Bardhosh Gaçe, Mehdi Frashëri, Muin Çami, Ago Agaj, Ali Asllani, Hamza Isaj, Jani Minga, Ibrahim Shyti, Ibrahim Kushta, Isuf Luzaj, Fatos Arapi, Lefter Çipa, Bernard Zotaj, Albert Abazi si dhe dhjetra historografë të tjerë. Në rastin e kryetarit të KMK-së vërtetohet ajo që thonë shumë shkrimtarë gjermanë se, "shqiptarët janë një popull zotërinjsh (Herrenvolk) dhe një autor francez thotë se: "...janë aristokratët e Ballkanit". Ata më mirë ndërronin besimin se hiqnin dorë nga qëllimet e synimet drejt të cilave i shtynte parreshtur ambicioni i tyre rrënjësor thellë në shpirt. Gjithashtu arkivat e bibliotekat kanë një pasuri dokumentare për këtë figurë që nuk mundën ta shuajnë e ertësojnë motet e trazuara shqiptare. Osman Haxhiu ishte dhe ngeli truri drejtues të Luftës kombëtare të Vlorës, që në një shekull dhjetra studiues janë përbashkuar në gjykimin historiografik shqiptar se, "Osman Haxhiu dhe KMK-ja ishin një elitë intelektuale, plotësisht e vendosur në fitore, e arsimuar, e pasur, atdhetare, shkruan enciklopedinë e mënjësinë dhe trimërisë shqiptare të shekujve, largpamës, të fjalës peshërëndë, të besës së palëkundur, të besimit në fitore, të burrave që materializojnë vendosmërinë absolute në fitore, besim tek vetja dhe besim tek Komandantët e çetave, besim tek çdo luftëtar, një trupë elitare drejtuese luftarake që besonte në vlerat e një Shqipërie të përbashkuar, besonin plotësisht në unitetin e bashkimit e përparimit kombëtar. KMK-ja ishte e rrallë, e papërsëritshme deri më sot në historinë e shqiptarëve. Organizatorët dhe drejtuesit e luftës së armatosur të shqiptarëve për çlirimin e Vlorës ishin bij të denjë të popullit të mënjësinë, të shkolluar, të pasur dhe me mbështetje të gjerë popullore. Prandaj në përvjetorin e 135-të i lindjes së Osman Haxhiut, këtij udhëheqësi të mcur popullor të luftës, busti i tij qëndron kryelartë i derdhur në bronz në qendër të qytetit të Vlorës! Mik i vegjël dhe i parisë, politikan i matur si prefekt e deputet, zë i fuqishëm i Vlorës historike, luftëtar i rreptë i fateve të vendit duke organizuar një luftë të tërë që ndriti historinë shqiptare. Ai ishte një personazh heroik me bëma të paçmueshme dhe themele të forta të shtetit të pavarur shqiptar. Ai do respektohet e nderohet për kontribute kombëtare, në të mirë të kombit të tij si simbol përbashkues i unitetit dhe dashurisë për Vlorën dhe Shqipërinë e përbashkuar.

Gjeneral Lejtënant Settimio Piaçentini -humbësi i Luftës së Vlorës më 1920-ën

Settimio Piaçentini ishte lindur në rrethin San Polo të Tarano-s në Peruxhia, më 6 janar 1859. Karakteri i tij i vendosur dhe i zgjuar e shtyu atë ta lidhte jetën me ushtrinë mbretërore apeninase. Pasioni për ushtrinë bën që të përfshihet në radhët e kadetëve ushtarakë në Akademinë Ushtarake. Kur ishte në moshë të pjekur e madhore, në moshën 30 vjeçare, më 1909 ai u thirr për të qenë pjesë

e Komisionit për shqyrtimin e propozimeve për shpërblim për trimëri ushtarake; ndërsa dy vjet më vonë më 1911 ai përzgjidhet si oficer madhor shtabnik e këshillues strategjik i mbretit italian. Në Shkollën ushtarake pranohet më 1.10.1875, kur ishte 16 vjeç, ndërsa në Akademinë Ushtarake më 1.10.1876, që e formoi si ushtarak karriere në një shkollë lufte. Në moshën 20 vjeçare më 27 korrik 1879, përfundon studimet në nivelin "ekselencë" dhe emërohet nëntoger. Dy vjet më vonë, më 12 qershor 1881, gradohet "Toger". Promovimi i shpejtë dhe përzgjedhja si oficerë me të ardhme bëri që Settimo Piaçentini t'i ndrinte fati dhe të kishte një karrierë të shpejtë e të shkëlqyer. Shumë shpejt do të bëhej një nga instruktorët më të njohur të së njëjtës Akademi Ushtarake, në shkollën e përgatitjes së Artilerisë dhe Inxhinierisë e më tej deri në detyra madhore në Korpusin e ushtarakëve të Shtabit të Përgjithshëm italian. Gradën "Kapiten" e mori më 26 shtator 1886, Major më 8 Mars 1894, Nënkolonel më 9 janar 1898, Kolonel më 8 korrik 1903 dhe pas gjashtë vjetësh më 23 dhjetor 1909 i jepet grada madhore Gjeneralmajor. Në vitet 1906-1910 shërbeu edhe si këshilltar i Institutit për studime në Sabine. Grada e fundit e gjeneral lejtënantit ju dha më 3 shtator 1914, gradë që e mbajti deri më 9 Shtator 1920, vetëm një javë pasi u largua nga fronti i luftës pa lavdi. Por përgjatë jetës ushtarake Piaçentini kreu edhe detyra shumë të vlerësuara si më 5 prill 1896 si komisioner ushtarak për hekurudhat; nga 4 maj 1911 deri më 6 shtator 1913, si gjeneral adjutant dhe gjeneral nderi i përgjithshëm i Mbretit italian nga 6.9.1913. Që prej datës 26 janar 1917, ka kryer detyrën edhe si anëtar i Këshillit të urdhrit ushtarak të Savojës. Lufta e Parë Botërore nga viti 1914 deri 1918 ishte "shansi" i tij. Ai shkëlqeu me zotësitë e tij ushtarake. Gjenerali italian përgjatë Luftës së Parë Botërore ishte mjaft aktiv, veçanërisht në Betejat e Isonzo-s. Settimo shpalosi gjithë aftësitë e tij, gatishmërinë, rreptësinë, vetdisiplinimin, korrektësinë që spikaste si elitë i trupës komanduese italiane. Në veprimtarinë e tij ushtarake u shqua si administrator i përgjithshëm i ushtrisë, dëshmon konkretisht aftësitë e tij organizative duke bërë përshtatjen dhe shërbimet e vendosura në kohë paqeje me rrethanat e luftës. Settimo Piaçentini do të avanconte në profesionalizëm duke marrë detyra si komandant i njëjësive kryesore në të gjitha fushat e betejës, nga Isonzo në Cadore. Në 1916 ai komandoi Korpusin e XVI të Ushtrisë Italiane në Shqipëri deri në maj 1916 kur u thirr përsëri në Itali për të komanduar korpusin e pestë italian në Frontin e dytë në Isonzo deri në Qershor 1917. Më 15 janarit 1918 në Monte Grappa Gjeneral Piaçentini nderohet me maljen e argjendit për trimëri dhe për kontributin e çmuar të trupave të tij të ushtrisë në rezistencën kundër ofensivës armike. Për zotësitë e tij si ushtarak ai është vlerësuar gjithashtu me dekoratën "Nderi i lartë i kalorësit të kryqit madhështor të urdhrit Ushtarak të Savojës". Dekoratat ishin "si breshër mbi supë" dhe i mbuluan gjoksin përgjatë gjithë jetës si: Kalorës i Urdhrit të Kurorës së Italisë 31.5.1894, Oficer i Urdhrit të Kurorës së Italisë 27.12.1906, Komandant i Urdhrit të Kurorës së Italisë 3.6.1909, oficeri i madh i urdhrit të kurorës së Italisë 19.6.1913, kordoni i madh i urdhrit të kurorës së Italisë 26.10.1920, kalorës i urdhrit të SS. Maurizio dhe Lazzaro 24.1.1901, oficer i urdhrit të SS. Maurizio dhe Lazzaro 13.1.1910, komandant i urdhrit të SS. Maurizio dhe Lazzaro 9.6.1912, zyrtari i madh i urdhrit të Shën Maurizio dhe Lazzaro 1.6.1918, kordoni i madh i urdhrit të SS. Maurizio dhe Lazzaro, oficeri i madh i Urdhrit Ushtarak të Savojës 28.12.1916, kordoni i madh i Urdhrit Ushtarak të Savojës 24.7.1920 (ndërkohë që ishte kulmi i luftimeve

në Vlorë dhe disfata e dukshme!), komandant i Urdhrit të Franz Joseph (Austri), oficeri i madh i urdhrit të Leopold (Belgjikë), Kalorës i Urdhrit të Legjionit të Nderit (Francë), urdhri i Shqiponjës së Kuqe (Gjermani), kalorës i kryqit të madh të Urdhrit të SS. Michele dhe Giorgio (Angli), kordoni i madh i urdhrit të Shën Stanislaus (Rusi). Periudha Luftës së Parë Botërore (1914-1918) dhe sidomos fushata ballkanike e vitit 1919 ishte një konglomerat e kompleksitet me përzijerje komandash, trupash, armësh, lavdishë e dështimesh dhe përsëri dekorimesh që gjenerali do t'i përjetonte si "kurorë dafinash" të kryqeve të arta për vjetërsi, merita lufte; medalje argjendi për trimëri ushtarake, por në fund në mugutirën e burrërisë me "një grusht të hekurt turinjve" të marrë nga luftëtarët shqiptarë në Luftën e Vlorës.

"Lavdia" dhe nderimi i një burrështetasi italian në vendin e vet

Fakt ishte se pala italiane "u paraqit" në përballje me shqiptarët në Vlorë me mendjet më të shquara akademike ushtarake të kohës si Settimo Piaçentini, Giovanni Giolitti, Enrico Gotti etj., që komandonin rreth 20 mijë trupa në Shqipëri. Por edhe pse humbja e italianëve ishte e sigurtë përsëri ata tentuan në synimet e tyre. Por duke u bazuar në në aktet përkujtuese parlamentare italiane hedhim dritë mbi atë që quhet "analiza e pasluftës", por që pa mundur të analizohej në detaje humbja, shuhet jeta e komandantit të luftës Piaçentinit, për të cilin e shikojmë të pasqyruar në dokumentat italiane. Ja si shprehej Tommaso Tittoni, President i Senatit Italian në ditën e vdekjes së gjeneral Settimo Piaçentini: "Të nderuar senatorë! Këtë herë, për fat të keq, gjatë rifillimit të punës sonë, kam detyrën e dhimbshme të njoftoj humbjen e kolegëve të dashur. Më 2 nëntor, gjeneral lejtënant Settimo Piaçentini papritmas ndaloi së jetuari në San Polo Sabino...Një figurë e pëlqyeshme ushtarake Piaçentini ia kishte kushtuar energjitë e tij më të mira vendit të tij; dhe me keqardhje të thellë njoftojmë humbjen e tij... Në Senat, kolegu ynë kishte hyrë që prej 8 qershori 1921. Ai lindi në Tarano më 6 janar 1859 dhe në një moshë shumë të re, përqafoi jetën ushtarake, i nxitur mbi të gjitha nga karakteri i tij i vendosur dhe natyra e tij e zgjuar. Pasi përfundoi me nderim kurset e Akademisë Ushtarake, në 1879 u emërua toger i dytë. Ai pati një karrierë të shpejtë dhe të shkëlqyer. Fitoi pozicione të shumta besimi dhe promovimi. Ka qenë instruktor në të njëjtën Akademi Ushtarake dhe më pas në Shkollën e Artilerisë dhe Inxhinierisë duke gjetur shkallët e karrierës deri në Shtabin e Përgjithshëm. Si gjeneralmajor, në 1909, ai u thirr të ishte pjesë e Komisionit për shqyrtimin e propozimeve për shpërblime për trimëri ushtarake dhe pak më vonë, në 1911, ai u zgjodh si ndihmës ushtarak i mbretit. Në luftën e fundit ai përfundoi një punë vërtet të çmuar, duke kryer në kontigjencat më të ndryshme një veprim që ishte i gatshëm dhe i ndriçuar, duke mbajtur gjithmonë një ndjenjë të rreptë të disiplinës dhe detyrës. Që në fillim të karrierës ushtarake spikati për cilësitë e organizatorit dhe drejtuesit si parashikues i luftës. Në karrierën e gjatë ushtarake meritoi vlerësime dhe dekorata të shumta, për trimëri, për kontribut të vlefshëm në rezistencën energjike kundër ofensivës së armikut etj. Në krye të komandës së trupave italiane në Shqipëri, në nderim të vendit dhe të armëve italiane, me forca të pakta në dispozicion ai ishte në gjendje të organizonte një mbrojtje të palëkundur rreth Vlorës dhe t'i tregonte Qeverisë masat e mençura dhe më të përshtatshme që kërkoheshin për të zgjidhur problemin e atij rajoni, për të cilin ai kishte marrë njohuri të

thella. Nderimi shumë i lartë, i dhënë atij me atë rast, si “kalorës i kryqit të madh të Urdhrit ushtarak të Savojës”, që ishte vlerësim i drejtë i shërbimeve dhe motivim si një titull lavdie, pasi ai arriti të kryejë denjësisht detyrën dhe të meritojë mirënjohjen e atdheut dhe i destinuar të japë fryte ndër vite. Jemi të trishtuar që fati ja ndërpreu jetën e çmuar dhe i shprehim mirënjohjen në kujtesë të shërbimeve ndaj vendit si dhe i dërgojmë gruas së ngushëllimet më të përzemërta! Kujtesa vijon të jetë e gjallë edhe pas një shekulli. Gasparotto, Ministër i Luftës: “Kërkoj të flas. Presidenti: Ka të drejtë”. Gasparotto, Ministër i Luftës: “Në emër të Qeverisë dhe ushtrisë, unë kam nderin të bashkohem me fjalët e larta të thëna nga Presidenti i shquar në kujtim të gjeneral Piacentini... Figura fisnike e gjeneralit Piacentini u shfaq në fushat e betejës. Ka qenë mësues në rininë e tij në shkollat tona të luftës, në prag të hyrjes së Italisë në konfliktin evropian. Ai u bë promovuesi i krijimit të njësisve të reja të destinuara për provën e afërt të luftës. Hapja e luftimeve e gjeti atë mbikëqyrës të përgjithshëm të ushtrisë dhe atje ai siguroi vendosmëri dhe mençuri për koordinimin e shërbimeve; Komandanti i Korpusit të parë të Ushtrisë Kadore, me veprim të vendosur komandues mbajti të vendosur pozicionet e pushtuara ndaj armikut dhe u përball, me sukses që kishte mahnitur opinionin publik italian, shqetësimin e paparashikuar të fushatës së parë dimërore. Prej asaj dite nuk kishte asnjë fushatë luftarake, nuk kishte asnjë moment kulminant në historinë tonë të luftës që të mos kishte në ballë figurën e gjeneralit Piacentini. Në mars 1916 ai ishte në Shqipëri, por kur armiku hyri në pellgun Arsiero, dy muaj më vonë, në maj të të njëjtit vit, ai ishte kthyer tashmë në Itali, ...dhe sërish në Shqipëri. Por pa sukses!

Gjeneral Piacentini që “u mbyt” në detin e Luftës së Vlorës

Piacentini përshkruhet nga bashkëkohësit si një ushtarak me tipare të lindura, i dashuruar me disiplinën, punëtor i palodhur, modest dhe i heshtur; gjithënjë i përkushtuar dhe i zhytur dhe trupëzuar me detyrën. Nga mesi i vitit 1918, ai u kthye në Shqipëri duke u emëruar Komandant i Përgjithshëm i forcave italiane në Vlorë dhe në gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë. Përzgjedhja e tij ishte për një “dorë të hekurt” përballë rrebelimit dhe mosbindjes shqiptare. Në Shqipëri erdhi me bindje për të komanduar e drejtuar trupat italiane në Shqipëri dhe në fakt me forcat e pakta në dispozicion, ai arriti të organizonte një mbrojtje korrekte bazuar në kriteret e mbrojtjes përgjatë gjithë qytetit të Vlorës, por që vartësve të tij u mungonte shpirti luftarak dhe morali për të fituar. Ai drejtoi për dy vjet nga 1918 deri më 3 shtatorin e vitit 1920, ku ai në fakt dështoi në luftimet në Luftën kombëtare të shqiptarëve, të cilët bënë të dështonte një ndër gjeneralët më të mirë të kohës të Mbretërisë së Apenineve. Pas humbjes së ushtrisë së tij në Vlorë me “një grusht rrebelësh”, përfundon edhe karriera e tij ushtarake dhe ai tërhiqet në Tarano, në qyteti i tij të lindjes, për një jetë të thjeshtë dhe të qetë larg zhurmave të luftës. Është në këtë periudhë e vendos veten në dispozicion të një drejtësie dhe paqeje, duke ruajtur njëherësh autoritetin e rrobës ushtarake në të cilën shërbeu me një karrierë që shkoi nga njera fitore në tjetrën, por që në fundin e jetës u turpërua me luftëtarët vlonjatë. Në jetën e shkurtër civile synonte paanësi, zgjidhje të mosmarrëveshjeve midis fshatarëve dhe pronarëve me qetësi dhe maturi. Gjenerali me tre vje Settimio Piacentini nuk pëlqente pompozitetin edhe në rastet ceremoniale, sikurse ishte nderimi për për

Ushtarin e Panjohur. Ai nuk shkon në Romë me autoritetet e para të shtetit, por dëshiron të nderojë ushtarin në tokën Sabine, në mënyrë të thjeshtë e të qetë me përfaqësuesit e Komunave dhe Shoqatave të Sabinës së Poshtme. Më 2. 11. 1921 sëmuret dhe ndërron jetë një gjeneral fitimtar, që humbi vetëm një betejë: “Betejën për Vlorën”. Ai nuk mundi t’i mbijetonte stresit që i krijoi lufta, bijtë italianë të humbur në luftë, si dhe momentet kur gjeneral Piacentini detyrohej t’u përcillte familjeve trupat e vrarë në një luftë të pakuptimtë që edhe vetë se kuptoi dot në kohë. Sipas Dr. A. Hitoaliaj, sipas “pasqyrës së humbjeve të njësisve italiane në operacionet në territorin e Shqipërisë”, rezultoi se “të vdekur të plagosur të humbur”, për vitin 1916 ka pasur 815 trupa; në 1917 – 93 trupa; në 1918 – 626, në 1920– 680 trupa; që në total humbjet në trupa italiane shkonin në 2877 trupa. Nga të cilët të vdekur kanë qenë 454 vetë. Vlora u shndërrua në barikadë e palueshme për italianët që edhe vetë nuk besonin në fitore. Edhe pse ata kishin 7500 ushtarë, 500 oficerë dhe 12 gjeneralë në Vlorë. Por trupa luftuese në front përbëhej nga 4400 trupa, 300 oficerë kurse pjesa joluftuese (mbështetëse) përbëhet nga rreth 200 oficerë dhe 3100 trupa. Malaria bënte kërdinë dhe numri ulej përditë, ku 2/3 ishin malarikë si dhe 1/3 e trupave me ethe malarike ose me ethe të humbjes së luftës. Trupa drejtuese pushtuese italiane kërkonte 1000 trupa funizime të reja edhe pse u premtuan 500 dhe erdhën 200. Ndërkohë 4400 ushtarë mbanin Vlorën të shërnguar. Por “litari u mblodh” dhe nderin e Settimio Piacentini e shpëtoi Protokollin shqiptaro-italian i 2 shtetit 1920, ku në tetë pika gjeti zgjidhjen e tërheqjes nga Vlora, që ishte një brengë në zemër e Gjeneralit për dështimin në prag të moshës së tretë. Ndërkohë që pika “VIII”, ishte një “thikë me dy presa” për nënshkruarit, pasi, “Përmbajtja e këtij protokollit paraprak as nuk do të botohet as nuk do të komunikohet të huajve, përveçse akordit mes palëve”. Në atë kohë kur çështja shqiptare do të çohet për diskutim në Konferencën e Paqes në Versajë, para përmblyljes së protokollit përfundimtar, palët nënshkruese mund të përdorin në konferencë aktin prezent. Për kohën tërheqja ishte zgjidhje, edhe pse Sazani ngeli “tokë nën zotërimin italian” edhe për 23 vjet të tjera. Piacentini e “kishte bërë detyrën” karshi politikës që i thuri lavde, u denigrua nga opozita e shtetit të vet, si dhe u ndie i dërrmuar ushtarakisht nga humbja reale e luftës, pavarësisht dekoratave që ndonjëherë shërbejnë edhe si dekor apo stoli xhingla-minglash. Nisur nga dokumente e relacione që Komanda e Trupave Italiane në vendin tonë dërgonte mbajnë nënshkrimin e gjeneraljejtënant Settimo Piacentini, që janë në fakt një ekspozitë luftarake me materiale arkivore italiane që pikëshruajnë ngjarjet, që fundosën italianët dhe ngritën lavdinë e shqiptarëve në Luftën kombëtare të Vlorës të 1920-ës. Megjithëse historiografët italianë e vlerësojnë gjeneraljejtënantin Settimio Piacentinin, që u shua në moshën 62 vjeçare, si një personalitet ushtarak gjeneralist të Tarano-s së Peruxhias. Tetë vite pasi kishte ndërruar jetë Piacentini, më 1929, Prefektura ku banonte miratoi vendosjen e një pllake për nder të tij në pjesën e jashtme të shtëpisë “Settimio Piacentini”.

Lufta e Vlorës si “leksion internacional” për kombet e shtypura

Por Lufta e Vlorës ishte edhe si “leksion internacional” për kombet e shtypura, për t’i treguar botës se liria rrënjët e veta në kohë paqeje i vadit me djersë dhe në kohë luftarake me gjak. Pra “Lufta”, nuk është vetëm një tragjedi për truallin e pushtuar, por dhe një tragjedi kombëtare dhe për vendin pushtues, sepse humbet bijtë e vet për interesa të

imperializmit, sikurse ndodhi me "bijtë" e gjeneral Piaçentiniit, i cili në momentet kur ishte i rrethuar nga kryengritësit shqiptarë, të cilët sa vinin dhe i shtrëngonin darën e rrethimit, të ndodhur para një fenomeni të pashmangshëm me urgjencë i kërkoi Ministrisë së Luftës Italiane dhe kryeministrit Nitti mbështetjen me trupa dhe armatim. Në fakt jehona e Luftës së Vlorës i kishte kaluar kufijtë dhe jo vetëm populli i thjeshtë italian, por dhe vetë brenda për brenda ushtrisë italiane, masa e zemërimit dhe urrejtjes ishte rritur së tepërmi. Arsyet ishin të ligjshme: Italia ishte tejlodhur nga luftërat, e sfilltur nga humbjet e një pas njëshme gjatë Luftës së Parë Botërore. Populli italian gjakderdhjen bijve të saj në Vlorë, kur ishte deklaruar se, "lufta kishte mbaruar", në fakt lufta vazhonte për interesa të kapitalit italian. Nuk kishte oficer apo ushtar italian që nuk e kishte kuptuar se në Vlorë kishin shkruar për qëllime koloniale dhe jo "për të sjellë civilizimin romak në interes të dy popujve" dhe ishte krejtësisht e kundërta e përbetimit se "Italia përgjyrohej për dashurinë e madhe që kishte për Shqipërinë", që në fakt ishte një grykësi dhe oreks i shtuar jo vetëm për Vlorën por për gjithë ultësirën shqiptare me objektiva e synime të shtrirjes në kufijtë e Romës së vjetër: Qytetet e Italisë, në Ankona, Trieste, Brindisi u përfshinë nga revoltat mes ushtarëve barselierë e karabinierë, kundërshtuan dërgimin e trupave në Vlorë, që në historiografinë italiane njihet si "La rivolta degli Arditi" (Rebelimi i trimave guximtarë). Parrullat e qershorit 1920, "Via da Vlora"! (Largohuni nga Vlora)! Ishin vendimi i ushtarëve për të kundërshtuar urdhrin e ministrit të Luftës që të imbarkoheshin në anije për t'u nisur në Shqipëri. Ata në fakt ishin solidarë me Shqipërinë, sepse popujt përbashkohen në kohë rreziku dhe viktimat italiane ishin paralajmërimi i dytë i humbjes pas uraganit të luftëtarëve shqiptarë këtej Adriatikut. Kur anija "Molfeta", planifikonte të nisej nga Brindisi një nënë u ngjit në shkallët e anijes dhe u bëri thirrje të gjithëve që të mos niseshin për në Shqipëri; në Ankona përleshjet midis forcave të rendit me popullatën civile dhe barsolierve që nuk praninin të shkonin në Shqipëri, kishte bërë që situata të agravohej. Protestat për tërhiqje të trupave pushtuese nga Vlora, u bënë të përgjakshme, ku humbën jetën gati 20 ushtarë e qytetarë. Kryeministri Giolitti, kishte zëvendësuar Francesko Nittin, që gazetat shkruanin se "Nitin e rrëzuan vlonjatët", por parrugëzgjdhje. Rrugëzgjdhja u gjet vetëm me nënshkrimin e paktit të 2 gushtit 1920, pakt që njohu sovranitetin e plotë të Shqipërisë. Rafaele Ofidani me pseudonimin "Spartakus" u këndonte ushtarëve italianë, që niseshin për në Shqipëri: "O ushtari proletar që e le nënën tënde, /Si skllav shkon të vrasësh njerëz./Armikun se ke atje mes malesh dhe detin e bukur,/Mos e kërko larg, tiranin e egër e ke këtu,/Të ikim sa nuk është vonë nga dielli Shqipërisë./Ta lemë malarin, masakrën dhe urinë,/Dekje qeverisë së pangopur që drejt ferrit po na çon, po na çon...". Ishte një thirrje që del nga gjoksi i popullit me tingëllim të përhershëm aktual. Ndërkohë që në malet shqiptare këndohej një tjetër këngë: "O djem na iku vatani,/Vlorën me gjak ta lani,/Të na njohë italianin...". Por në fakt popujt nuk e donin dhe nuk e duan luftën. Politika ishte pro saj, nxitëse dhe frymëzuese. Qarqet reaksionare dhe shoviniste kur hyping në pushtet sjellin gjëma për kombin e tyre dhe fqinjët. Qëllimet dhe synimet e vjetra shoviniste e ultra shoviniste pavarësisht se si kamuflohen me lumë oratorik fjalësh të bukura, për të paralizuar dhe helmatisur përkohësisht ndërgjegjen kombëtare, nuk mund të kenë shërim dhe as të gjejnë melhem për plagët që u hapin popujve. Është maksimë e njohur e shumë popujve se në një përplasje luftarake njera palë thihet dhe tjetra tri-

umfon, po varet se si me çfarë çmimi. Dhe çmimi i një lufte është gjaku i derdhur përpara se të shkohet tek fitorja. Prandaj pas çdo lufte shkruhen konkluzionet dhe konsideracionet për luftën sikurse u shkruan dhe vijojnë të shkruhen edhe pas një shekulli si "Fitorja shqiptare e "Luftës së Vlorës". Diplomati italian Pietro Quaroni, i cili ka shërbyer në Shqipëri në vitet 1931-1932, në librin "Valixhia diplomatike", në lidhje me konfliktin ushtarak shqiptaro-italian, në verën e vitit 1920, i referohet Musolinit, i cili e quante "mynxyra jonë shqiptare! dhe...katastrofa jonë në Shqipëri". Gabriele D'Annunzio "asgjësimi i fitores tonë, ...një tjetër delikt i shëmtuar... kundër atdheut (Italisë)", Quaroni konkludon: "...të çapërlelesh për të shtënë në dorë mandatin mbi Shqipërinë, ta arrish këtë, duke siguruar edhe pëlqimin ndërkombëtar dhe pastaj duke patur armët në dorë, të na përzënë një grusht rebelësh shqiptarë, kjo i kapërcen kufijtë e imagjinatës". Fakt është se për shqiptarët lufta e Vlorës ishte krenari e ligjshme kombëtare, kurse për italianët, një disfatë e dhimbshme dhe e turpshme, pothuaj e pashpjegueshme. Gjenerali Luigi Cadorna, ish-kryetar i Shtatmadhorisë së Ushtrisë italiane në Luftën e Parë Botërore, gjykonte: "kurrë nuk është parë ndonjë shembull i tillë që qeveria e një shteti fitimtar të pësojë një ofensivë kaq të turpshme në dinjitetin kombëtar. Tërheqja jonë nga Vlora u bë në rrethana të turpshme!" Ky "defincion" ishte një këmbanë e turpshme në radhë të parë për komandantin e luftës. Ushtritë e një mbretërie me dyzetëmilionë banorë, të armatosura me mjetet luftarake më moderne, të komanduara nga gjeneralë të sprovuar në beteja, u mundën nga çetat shqiptare, të armatosura në mënyrë modeste, me armë të zakonshme, madje edhe me sëpata e hanxharë. Këtu italianën nënvleftësuan vlerën e "moralit në luftë". Heroizmi i luftëtarëve shqiptarë, gjaku i dëshmorëve shqiptarë rrëzoi mirin e pathyeshmërisë italiane, ndërkohë që "Traktatin e fshehtë të Londrës" dhe gjithë planet e tjera përfunduan në tre muaj luftë në koshin e historisë. Epopeja e Vlorës u zhvillua në Vlorë, por ajo do të kishte po atë ngjashmëri kudo në çdo krahinë apo troje që të shkelte pushtuesi, sepse shpirti i shqiptarit për liri, pavarësi dhe identitet kombëtar nuk ka reshtur, por ka ngelur flakadan gjer në yjet, pra është epope e gjithë Shqipërisë me të kuqen e flamurit të Vlorës. Pa një ide të qartë politike, pa zjarrin e atdhedashurisë, pa masa të sigurta organizative ushtarake pa guxim e trimëri sikurse dhe pa gjak dëshmorësh nuk ka e s'mund të ketë fitore dhe Lufta e Vlorës dhe shumë heronj e dëshmorë, të cilët u varrosën në kodrat e Babicës për të mos u harruar kurrë. Lufta e Vlorës është epope historike, stacion i gravitetit të patriotizmit dhe nderit kombëtar; në jetën e kombit tonë. Halim Xhelua me të drejtë thoshte: "Vlora u kthye në "termopilet" e Shqipërisë", sepse krisma e saj u dëgjua fort në kancelaritë e perëndimit. Zgjimi shqiptar, ishte i vonshëm, i vrullshëm ja vlejti para një shekulli, duke i folur kancelarive të Europës me gjuhën e forcës. Epopeja ka emrin "Lufta e Vlorës", ka emrin lavdi, ka emrin Shqipëri, ka emrin Pavarësi, ka emrin shpëtim përfundimtar për Shqipërinë nga rreziku i copëtimit dhe zhdukjes nga harta politike e botës. Shqiptarët u treguan italianëve, Europianëve dhe më gjerë se ditën ta gjen vetë rrugën e mbrojtjes së vendit të tyre me gjakun e dëshmorëve. Për lidhshimin politik-ushtarak italian të para një shekulli, Lufta e Vlorës ishte një grusht të hekurit nga shqiptarët turinje të Gjeneral Piaçentiniit dhe ushtrisë së komanduar prej tij. Ky ishte një mësim historik i papërsëritshëm që lartësoi Osman Haxhiun dhe fundosi, pse jo dhe propozoi gjeneral Settimio Piaçentinin, ndërkohë që në pikëpamje historiografike Piaçentini është gjenerali që "u mbyt" në detin e Luftës kombëtare të Vlorës.



FANË MISIONET NDËR KOMBËTARE
Gëzuar Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë!